INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

Seria për kërkime politike
BOTIM I VEÇANTË

Tërësia e Kompetencave
Rehabilitimi i shoqërive të shkatërruara nga lufta
Një projekt i koordinuar nga
Qendra për Studime të Aplikuara në Negociatat Ndërkombëtare (CASIN)

ADMINISTRIMI DHE QEVERISJA NË KOSOVË

Mësimet e mësuara dhe ato që mbeten për tu mësuar

Prishtinë/Gjenevë, qershor 2005
Ribotim

KIPRED

INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

Seria për kërkime politike
BOTIM I VEÇANTË

Tërësia e Kompetencave
Rehabilitimi i shoqërive të shkatërruara nga lufta
Një projekt i koordinuar nga
Qendra për Studime të Aplikuara në Negociatat Ndërkombëtare (CASIN)

ADMINISTRIMI DHE QEVERISJA NË KOSOVË

Mësimet e mësuara dhe ato që mbeten për tu mësuar

Prishtinë/Gjenevë, qershor 2005
Ribotim

Ky studim është përgaditur nga Robert Muharremi, Lulzim Peci, Leon Malazogu, Verena Knaus dhe Teuta Murati, redaktuar nga Isa Blumi nën kujdesin e Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikës (KIPRED). KIPRED synon mbështetjen dhe promovimin e vlerave demokratike në Kosovë duke ofruar trajnime, kryer hulumtime dhe analiza të pavarura, me qëllim të dhënies së ndihmës hartuesve të politikave për zhvillimin e politikës profesionale publike.

Tërësia e kompetencave *Rehabilitimi i shoqërive të shkatërruara nga lufta* është një projekt i Komitetit Koordinues ndër-Departamental Zvicran për Partneritet për Paqe, që është pjesë e aktiviteteve të Zvicrës në Partneritetin për Paqe. Kjo tërësi e kompetencave koordinohet nga Jean F. Freymond, Drejtor i Qendrës për Studime të Aplikuara në Negociatat Ndërkombëtare (CASIN).

Mendimet e shprehura në këtë punim pasqyrojnë vetëm ato të autorëve e jo të institucioneve të cilave ata i përkasin.

Ky hulumtim është përpiluar:
Robert Muharremi, Lulzim Peci, Leon Malazogu
Verena Knaus and Teuta Murati;
Editor: Isa Blumi

Copyright © 2005 nga KIPRED. Botimi i parë 2002. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sistem të rikthimit ose të transmetohet, në asnjë mënyrë dhe me asnjë mjet, në mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjim, incizim ose ndonjë mënyrë tjetër, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit. Ju lutemi, kontaktoni në postën elektronike: info@kipredinstitute.org ose në tel. +381 38 555 887.

Publikuar nga:

KIPRED

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Kodra e Diellit, Rruga 3, Lam. 39
Prishtina, Kosovë (UNMIK)
Phone and Fax: +381 38 555 887
www.kipredinstitute.org

Përmbajtja

Përmbledhja e përgjithshme
Hyrje
Përshkrim i shkurtër historik i Kosovës dhe UNMIK-ut

NJË VLERËSIM I PËRGJITSHËM

KORNIZA LIGJORE
Ligji i zbatueshëm: Teoria dhe Praktika
Legjislacioni i UNMIK-ut ndërmjet sistemit kontinental dhe atij Anglo-Sakson
Legjislacioni i Insitutucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes
a. Kompetencat e rezervuara dhe përgjegjësitë e transferuara
b. Harmonizimi i legjislacionit Kosovar me Acquis Communautaire
c. Disa aspekte të praktikave të tanishme legjislative
Rekomandimet mbi politikat

MENAXHIMI I SIGURISË SË BRENDSHME NË KOSOVË
Hyrje
Vendosja dhe strukturimi i Forcës Ndërkombëtare Ushtarake dhe Policisë Civile
Zbatimi i ligjit dhe rendit
Ndërtimi i qëndrueshmërisë: Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK)
Rekomandimet mbi politikat

MARRËDHËNIET NDËRETNIKE NË KOSOVË: SHIKIMI NË ARDHMËRI
Hyrje
Marrëdhëniet me komunitetet jo-Serbe
Kthimi i qëndrueshëm
Institucionet Kosovare dhe klima e përgjithshme
Insitucionet paralele
Rindërtimi dhe mundësitë ekonomike
Menaxhimi i Pronës
Të drejtat grupore dhe mbipërfaqësimi i minoriteteve
Praktikat e mira
Mësimet e mësuara për misionet e ardhshme
Rekomandimet mbi politikat

MISIONI I PARË I BASHKIMIT EUROPIAN
Ringjallja e fantazmave
Sektori i panjohur privat
Prona është kryesore
Krijimi i pronës është paqeruajtje

Nga rindërtimi në zhvillim
Menaxhimi i paditurisë

REHABILITIMI NË MITROVICË
Siguria
Administrimi
Serbët lokal dhe Beogradi
Shqiptarët e Kosovës
Rekomandimet

PËRFUNDIM

Shtojca: Shkurtesat dhe sqarimet gjuhësore

Shënimet

Përmbledhje

Ky punim ka për qëllim studimin e dinamikave të administritimit ndërkombëtar të Kosovës. Një studim i tillë do t'i përdorë përvojat e tri viteve të kaluara me qëllim të formulimit të pyetjeve të reja hulumtuese që mund ta ngrisin aftësinë e hartuesve të politikave për marrjen e vendimeve të duhura. Duke e vlerësuar misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe implementimin e komponentëve civil dhe ushtarak të mandatit të saj, ky punim identifikon sukseset dhe dështimet kryesore që kanë të bëjnë me dinamikat administrative në Kosovën e pas-luftës.

Punimi është i organizuar në katër pjesë të ndryshme, ku secila i përket një çështjeje të veçantë që ka të bëjë me veprimtarinë e UNMIK-ut duke ia tërhequr vëmendjen lexuesve në mësimet që mund të nxirren nga kjo përvojë. Në pjesën e parë, ne përqëndrohemi në aspektet kryesore të historisë së vonshme të Kosovës dhe vendin e saj ne kontekstin rajonal dhe ndërkombëtar. Në këtë kuadër, ne i shqyrtojmë bazat ligjore të administratës së tanishme në Kosovë dhe efektshmërinë e bashkësisë ndërkombëtare në transferimin e kompetencave/përgjegjësive te strukturat e sapo themeluara lokale. Kjo pasohet nga një pjesë që shqyrton performansën e tri organizatave të sigurisë – forcat ndërkombëtare ushtarake nën udhëheqjen e NATO-s, policinë civile ndërkombëtare dhe shërbimin lokal policor. Ne pastaj analizojmë marrëdhëniet ndëretnike pas luftës dhe vlersojmë përpjekjet e aktorëve të ndryshëm ndërkombëtar dhe lokal në promovimin e pajtimit, administrimin e pronës që ndikon në marrëdhëniet në mes të komuniteteve dhe mundësimin e kthimit të popullatës së zhvendosur. Përfundimisht, punimi vështron problemin e qytetit të ndarë të Mitrovicës si studim rasti, duke e testuar rëndësinë e përfshirjes ndërkombëtare në nivelet lokale të administrimit në Kosovën e pas-luftës.

Progresi dhe arritjet në Kosovë në periudhën e pas-luftës nuk do të mund të imagjinohen pa nja prani ndërkombëtare. Përkundër përpjekjeve politike për dorëzimin e kompetencave te strukturat lokale në disa sektore, prania ndërkombëtare mbetet e domosdoshme. Të gjitha tiparet e spikatura të shteteve Ballkanike në tranzicion shfaqen edhe në Kosovë. Shumë individë nga bashkësia ndërkombëtare pohojnë se Kosova është duke u rindërtuar nga zeroja, përderisa është duke kaluar nëpër tranzicionin në ekonomi të tregut. Administrohet nga një mision ndërkombëtar, që nganjëherë nuk e ka të qartë rolin dhe vizionin e vet. Një komplikim shtesë është statusi i jashtëm i Kosovës, që paraqet një temë tabu për diskutim. Jeta publike është duke u ndërtuar nga poshtëlart, duke filluar nga strukturat komunale në ato qendrore.

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që ia dha mandatin Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ishte po aq e mirë sa edhe kompromisi politik që e shkaktoi atë. Ndryshe nga shumë rezoluta tjera, 1244 ka pasë një ndikim mjaft të madh në situatën në terren. Aspektet e paqarta në rezolutë i lejuan hapësirë interpretimeve kundërthënëse nga palët e ndryshme me interes në proces, siç janë përfaqësuesit legjitim të Kosovës, UNMIK, dhe entitetet politike Serbe. Këto interpretime

kundërthënëse dhe pritjet nga ato që na bëjnë përfundimisht të përfundojmë se 1244 nuk ka qenë domosdo mekanizimi më i mirë për të mundësuar rindërtimin e Kosovës. Bashkësia ndërkombëtare nganjëherë mund të ketë pritje shumë të mëdha. Procesi i rehabilitimit është një proces i gjatë. Ky proces ka nevojë për një sinergji më të madhe ndërmjet organizatave ndërkombëtare dhe lokale për ta marrë parasysh të kaluarën dhe historinë e vonshme, kulturën dhe traditën dhe për të ndërtuar struktura praktike dhe të qëndrueshme të vendim-marrjes dhe hartimit të politikave. Në këtë mënyrë, procesi i ndërtimit të paqes mund të vlerësohet më mirë që do të ketë si rrjedhojë një cilësi më të lartë të administrimit dhe qeverisjes të zonave të kapluara nga konfliktet.

Hyrje

Ky punim identifikon disa çështje kyqe në administrimin dhe qeverisjen e Kosovës në periudhën e pasluftës. Punimi shpjegon se si organet udhëheqëse janë marrë me këto çështje, duke nxjerrë mësime nga bashkëveprimi i përfaqësuesve lokal me bashkësinë ndërkombëtare që pasqyrohen në rekomandimet tona mbi politikat parimore për misionin në Kosovë. Nëpërmjet këtij procesi, ne shpresojmë se lexuesit tanë do të nxjerrin mësime për misione të ngjashme që mund të themelohen në një të ardhme të afërt. Pas një vështrimi të gjithëmbarshëm të çështjeve të përgjithshme, punimi shikon disa fusha të ndryshme të qeverisjes dhe administrimit si dhe transferimin e kompetencave te aktorët lokal. Pjesa e parë merret me çështjen e kornizës ligjore të Kosovës. Pjesa e dytë vështron çështjen e sigurisë duke e analizuar performansën e pranisë ndërkombëtare ushtarake të udhëhequr nga NATO, policisë ndërkombëtare civile dhe shërbimit lokal policor. Në pjesën e tretë pason një analizë e marrëdhënieve ndëretnike pas luftës dhe veprimet përkatëse institucionale në këtë drejtim. Pjesa e katërt vështron zhvillimin dhe rindërtimin ekonomik pas luftës. Përfundimisht, punimi vështron rastin e posaqëm të qytetit të ndarë të Mitrovicës, çështjen më të vështirë të paraqitur gjatë administrimit ndërkombëtar të Kosovës në periudhën e pas-luftës.

Palët kryesore udhëheqëse të cilave iu drejtohet ky punim janë: bashkësia ndërkombëtare e pranishme në Kosovë (UNMIK, OSBE, UNHCR, Misioni i BE-së në Kosovë dhe zyret e huaja diplomatike dhe të ndërlidhjes), strukturat qeveritare kosovare në të gjitha nivelet dhe partitë politike. Sidoqoftë, mësimet që nxirren për misionet e ardhshme i drejtohen komuniteteve të gjera akademike dhe paqeruajtëse në përgjithësi pa marrë parasysh se a janë të përfshira në Kosovë apo jo. Punimi mundohet që të shpjegoj situatën në mënyrë analitike duke i lënë lexuesit që të vendos së në çfarë mase misioni është i suksesshëm.

Përshkrim i shkurtër historik i Kosovës dhe UNMIK-ut

Kosova ishte një krahinë e ish Jugosllavisë statusi i së cilës u ngrit në entitet autonom federal në 1974. Në fund të viteve tetëdhjetë, autonomia e Kosovës u shfuqizua nga Republika e Serbisë. Shqiptarët e Kosovës (vlerësohet se kanë përbërë rreth 90% të dy milion banorëve, sa kishte Kosova para luftës) shpallën pavarësinë dhe organizuan jetën e tyre të përditshme dhe institucionet paralele nëpërmes lëvizjes paqësore të rezistencës të udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Kosova mbeti nën regjimin represiv serb dhe trazirat u shkallëzuan gradualisht, duke arritur kulmin me luftën e armatosur në vitin 1998 dhe intervenimin me forcë të NATO-s në 1999. Pas luftës, Kosova është administruar nga një mision civil, kryesuar nga Kombet e Bashkuara me komponentin ushtarak të KFOR-it nën udhëheqjen e NATO-s. Ky mision që synon administrimin e Kosovës pa e paragjykuar statusin e jashtëm, është definuar nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara,[1] dhe është përshkruar detajisht në pjesën e parë.

Për herë të parë në histori, Kombeve të Bashkuara i është dhënë një mandat pa precedencë, si për nga shtrirja ashtu edhe për nga struktura e komplikuar, për ta marrë rolin e një shteti. Rezoluta 1244 themeloi UNMIK-un dhe i dha detyrë që të: kryejë funksionet themelore administrative civile, promovojë ndërtimin e autonomisë substanciale dhe vetëqeverisjes në Kosovë, mundësojë procesin politik për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, bashkërendojë shpërndarjen e ndihmave humanitare të të gjitha organizatave ndërkombëtare, mbështesë rindërtimin e infrastrukturës kryesore, mbajë rendin dhe qetësinë publike, promovojë të drejtat e njeriut dhe sigurojë kthimin e sigurt dhe të papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë.

Korniza operative e UNMIK-ut është ndarë në katër shtylla që udhëhiqen nga organizata të ndryshme ndërkombëtare që për herë të parë veprojnë si pjesë e qeverisë dhe gëzojnë një nivel të lartë të autonomisë në krijimin dhe implementimin e politikave parimore. Shtylla humanitare e udhëhequr nga UNHCR është përmbyllur në qershor të vitit 2000. Në vjeshtë të vitit 2002, shtyllat ishin: (I) Policia dhe Drejtësia, nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të Kombeve të Bashkuara; (II) Administrata Civile (KB); (III) Demokratizimi dhe ndërtimi i intsitucioneve (OSBE); (IV) Rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik (BE).

Një vlerësim i përgjithshëm

Ndonëse administrimi ndërkombëtar i territoreve ka precedencë historike (p.sh. Namibia, Kamboxha, Sllavonia Lindore, Irani Perëndimor), rasti i Kosovës së bashku me disa raste tjera të viteve nëntëdhjetë (si Bosna dhe Hercegovina dhe Timori Lindor) paraqet një topologji të re për akademikët në këtë fushë. Literatura deri më tani është e kufizuar në botimet interne të Kombeve të Bashkuara, dhe vetëm tani vonë janë bërë disa hulumtime të pavarura në këtë drejtim.

Richard Caplan ka bërë një analizë të qartë në këtë drejtim, duke vërë në pah një varg çështjesh që janë të lidhura me misione të tilla ndërkombëtare.[2] Ky punim trajton disa çështje të spikatura që i përkasin në mënyrë të veçantë Kosovës. Legjitimiteti është njëri ndër faktorët kryesorë që një mision ndërkombëtar duhet të kërkojë para se ta merr një territor nën administrim. UNMIK-u e kishte legjitimitetin, ndonëse në nivel shumë më të ulët në krahasim me KFOR-in e udhëhequr NATO. Në përgjithësi, kosovarët ishin të mendimit se Kosova kishte nevojë për siguri të paqëruajtësve e jo për një mentorim të gjithëpranishëm në të gjitha nivelet dhe sferat e jetës publike. Sidoqoftë, të gjithë kosovarët dhe dy liderët kryesorë, Rugova dhe Thaçi, që në mënyrë publike hoqën dorë nga institucionet që ata vetë i krijuan ose gjatë rezistencës ose menjëherë pas luftës, e pranuan misionin. Ky nuk ishte rasti me udhëheqjen serbe në veriun e Mitrovicës, të cilët nuk hoqën dorë nga udhëheqja e Beogradit. Përkundër sfidave, KB-ja ishte organizata e vetme e qëndrueshme që thirrej në neutralitet dhe që ishte aq shumëpalëshe sa që të jetë e pranueshme për të gjithë në Kosovë. Sa i përket rolit të palës së tretë, Stephen Stedman thekson rolin e "kujdestarit" dhe rëndësinë e marrjes së pajtueshmërisë nga të gjitha palët. "Një parakusht themelor për një proces të suksesshëm paqësor janë "kujdestarët" e pranueshëm" përshkruar nga Stephen Stedman si "aktor ndërkombëtar detyra e të cilëve është që të mbikqyrin implementimin e procesit paqësor." [3] Një nga detyrat e UNMIK-ut, mund të thuhet më e rëndësishmja në planin afatgjatë, ka qenë që ta sjellin territorin në një nivel në të cilin çështjet që kanë të bëjnë më statusin e jashtëm mund të mirren parasysh. Qoftë për shkak të konfliktit të komplikuar apo për shkak se UNMIK-u nuk i ka kryer shërbimet të cilat është dashur t'i kryejë, në kohën kur UNMIK-u ka qenë i pranuar mirë, tri vite e gjysëm pas konfliktit, asnjëherë nuk ia ka dal ta marrë rolin e "kujdestarit" të duhur.

Një ndër kushtet kryesore për një mision të suksesshëm është një vizion i qartë mbi statusin përfundimtar politik dhe ekonomik të territorit të administruar. "Asnjë administratë ndërkombëtare nuk mund të funksionojë pa pasur një vizion politik, të nënkuptuar ose të deklaruar, për shoqërinë që e administron"[4] Në rastin e Timorit Lindor Sllavonisë Lindore dhe Bosnës, qëllimi përfundimtar pak a shumë ishte i qartë. Statusi i pazgjidhur i Kosovës, në anën tjetër, në mënyrë të vazhdueshme e politizon procesin paqësor dhe nxit lëvizjet radikale. Tabuja e kësaj teme është thyer në fund të vitit 2002 me një konferencë rajonale të organizuar nga një OJQ e pavarur amerikane që shpejt ka qenë e pasuar me iniciativa të ndryshme. Kjo çështje vazhdon t'i ndajë komunitetet, mbjellë frikë dhe vështirësojë përpjekjet për ndërtimin e paqes. Duke e parashikuar

krizën, komunitetet vazhdojnë të mbyllen në mesin e tyre, duke i etiketuar Kombet e Bashkuara si të njëanshme, dhe në këtë mënyrë e shtyejnë përpara kohezionin shoqëror dhe homegjenizimin e secilit grup me ndjenjën psikologjike se akoma mbetet dinamika e konfliktit të vitit 1999.

Një çështje e rëndësishmë lidhur me kompletimin e misionit është ajo e nivelit të përfshirjes së aktorëve të ndryshëm. Kjo përfshirje dhe natyra e implementimit të saj mbështetet në (a) strukturën organizative të KB-së, (b) natyrën e misionit dhe (c) mundësitë për aktivizimin e personelit. Duke e ushtruar mandatin e vet, Kombet e Bashkuara janë përhapur thellë ne shoqërinë kosovare. Sidoqoftë, natyra e këtij bashkëveprimi nuk është imune ndaj kritikave. Në të vërtetë, një nga ankesat e para rreth misionit është mungesa e njohurisë mbi Kosovën në mesin e atyre që kanë për detyrë ta administrojnë rajonin. Ndryshe nga strategjia koloniale britanike që është bazuar në përpjekjet për ta kuptuar komunitetin të cilin e ka qeverisur, misioni i KB-së ka bërë pak në pranimin e punës së komunitetit ose të udhëheqësisë lokale, derisa në të njejtën kohë ka gëzuar imunitet absolut nga përgjegjësia ligjore dhe politike.

Mungesa e transferimit të autoritetit në strukturat lokale ka përshkruar të gjitha nivelet e qeverisjes të varura nga strukturat ndërkombëtare. Kjo ka krijuar një varshmëri të lartë nga Kombet e Bashkuara. Siç edhe është vërejtur me të drejtë nga Caplani: "Transferimi i hershëm gjithashtu ndihmon në parandalimin e ekuivalentit administrativ të varshmërisë nga ndihmat, meqë rast popullata lokale mësohet që përfaqësuesit ndërkombëtar të vendosin për ta, duke përfshirë disa vendime më të vështira që si rezultat ata mund të zgjedhin që t'i injorojnë."[5] Kjo varshmëri ka inkurajuar një kulturë të pasivitetit. Autoritetet lokale ishin të përjashtuar nga çdo përgjegjësi vendimmarrëse. Këtu mund të ngritet argumenti që autoritetet lokale do të duhej të lejoheshin që të gabojnë bile edhe në dëm të komunitetit të vet si përfaqësues të zgjedhur me zgjedhje të lira. Qëndrimi i Kombeve të Bashkuara ka qenë se ata duhet të mentorohen për një përiudhë më të gjatë kohore me argumentin se ata akoma nuk janë të pjekur apo toleran sa duhet.

Argumenti rreth nivelit të përfshirjes gjithashtu shtrihet edhe në autorizimet gati diktatoriale të Përfaqësuesit të Posaqëm të Sekretarit të Përgjithshëm (PPSP). Mëgjithëse përdorimi i një përfaqësuesi fuqiplotë ka qenë më i paktë se në Bosne, ku radikalët fitonin zgjedhjet në mënyrë të vazhdueshme, kritikat janë shtruar bile edhe nga ndërkombëtarët si Ombudspersoni i Kosovës. Duke e shkelur Kartën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, të zbatueshme në Kosovë, shumë njerëz janë mbajtur në paraburgim me urdhër të posaqëm të PPSP-së me muaj të tërë dhe janë liruar më vonë për shkak të mungesës së dëshmive. Në vend se të shërbejë si model për demokraci në një vend ku ajo ka munguar, autorizimet e PPSP-së kanë dëmtuar në mënyrë të dukshme integritetin dhe kredibilitetin e administratës së Kombeve të Bashkuara.

Autorizimet e larta gjyqësore të bashkësisë ndërkombëtare nga komuniteti dhe udhëheqësia kosovare janë kuptuar si politike për nga natyra. Mendimi i kosovarëve është se administrata ndërkombëtare ka qenë shpesh politikisht e orientuar dhe e një-anshme

për nga ndikimi i saj. Derisa komuniteti serb shpesh e ka akuzuar UNMIK-un për qëndrimet pro-shqiptare dhe që ka bërë pak për kthimin e serbëve të zhvendosur, shqiptarët shpesh e kanë akuzuar atë për margjinalizim të forcave të zgjedhura politike dhe shtyerjen e Kosovës drejt Serbisë dhe bllokimin e funksionimit të institucioneve të saj gjoja për shkak të ndjeshmërisë politike. Ndonëse roli i administratës ndërkombëtare në Kosovë parasheh detyrën për ta përgatitur rajonin për zgjidhjen e statusit përfundimtar, nuk është e qartë nëse ekziston ndonjë rol i nënkuptuar në ndikimin e rezultatit të përgjithshëm politik.

Përgatitja e rajonit për statusin përfundimtar dhe mosdhënia e ndonjë drejtimi politik e lë vetëm një rrugë të hapur për të ardhmen e afërt: ndihmën për themelimin e institucioneve lokale të qeverisjes në të gjitha nivelet dhe ndërtimin e ekonomisë. Një transfer më i shpejtë i kompetencave është kyq dhe paraqet një evolucion natyral të një misioni të tillë të përkohshëm. Kanë ekzistuar opinione të ndryshme në bashkësinë ndërkombëtare lidhur me qëndrimin e tyre drejt strukturave ekzistuese lokale si të paligjshme, të paqena, joadekuate, ose jodemokratike. Përkundër mungesës së vizionit dhe vullnetit politik për krijimin e tij, objektivi primar "i një regjimi tranzicional duhet të jetë autorizimi i popullatës lokale për udhëheqjen e punëve të veta."[6] Për shkak të vizionit politik të administratës, kjo është konsideruar si problematike pasi që vetë ndërtimi i institucioneve është konsideruar që do të sjellë aktin e kryer ku kosovarët do të ishin të aftë për udhëheqjen e punëve të veta dhe si rrjedhojë nuk do të ishin aq të ndikuar nga presioni ndërkombëtar.

Mungesa e përfshirjes lokale ka përjashtuar përgjegjësinë formale dhe joformale të udhëheqësisë kosovare. Administrata ndërkombëtare raporton vetëm para Këshillit të Sigurimit dhe shteteve anëtare, duke mos i dhënë kompetenca liderëve lokal, duke rikrijuar kështu mungesën e përfshrijes dhe përgjegjësisë që kosovarët e përjetuan më vite nën udhëheqjen jugosllave. Kjo është manifestuar në zgjedhjet fundit, si një barometër i dobishëm i të priturave të shoqërisë kosovare lidhur me forcën e vetë për ndryshim. Përkundër euforisë gjithpërfshirëse në Kosovë pas luftës, pjesëmarrja në zgjedhje ka rënë tri vjet pas luftës në më pak se 50%. Një mungesë e tillë e pjesëmarrjes se votuesve kryesisht mbështetet në mendimin e kosovarëve se strukturat lokale nuk kanë kurrëfarë përgjegjësi ose kompetenca.

Siq pohon Darby, "…në një shoqëri të ndarë, përgjegjësia e brendshme për siguri menjëherë etiketohet si e njëanshme, kurse ajo e jashtme, trupat multinacionale mund të shërbejnë si fajtor kujdestar për politikat e jopopullarizuara."[7] Politikanët kosovar shpesh e kanë te lehtë që të përdorin fajësimin e UNMIK-ut për dështime si rrugëdalje ose ia lejnë UNMIK-ut marrjen e vendimeve më ndjeshmëri politike. Pjesëmarrja rekorde e ulët e votuesve në vjeshtë të vitit 2002 pjesërisht mbështetet në nivelin e ulët të kompetencave të elitës lokale politike. Kjo përgjegjësi gjithashtu është dobësuar pjesërisht edhe në anën tjetër nga përçarjet e mëdha në mes të të zgjedhurve politik dhe administratës. Qytetarët kosovarë, të cilët nuk janë të mësuar që të kërkojnë transparencë dhe përgjegjësi shpesh shprehin dëshprimin me modelin e parë të

"demokracisë" që e shohin për nga afër.

Kjo jo vetëm që i lë politikanët lokal pa përgjegjësi (dhe pa autorizime), por gjithashtu i ka vështirësuar marrëdhëniet më përfaqësuesit e komuniteteve lokale, të cilëve shpesh iu është lejuar që të krijojnë politika në nivelin lokal sipas dëshirës së tyre, që për rrjedhojë ka pasë mënyra të ndryshme të menaxhimit të komunave varësisht nga aftësitë, përvoja dhe tradita e administratorëve ndërkombëtar të komunave.

Në përgjithësi, kosovarët e kanë pranuar UNMIK-un, por kurrë nuk e kanë ndier si të vetin. Ata e shikuan atë si politike, të fshehtë dhe të papërgjegjshme në çfarëdo mënyre ndaj komunitetit lokal. "Ideja e udhëheqjes ndërkombëtare mbi një territor të huaj mund të jetë legjitime vetëm nëse ajo udhëheqje ushtrohet në emër të, ose për të mirën e popullatës lokale."[8] Nëse mbështetemi në këtë definicion, legjitimiteti i UNMIK-ut është i dyshimtë me te madhe, pjesërisht për shkak të mandatit të imponuar nga lart, por gjithashtu edhe për shkak të mënyrës se si është implementuar. Disa kosovarë madje kanë fillluar t'i etiketojnë disa veprime të UNMIK-ut si neo-koloniale.

Në pikëpamje operative, një nga çështjet që përmenden në pjesët në vazhdim të ketij punimi janë politikat parimore mbi personelin e organizatave ndërkombëtare. Këto organizata shpesh janë të paafta për rekrutimin e numrit të nevojshëm të stafit kualitativ nga shtetet anëtare, që ose nuk kanë tepricë të gjykatësve dhe policëve ose mekanizmat e tyre të brendshëm e vështirësojnë dërgimin e tyre në terren.

Një nga kritikat kryesore të pjesës civile të paqeruajtjes është mungesa e planifikimit. Ndryshe nga komponenti ushtarak që e kishte një mbështetës kryesor, NATO në përgjithësi, dhe Britaninë dhe SHBA-të në veçanti, Kombet e Bashkuara e shikuan si politikisht të ndjeshëm planifikimin e hershëm. UNMIK-u dështoi në planfikimin e misionit të vet përderisa, "dokumenti i parë i planifikimit strategjik nuk është nxjerrë deri më 5 dhjetor 1999, gjashtë muaj pas fillimit të misionit."[9] Caplani gjithashtu përfundon se "organizata shumë rrallë është e përgaditur për më të keqen, misionet planifikohen ngutazi dhe mbështetja për to është e pamjaftueshme për një kohë të gjatë pas vendosjes të tyre."[10] Pasi që sistemi ndërkombëtar është i përbërë nga shtetet si njësi themelore, ekziston një tendencë natyrale për të lëvizur kundër këtij trendi si kërcnim ndaj sistemit shtetëror. Prandaj, ekzistojnë pengesa që janë rrjedhojë e: (a) rrethanave politike, (b) strukturës organizative dhe mungesës së planfikimit në mes të departamenteve dhe (c) paaftësia e koordinimit me strukturat lokale në terren.

Mbase njëri ndër rekomandimet më të rëndësishme të këtij punimi është që KB-ja duhet të planifikojë me kohë madje edhe për krizat që nuk mund të ndodhin. Standardet për administrata ndërkombëtare të territoreve të shkatërruara nga lufta, siç është Kosova, dhe të shteteve të dështuara duhet të zhvillohen në të njejtën mënyrë si për operacione ushtarake dhe humanitare. Nëse planifikimi i hershëm nuk është i mundur, hulumtimi dhe kundërzbulimi i vazhdueshëm në zonat e konfliktit mbetet si opcion. DPA dhe DPKO duhet të themelojnë një zyre të përbashkët që kryen hulumtime mbi ekonominë, politikën, drejtësinë dhe një mori çështjesh tjera mbi disa situata të ndryshme të krizave në botë.

Korniza ligjore e Kosovës nën administrimin e përkohshëm të kombeve të bashkuara

Ligji i zbatueshëm: Teoria dhe Praktika

Në bazë të Rezolutës 1244 (1999) Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara autorizoi Sekretarin e Përgjithshëm që të krijojë një mision ndërkombëtar civil të njohur si Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkura në Kosovë (UNMIK) me mandatin që "të sigurojë një administratë të përkohshme për Kosovën nën udhëheqjen e së cilës populli i Kosovës do të gëzojë autonomi substanciale në kuadër të RFJ-së, dhe do të sigurojë administratë kalimtare derisa të formohen institucionet demokratike vetëqeverisëse për të krijuar kushtet për një jetë normale dhe paqësore për të gjithë banorët e Kosovës."[11]

Rezoluta është rezultat i përpjekjeve diplomatike para dhe gjatë fushatës ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë (24 mars deri më 10 qershor 1999). Përkundër dështimit të arritjes së marrëveshjes paqësore në Rambouillet, ofensiva e ushtrisë Jugosllave kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (që shkaktoi zhvendosjen e përafërsisht gjysmës së popullsisë së Kosovës), dhe fushatës pasuese ajrore të NATO-s, përpjekjet diplomatike rezultuan me zgjidhjen politike të konfliktit që e mënjanoi intervenimin me forcë të trupave tokësore të NATO-s në Kosovë. [12]

Në fillim të qershorit të vitit 1999, i dërguari i Bashkimit Europian, Z.Martti Ahtisaari, dhe i dërguari i Kryetarit të Federatës Ruse, z. Victor Chernomyrdin, ia dorëzuan një plan qeverisë jugosllave për zgjidhjen paqësore të konfliktit.[13] Plani paqësor ishte përgatitur nga ministrat e punëve të jashtme të Grupit G-8 më 6 maj 1999 dhe parashikonte krijimin e administratës kalimtare për Kosovën nën përkujdesjen e Kombeve të Bashkuara.

Më 2 qershor 1999, qeveria jugosllave e pranoi planin paqësor dhe gjithashtu u pajtua për ngritjen e pranisë ndërkombëtare civile dhe të sigurisë të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Rezoluta përfshinte planin paqësor dhe themeloi UNMIK-un si një mision paqëruajtës[14] për të siguruar një administratë të përkohshme për Kosovën, në pritje të një procesi politik dhe zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës.

Mëgjithëse nuk shprehet qartë në rezolutë, mandati për të siguruar një administratë të përkohshme për popullin e Kosovës nënkupton autorizimin për të nxjerrë ligje. Duke u mbështetur në rezolutë, Përfaqësuesi i Posaqëm i Sekretarit të Përgjithshëm (PPSP) në Kosovë në aktin e parë legjislativ të UNMIK-ut, Rregullorja Nr. 1999/1 e 25 korrikut 1999, përcaktoi që të gjitha autorizimet legjislative dhe ekzekutive në lidhje me Kosovën, duke përfshirë edhe administrimin e gjyqësisë, i jipen UNMIK-ut dhe ushtrohen nga PPSP.[15] Në ushtrimin e detyrave të dhëna UNMIK-ut, PPSP do të nxjerrë akte legjislative në formë të rregulloreve.[16]

Sidoqoftë, kur Kombet e Bashkuara hynë në Kosovë, Kosova nuk ishtë një "zonë pa

ligje". Këshilli i Sigurimit mbajti sovranitetin e Republikës Federale të Jugosllavisë mbi Kosovën dhe në lidhje me atë sovranitet, UNMIK-u siguroi se ligjet jugosllave të zbatueshme në territorin e Kosovës para 24 marsit të vitit 1999, duhet të vazhdojnë të zbatohen përderisa nuk janë në kundërshtim me standardet e pranuara ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut, me përmbushjen e mandatit të dhënë UNMIK-ut ose më cilëndo rregullore të miratuar nga UNMIK-u.[17] Legjislacioni lokal përfshin legjislacionin e Federatës jugosllave, të Republikës së Serbisë dhe të Krahinës së Kosovës.

Një vendim preciz mbi konfliktin në mes të legjislacionit lokal dhe legjislacionit të UNMIK-ut u paraqit disa muaj më vonë nëpërmjet Rregullores Nr. 1999/24 të UNMIK-ut më 12 dhjetor të vitit 1999 mbi ligjin e zbatueshëm në Kosovë. Me këtë rast, PPSP përcaktoi se në rast të konfliktit, rregulloret dhe instrumentet tjera të lëshuara nga UNMIK-u duhet të kenë përparësi para legjislacionit lokal në fuqi.[18]

Sidoqoftë, nevoja reale për lëshimin e rregullores në fjalë, ishte shkaktuar nga refuzimi i gjykatësve dhe prokurorëve publik për të zbatuar legjislacionin lokal, që ishte në fuqi më 24 mars 1999. Ata e konsideronin këtë legjislacion si diskriminues ndaj popullatës shqiptare të Kosovës pasi që ishte nxjerrë pas shfuqizimit të statusit autonom të Kosovës që do të thotë pa pjesëmarrjen e Kosovës në procedurat përkatëse ligjislative.[19] Komuniteti lokal juridik filloi me zbatimin e legjislacionit, që ishte në fuqi para suspendimit të autonomisë së Kosovës, veçanërisht në rastet penale. Me qëllim të menjanimit të dallimeve në mes të "ligjit në libra" dhe "ligjit në veprim" PPSP vendosi që të kodifikojë praksën e përshkruar ligjore duke përcaktuar se përveç akteve ligjore të UNMIK-ut, ligjislacioni i zbatueshëm në Kosovë duhet gjithahstu të përfshijë edhe ligjin në fuqi më 22 mars 1989.[20] Vetëm nëse ndonjë situatë nuk ka qenë e përfshirë nga legjislacioni në fjalë, ligjet në fuqi pas 22 marsit 1989 mund të zbatohen përderisa nuk kanë qenë diskriminuese ose në kundërshtim me standardet e pranuara ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut.[21] Kjo shtesë që mirret me ligjislacionin lokal të zbatueshëm demonstron përfshirjen e pamjaftueshme të komunitetit lokal juridik në kohën kur UNMIK-u vendosi mbi legjislacionin e zbatueshëm.

Nga pikëpamja teorike definicioni i legjislacionit të zbatueshëm dukej se ishte i qartë. Por nga pikëpamja praktike nuk ishte ashtu. Pas vendosjes së pranisë ndërkombëtare civile në Kosovë, anëtarët e stafit ndërkombëtar nga shtetet e ndryshme pa trajnim paraprak ose pa përvojë adekuate në dhënien e shërbimeve administrative nën udhëheqjen e Kombeve të Bashkuara ishin të përballur me nevojën e rikthimit të qetësisë dhe sigurisë publike, duke përfshirë luftën kundër strukturave kriminele. Në këtë rast shumë persona ishin të arrestuar dhe mbajtur në paraburgim. Sidoqoftë, në këtë fazë nuk ekzistonte absolutisht kurrëfarë njohurie mbi legjislacioni e zbatueshëm në Kosovë në bazë të të cilit mund të urdhërohej dhe ekzekutohej paraburgimi. Policët nga shtetet e ndryshme me përvojë të ndryshme ligjore zbatuan principet ligjore me të cilat ishin mësuar të punonin në shtetet e tyre.

Kjo situatë nuk u përmirësua dukshëm në muajt vijues. Juristët ndërkombëtar, kryesisht këshilltarë të sjellur në Kosovë për përgatitjen e drafteve legjislative brenda një afati rel-

ativisht të shkurtër kohor, nuk i kushtonin vëmendje të mjaftueshme legjislacionit lokal dhe si rrjedhojë përgatitnin legjislacion që vështirë do të përshtatej me sistemin ekzistues ligjor. Arsyja kryesore për një sjellje të tillë janë informatat e pamjaftueshme mbi legjislacionin lokal të zbatueshëm për shkak të vështirësive në qasjen në burimet zyrtare mbi legjislacionin e tillë. Gazetat Zyrtare, që përmbanin ligjet relevante, ose ishin humbur ose shkatërruar gjatë konfliktit të armatosur. Poashtu, mosnjohja e gjuhës Shqipe ose Serbe ishte pengesë kryesore për juristët ndërkombëtar për ta kuptuar legjislacionin lokal. Madje edhe tani, tri vite pas vendosjes së Misionit, ende nuk ekziston një bazë e të dhënave me legjislacionin lokal, megjithëse instutucionet si Qendra Juridike e Kosovës, ish Departamenti Administrativ i Shërbimeve Publike dhe OSBE-ja e përmirësuan nivelin e informimit përmes grumbullimit të ligjeve dhe publikimeve tjera. [22]

Legjislacioni i UNMIK-ut në mes të sistemit kontinental dhe atij anglo-sakson

Në mes të qershorit të vitit 1999 dhe shtatorit të vitit 2002 UNMIK-u miratoi 144 rregullore dhe 86 urdhëresa administrative që përfshijnë të gjitha fushat ligjore, si ligjin penal, ligjin civil/komercial dhe ligjin publik/admistrativ.[23] Ky aktivitet legjislativ kishte një ndikim të madh në sistemin ligjor të Kosovës, në veçanti në lidhje me sistemin civil ligjor. Përkundër të gjitha elementeve socialiste, sistemi ligjor i Kosovës si pjesë e sistemit të përgjithshëm jugosllav klasifikohet se i takon sistemit civil kontinental të bazuar në Ligjin Romak. Legjislacioni civil përfshijnë në mesin e ligjeve tjera specifike Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve,[24] Ligjin mbi Marrëdhëniet Pronësore,[25] Ligjin e Procedurës Civile,[26] duke e pasqyruar kështu sistemin klasik të ligjeve civile.

Me përfshirjen e një numri të jursitëve ndërkombëtar me përvojë në sistemin ligjor anglo-sakson në aktivitetet legjislative të UNMIK-ut, dhe duke marrë parasysh mungesën e lartëpërmendur të njohurisë mbi sistemin ligjor të Kosovës, UNMIK miratoi legjislacion në shumë fusha, që qartazi ishte i bazuar në principet ligjore të sistemit anglo-sakson, siq janë p.sh. rregullorja mbi organizatat afariste ose rregullorja mbi pengjet. Në fushën e ligjit të kontratave, UNMIK thjeshtë e transformoi Konventën e Kombeve të Bashkuara për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave në ligjin vendor të kontratave pa e kuptuar nevojën për harmonizim të këtij legjislacioni me pjesën tjetër të sistemit ligjor.[27] Kjo qasje jo vetëm që e përhapi terminologjinë ligjore të sistemit anglo-sakson që ishte e panjohur për juristët e arsimuar në ligjin civil kontinental (p.sh. termi *"kolateral"* në kontekst të pengjeve dhe hipotekave) por gjithashtu shkaktoi edhe papajtueshmëri dhe kundërthënie, që në fund shkaktuan pasiguri ligjore.

Ky rezultat gjithashtu mbështetej në politikë legjislative të ndjekur nga UNMIK-u, e cila bazohej në rregullimin e veçantë të çështjeve të posaqme (siq janë pengjet) duke e mënjanuar rregullimin e përgjithshëm dhe përfundimtar të çështjeve (si p.sh. rregullimi i çështjes së pengjeve në kontekst të Ligjit të Përgjithshëm të Pronës).[28] Kjo politikë legjislative është e kuptueshme kur mirret parasysh se UNMIK-u e konsideronte veht-

en vetëm si një administratë kalimtare dhe për këtë arsye nuk preferonte ndërrmarjen e operacioneve të komplikuara legjislative, siq është përpilimi i Kodit Civil për Kosovën.

Legjislacioni i Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes

a. Kompetencat e rezervuara dhe përgjegjësitë e transferuara

Më 15 maj të vitit 2001, UNMIK-u miratoi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (IPV-Institucionet Përkohshme të Vetëqeverisjes) në Kosovë përpiluar nga ekspertë ndërkombëtar dhe lokal duke themeluar kështu institucionet e përkohshme qeverisëse, duke përfshirë Kuvendin e Kosovës, Qeverinë dhe Zyren e Presidentit të Kosovës (UNMIK Rregullorja Nr. 2001/19). Sidoqoftë, autorizimet e PPSP-së mbi IPV-në janë të shprehura në kapitullin 8.1 të Kornizës Kushtetuese, që autorizon PPSP-në që ta shpërndajë Kuvendin e Kosovës dhe të thërret zgjedhje të reja në rrethana kur mendohet se IPV ka vepruar në mënyrë të tillë që nuk është në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.[29] Po ashtu, Korniza Kushtetuese në mënyrë të qartë cek se ushtrimi i përgjegjësive të IPV nën Kornizën Kushtetuese nuk e pakëson ose ndikon në autoritetin e PPSP për të siguruar implementim të plotë të Rezolutës 1244 (1999), duke përfshirë mbikqyrjen e IPV-së, zyrtarëve dhe organeve të saj.[30]

Me Kornizën Kushtetuese, PPSP i dorëzoi disa përgjegjësi të caktuara IPV-së në drejtim të përgatitjes së ligjeve, për shembull në fushat e arsimit, rinisë, kulturës, punës dhe mirëqenies sociale, transportit dhe telekomunikacionit, administratës publike, agrikulturës, planifikimit hapësinor dhe mbrojtjes së ambientit, tregtinë dhe industrinë vendore dhe të jashtme, statisikën, turizmin si dhe qeverisjen e mirë dhe të drejtat e njeriut.[31] Në këto fusha si Qeveria ashtu edhe Kuvendi kanë të drejtën që të inicojnë dhe miratojnë ligje dhe rezoluta, në mënyrë që rezolutat të jenë deklarata të pa-obligueshme.[32] Posa legjislacioni të adoptohet nga Kuvendi si organi më i lartë legjislativ i IPV-së ai hyn në fuqi vetëm nëse nënshkruhet që do të thotë miratohet nga PPSP.[33] Një zyrtar i lartë i UNMIK-ut shpjegon këtë lloj të kompetencës legjislative të PPSP-së si ushtrim të përgjegjësisë legjislative për dhe nën autoritetin e PSPP-së.[34] Principi i njejtë zbatohet edhe në marrëveshjet ndërkombëtare, që mund të përgatiten nga IPV-ja nëse tema në fjalë bie nën përgjegjësitë e saj siq referohet në Kapitullin 5 të Kornizës Kushtetuese.[35]

Në anën tjetër, PPSP mban disa kompetenca të ashtuquajtura të rezervuara, ku PSPP ka autorizimin e vetëm dhe ekskluziv legjislativ. Këto fusha përfshijnë, përveç tjerash, çështjet e lidhura me sovranitet, siç janë marrëdhëniet e jashtme, administrimi i pronës publike, shtetërore dhe shoqërore, hekurudhat dhe aviacioni civil, kontrollin mbi bazën e të dhënave të regjistrit civil, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me emërimin dhe shkarkimin e gjykatësve dhe prokurorëve publik, mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe bashkëpunimi me KFOR-in, zbatimi i qetësisë dhe sigurisë publike, emergjenca civile

dhe gatishmëria e sigurisë.[36]

Dallimi në mes të përgjegjësive legjislative të transferuara te IPV dhe kompetencave të rezervuara për PPSP-në, si dhe "formulimi i hapur" dhe i paqartë i dispozitave relevante në Kornizën Kushtetuese rreth asaj se cila fushë është transferuar dhe cila jo, u paraqit si njëri ndër burimet kryesore të konfliktit në mes IPV dhe UNMIK-ut sa i përket implementimit të Kornizës Kushtetuese. Shembulli i 23 shkurtit të vitit 2001 i marrëveshjes bilaterale të përcaktimit të kufirit në mes të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (IRJM) mund të ilustrojë përmasat e këtij problemi.

Me qëllim të mënjanimit të mosmarrëveshjeve të kësaj natyre në të ardhmen, UNMIK dhe IPV kanë themeluar- së paku për legjislacionin ekonomik, fiskal dhe komercial- nën ombrellën e Këshillit Ekonomik dhe Fiskal principet e para dhe fillestare për qartësimin e temave që bien nën përgjegjësitë e rezervuara/transferuara dhe për bashkëpunim në çështjet legjislative. Megjithëse kjo çështje është vendimtare në implementimin e ardhshëm të Kornizës Kushtetuese dhe transferit të mëtutjeshëm të përgjegjësive në IPV, qartësia ligjore dhe koordinimi efektiv, akoma janë larg arritjes së qëllimit.

Studim i rastit: Vija kufitare

Vija kufitare në fjalë ishte vija kufitare në mes të Kosovës dhe IRJM. Rezultati i marrëveshjes ishte që përafërsisht 2400 hektarë të tokës që i takonin Kosovës të transferohen IRJM-së. IPV konsideronte këtë marrëveshje si shkelje të integritetit territorial të Kosovës që mbrohej me Rezolutën 1244 dhe Kapitullin 1.2 të Kornizës Kushtetuese.[1] Pasi që Këshilli i Sigurimit e pranoi marrëveshjen kufitare në mes të RFJ dhe IRJM, Kuvendi i Kosovës më 23 maj 2002 miratoi një rezolutë me të cilën nuk e njohu marrëveshjen kufitare dhe deklaroi ndikimet e saj si të paligjshme dhe të pavlefshme për Kosovën (Kuvendi i Kosovës 2002). Argumenti kryesor i tij ishte se populli i Kosovës nuk është konsultuar për këtë çështje dhe se kufijtë e Kosovës nuk do të duhej të ndëroheshin pa pajtimin e popullit të Kosovës, argumente që e kanë bazën në parimet e pranuara ndërkombëtarisht për vetë-vetëndosjen e brendshme të popujve.Në një reagim të menjëhershëm për miratimin e rezolutës nga Kuvendi, PPSP e shpalli rezolutën të pavlefshme. Vendimi i PPSP ishte i bazuar në argumentin se IPVQ kanë të drejtë që vetëm të miratojnë rezoluta që janë nën përfshirjen e kapitullit 5 të Kornizës Kushtetuese. Pasi që "integriteti territorial" nuk përfshihej në Kapitullin 5 por përmendej në Kapitullin 2, IPVQ formalisht nuk e kishin autorizimin e lëshimit të rezolutës për këtë çështje. Kjo mosmarrëveshje mund të përshkruhet si konflikt në mes të formalitetit ligjor kundër vetë-vendosjes së brendshme. Situata mbeti ashtu si ishte: marrëveshja kufitare ende nuk është implementuar, IPVQ ende qëndron me rezolutën e Kuvendit dhe UNMIK-u e konsideron rezolutën e Kuvendit jo-ekzistente.

b. Harmonizimi i legjislacionit kosovar me *Acquis Communautaire*

Një aspekt tjetër, që e karakterizon Kornizën Kushtetuese në lidhje me legjislacionin, është zotimi i IPVQ për t'ju afruar intergrimit evropian. Në pajtim me Kapitullin 5.7 të Kornizës Kushtetuese, IPVQ janë përgjegjëse për përshtatjen e legjislacionit të tyre në të gjitha fushat e përgjegjësisë me të gjitha standardet dhe normat relevante Europiane. Kjo dispozitë përmban një obligim të qartë kuazi-kushtetues për harmonizimin e legjislacionit Kosovar me *acquis communautaire* të Bashkimit Europian.

Me këtë dispozitë, Korniza Kushtetuese e Kosovës është bërë teksti më i përparuar kushtetues në Gadishullin Ballkanik. Në praktikë, sidoqoftë, IPVQ nuk e posedon kapacitetin dhe burimet e nevojshme që në të vërtet ta ndërmarrin harmonizimin e kërkuar. Në këtë kontekst, Bashkimi Europian ka ofruar mbështetjen e vet duke dhënë ndihmë legjislative dhe administrative nëpërmes institucioneve të ndryshme si Agjensioni Europian për Rindërtim, Shtyllës së IV-të të UNMIK-ut (BE-së) dhe zyrës së sapo krijuar. Problemi kryesor që mund të paraqitet në kontekst të harmonizimit me standardet e BE, është kapaciteti i pazhvilluar dhe mungesa e burimeve të mjaftueshme në anën Kosovare për të ndërmarrë harmonizimin në mënyrë vetanake, pa nevojë të mbështetjes në burimet jashtë Kosovës. Ndërtimi i kapaciteteve në këtë fushë është i një rëndësie të veçantë për të mbështetur procesin e qëndrueshëm të integrimit në strukturat e BE.

c. Disa aspekte për praktikat e tanishme legjislative

Pasi që IPVQ janë institucione tani vonë të formuara identifikimi i praktikave dhe standardeve legjislative kur kemi të bëjmë me përpilimin dhe procesimin e legjislacionit është i vështirë. Sidoqoftë, në muajt e parë pas krijimit të tyre mund të vërehet që iniciativa legjislative është në anën e Qeverisë e jo në atë të Kuvendit. Faktikisht, Kuvendi merr një rol mjaft pasiv në këtë drejtim, duke e kritikuar Qeverinë për mospërgatitje të shpejtë të draft legjislacionit por duke dështuar që në çfarëdo mënyre të ushtrojë të drejtën e vet për iniciativë legjislative

Një aspekt tjetër që vlen të përmendet është çështja e këshilltarëve juridik ndërkombëtar të financuar nga organizata të ndryshme të huaja që janë të përfshira në përpilimin dhe procesimin e procedurës si në Qeveri ashtu edhe në Kuvend dhe që kryesisht përqëndrohen në legjislacionin komercial dhe atë ekonomik. Legjislacioni në këtë fushë përpilohet kryesisht nga ata këshilltar ndërkombëtar që e ofrojnë produktin përfundimtar me pjesëmarrje të vogël të juristëve lokal, të punësuar në IPV dhe pa mundësuar kështu ndërtimin e kapaciteteve për juristët lokal, në mënyrë që ata vetë të aftësohen që të përpilojnë një legjislacion të tillë.

Karakteristika e tretë që duhet të merret parasysh është ajo e numrit të madh të organizatave ndërkombëtare jo-qeveritare (OJQ) dhe organizatave të përfshira në strukturat administrative të Kuvendit përmes "programeve për ndërtimin e kapaciteteve" për shërbimin civil të Kuvendit dhe për anëtarët e Kuvendit. Ligjëratat e ofruara nga ekspertët dhe këshilltarët ndërkombëtar, vizitat studimore në institucionet e huaja

legjislative, si dhe shërbimet këshilldhënëse janë elementet kryesore të këtyre programeve. Në njërën anë, këto programe i ndihmojnë si zyrtarëve civil ashtu edhe anëtarëve të Kuvendit që të njihen me funksionimin e një Kuvendi. Në anën tjetër, programet shpesh nuk janë të përshtatura rrethanave dhe nevojave specifike të Kuvendit të Kosovës.

Deri më tani, gjithashtu nuk ekziston kurrëfarë programi i qëndrueshëm i ndërtimit të kapaciteteve në fushën e potencialit njerëzor, menaxhimit të administratës dhe të infrastrukturës teknike. Efekti më i rrezikshëm i një përfshirjeje kaq intenzive të OJQ-ve të huaja dhe organizatave tjera në punët ditore të Kuvendit (disa OJQ mund të marrin pjesë bile edhe në punimet e komiteteve të Kuvendit), sidoqoftë, është mundësia e tyre e pakontrolluar dhe direkte për të ndikuar te anëtarët e Kuvendit gjatë procesit të marrjes së vendimeve politike. Kjo situatë përfshin rrezikun që anëtarët e Kuvendit të mos e përfillin elektoratin por OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare financiarisht të forta, situatë që është diskutabile nga pikëpamja demokratike.

1.4. Rekomandimet mbi politikat

Themelimi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor disa muaj pas themelimit të UNMIK-ut tregon se të dy modelet kanë një strukturë gati identike organizative, me të njejtat kompetenca të gjera legjislative, me të njëjtat politika dhe teknika që mund të shërbejnë si model për misionet e ardhshme të përkohshme të Kombeve të Bashkuara.[37] Përvoja legjislative e fituar në Kosovë shumë mirë mund të shërbejë si "modul i mësimeve të mësuara" për misionet e ardhshme.

Një problem kryesor që është identifikuar në këtë analizë të shkurtër është **njohuria e pamjaftueshme rreth sistemit lokal ligjor**. Shumë vështirë mund të imagjinohet që Kombet e Bashkuara të kenë kapacitetin administrativ për të krijuar baza të të dhënave mbi ligjet për secilin shtet dhe të mbajnë njësi të juristëve të trajnuar dhe me përvojë që do të "parashutoheshin" në vendin ku misoni i përkohshëm i Kombeve të Bashkuara instalohet. **Zgjidhja e preferuar do të ishte krijimi i Kodit Penal të Kombeve të Bashkuara dhe Kodit Administrative të Kombeve të Bashkuara**, të cilat do të zbatoheshin kurdo që Kombet e Bashkuara duhet ta administrojnë një territor.

Rregulli i konfliktit të ligjeve siç është i zhvilluar nga UNMIK-u në lidhje me legjislacionin lokal shumë mirë mundet të zbatohet si rregull e përgjithshme **për përcaktimin e marrëdhënieve në mes të Kodeve të KB dhe ligjeve përkatëse lokale**. Duke pasë parasysh se Kodet e tilla të KB mund ta kenë rrezikun që nuk janë plotësisht të pajtueshme me legjislacionin vendor, që do ta mënjanonte paqartësinë ligjore, që paevitueshëm ekziston në kontekst të secilës administratë të përkohshme të Kombeve të Bashkuara. **Paqeruajtësit mund të trajnoheshin për këto kode dhe duke i zbatuar ato në mënyrë të duhur**, ata do të siguronin standardet e pranuara ndërkombëtarisht për sundimin e ligjit.

Kurdo që Kombet e Bashkuara e kanë mandatin për nxjerrjen e ligjeve në një vend, tra-

ditat dhe sistemet lokale duhet të rrespektohen. Një përzierje konfuze në mes të elementeve të sistemit anglo-sakson dhe atij kontinental civil, siq ekziston në Kosovë, nuk duhet të përsëritet. **Në vende ku dominon tradita kontinentale e ligjit civil, Kombet e Bashkuara duhet të dërgojnë juristë të trajnuar në ligjin civil kontinental dhe në vende me sistem anglo-sakson të dërgojë juristë me pregatitje në sistemin ligjor anglo-sakson**.

Në përgjithësi, Kombet e Bashkura duhet ta **rishikojnë qasjen e tyre paqeruajtës**e dhe të kalojnë nga **angazhimi që fillimisht ishte më shumë ushtarak në një qasje më administrative**. Paqëruajtësit e ardhshëm duhet të kenë karakterin e administratorëve publik, kontabilistëve dhe juristëve në vend të atij të ushtarit. Tani është koha që Kombet e Bashkuara të fillojnë të bëjnë ndryshime serioze në qasjen dhe organizimin e tyre në mënyrë që t'i përballojnë sfidat e ardhshme të paqeruajtjes.

Menaxhimi i sigurisë së brendshme në Kosovë

Hyrje

Kjo pjesë ka për qëllim analizën e menaxhimit të sigurisë së brendshme të Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare. Strategjia primare e saj për stabilizimin dhe sigurimin e paqes afat-gjate ishte ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të autoriteteve lokale dhe në fund transferi i strukutrave të sigurisë në këto autoritete. Analiza do të përqëndrohet në tri palë udhëheqëse kryesore në këtë proces, që kryesisht përqëndrohet në "transferin e kompetencave" në institucionet lokale kosovare. Komponenti i parë dhe ndoshta edhe më i rëndësishmi për gjendjen e tanishme në Kosovë janë Forcat e Kosovës (KFOR) të udhëhequra nga NATO-ja. Komponenti i dytë kryesor në përpjekjet e bashkëisë ndërkombëtare për sigurimin e stabilitetit në Kosovë është policia e administruar nga misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Komponenti i fundit është Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), një forcë policore lokale që trajnohet nga OSBE-ja. Brenda këtij treshi mbeten një sërë çështjesh në atë se si burimet e shumta të bashkësisë ndërkombëtare do të mund të ndikonin në performansën e këtyre institucioneve të sigurisë.

Korniza ligjore e menaxhimit të sigurisë së Kosovës nga ana e bashkësisë ndërkombëtare është e theksuar në Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, duke u bazuar në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Rezoluta identifikon bashkësinë ndërkombëtare si entitetin e vetëm legjitim me mandat të zbatimit të ligjit dhe përdorimit të forcës në rajon. Detyra e zbatimit të paqes, siq përcaktohet nga rezoluta i është dhënë vetëm KFOR-it, derisa KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut (CIIPVOL) u është dhënë mandati për zbatimin e ligjit bashkarisht. Manadati i dytë i dhënë policisë së UNMIK-ut (CIIPVOL) është zhvillimi i Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK).

Ajo që rezoluta dështon të specifikojë është se ku dhe si përgjegjësia në menaxhimin e sigurisë së brendshme të Kosovës duhet të shtrihet në mes të pranisë ndërkombëtare civile dhe ushtarake. Në strukturën e vet komanduese, janë dy organe mjaft të ndryshme dhe shpesh konfliktuoze që funksionojnë në Kosovë. Forcat e KFOR-it janë përgjegjëse para Shtabit Qendror të NATO-s në Bruksel dhe nuk i përgjigjen UNMIK-ut, derisa policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja janë drejtpërsëdrejti përgjegjëse para PPSP-së. Ky bifurkacion i komandës dhe kontrollit ka shpier në disa konflikte dobësuese në politikë si tregohet qartë në rastin e Mitrovicës, që shpjegohet më vonë.

Çfarë është më me rëndësi për ambiciet e deklaruara të misionit ndërkombëtar për "transferin e kompetencave" në institucionet lokale, është se ekzistojnë kontradikta të rëndësishme në Kornizën Kushtetuese të Kosovës (KKK), shpallur nag ish-PPSP, Hans Haekerup, më 15 maj 2001. Në KKK, policia dhe drejtësia mbesin nën UNMIK-un dhe janë kompetenca të pa-transferueshme duke i mohuar Qeverisë së Kosovës çfarëdo përgjegjësie formale në zbatimin e ligjit dhe rendit. KKK thekson që në fazën

e fundit të misionit, policia e UNMIK-ut do t'ja transferojë SHPK-së përgjegjësinë primare duke mbajtur pastaj një rol mbështetës dhe monitorues. Problemi qëndron në mungesën e kornizës së qartë kohore brenda së cilës misioni i KB-së do mendonte se është e gatshme që faktikisht t'i dorëzojë këto përgjegjësi, duke krijuar tensione institucionale në mes të Qeverisë së Kosovës dhe UNMIK-ut.[38]

Vendosja dhe strukturimi i Forcës Ndërkombëtare Ushtarake dhe Policisë Civile

Sfida kryesore për misionin e KB-së në Kosovë në drejtim të sigurisë është se ky mision është i pari mision i Kombeve të Bashkuara me mandat të zbatimit të ligjit. Pa pasë ndonjë model operacional në të cilin do të mbështetej, përpjekjet, në mesin e gjërave tjera, për të adresuar vakuumin e sigurisë që u paraqit në Kosovë pas tërheqjes së forcave të aramtosur serbe/jugosllave në qershor të vitit 1999 nuk ishin koherente dhe shpesh në kundërshtim me detyrat tjera të këtij misioni.[39] Sfidat tjera, siq ishte mbikqyrja e demilitarizimit dhe transformimit të UÇK-së në një forcë civile ishin kompromise me paqartësitë e misionit.[40] Ndoshta çështja më e rëndësishme që vlen të ceket në përgjegjësitë rreth sigurisë në Kosovë që shpesh janë kontradiktore dhe mbulojnë njëra tjetrën, ishte roli i KFOR-it në zbatimin e ligjit në muajt e parë të misionit. Trupat e NATO-s, të trajnuara për luftëra ishin ose të papërgatitura ose të pavullnetshme për t'i përmbushur detyrat e forcës policore civile. Kjo shkaktoi një periudhë fillestare të kaosit dhe i kushtoi Kosovës disa muaj në procesin e rindërtimit.

Paqartësia rreth misionit fillon para intervenimit të drejtpërdrejt të NATO-s në luftën e Kosovës. Fillimisht funksioni i KFOR-it ishte që ta mbajë konfliktin e Kosovës brenda kufijve të saj. Nën emrin Operacioni "Joint Guardian", shpërndarja fillestare e forcave dhe fondeve filloi në verë të vitit 1998 dhe u ndalua nga tetori i vitit 1998 deri në shkurt të vitit 1999.[41] Faza e planifikimit që rifilloi në shkurt të vitit 1999 për intervenimin e paevitueshëm të trupave të NATO-s në Kosovë inicoi shkarkimin e trupave në Maqedoni dhe Shqipëri, që përfundimisht arritën numrin prej 17.500 trupave deri më 9 qershor 1999, kur u nënshkrua Marrëveshja Tekniko-Ushtarake në mes të NATO-s dhe autoriteteve jugosllave/serbe në Maqedoni.

Me arritjen e marrëveshjes në Kumanovë, trupat e NATO-s, që numëronin 16.100, hynë në Kosovë gjatë ditës së fundit të tërheqjes së forcave jugosllave/serbe më 18 qershor 1999. Numri shtesë prej 11.000 ushtarësh u mundësua nga bazat ne IRJM.[42] Brenda pak ditësh , Shtabi Qendror i KFOR-it u zhvendos nga IRJM në Prishtinë dhe pesë shtabe rajonale të KFOR-it në nivel të brigadës u ngritën, që i përshtateshin shteteve (SHBA, Britania e Madhe, Franca, Gjermania dhe Italia) në krye të komandave rajonale. Deri në fund të vitit 1999, me pjesëmarrjen shtesë të më shumë se 30 shteteve partnere, prania totale e trupave arriti në 45.000.[43]

Hyrja dhe vendosja e shpejtë e KFOR-it në Kosovë doli të ishte vendimtare në krijimin e një ambienti të sigurtë në rajon. Kjo vendosje e mundësoi kthimin e 1,3 milion shqip-

tarëve të Kosovë.[44] Ritmi i kthimit, sidoqoftë, tejkaloi me të madhe parashikimet e institucioneve që kishin për detyrë dhënien e ndihmës humanitare dhe natyrisht, sigurisë.[45] Rezultati përfundimtar ishte që Kombet e Bashkuara ende nuk ishin të gatshme për t'i marrë përsipër detyrat policore me forcën e paraparë policore të UNMIK-ut. KFOR-i, i braktisur me përgjegjësinë e mbajtjes së sigurisë dhe zbatimin e rendit dhe ligjit, dështoi sipas të gjitha vlerësimeve. Numri i vrasjeve në Kosovë në pjesën e dytë të qershorit 1999 arriti nivelin e 50 vrasjeve në javë.[46] Ky ishte një dështim i madh, që u kombinua me faktin qe minoriteti serb shihej si cak i hakmarrjes në shkallë të gjerë dhe që KFOR-i dështoi në parandalimin e Beogradit për realizimin e ndarjes së Mitrovicës dhe krijimin e enklavave etnikisht të pastra. Për shkak të kësaj, KFOR-i e përmirësoi dukshëm sigurinë në muajt vijues. Me qindra kriminel të dyshimtë u arrestuan, armatimi dhe muncioni u konfiskua dhe për shumë vëzhgues, siguria dhe stabiliteti u rivendosën.[47] Kah fillimi i vitit 2000, numri i vrasjeve zbriti në pesë në javë.[48] Në kontekst të dhënies së përgjigjes për ato që ndodhën me trajtimin e pakujdesshëm të mbrojtjes së serbëve, që nga fillimi i vitit 2000, më shumë se gjysma e të gjitha trupave të KFOR-it u përfshinë në mbrojtjen e serbëve dhe komuniteteve tjera.[49] Për aq sa i përket NATO-s, KFOR-i do të mund të ishte më efektiv në kryerjen e detyrave primare në Kosovë në qoftë se Kosova do të kishte një prani më të theksuar policore si dhe një sistem funksional gjyqësor.[50]

Për dallim nga aktivitetet e KFOR-it, forca ndërkombëtare policore civile është përballuar me probleme serioze për shkak të vonesës në dërgimin e policëve në Kosovë dhe në ndërtimin e strukturës operative e detyruan projektin në implementimin e planeve afat-gjate të sigurisë në Kosovë që u zhagitën deri në vitin 2000.[51] Udhëzimet formale për funksionet e policisë së UNMIK-ut, që janë baza të planifikimit operacional në planin afat-gjatë, u inicuan nga raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Kofi Annan më 12 korrik 1999, gati një muaj pas hyrjes së forcave të KFOR-it.[52] Rezultati përfundimtar ishte që vetëm një forcë e vogël prej 200 policëve civil që shërbenin në Misionin e KB në Bosnjë dhe Hercegovinë arritën në Kosovë në fund të korrikut të vitit 1999.[53]

Plani fillestar ishte që Policia e UNMIK-ut do të përbëhej nga 3.110 policë. Këto plane shpejt u modifikuan pas marrjes së rekomandimeve nga PPSP i atëhershëm Bernard Kouchner, duke e rritur numrin kështu në 4.718.[54] Përforcimet filluan të arrijnë në fund të gushtit të vitit 1999, së pari në Prishtinë dhe përfundimisht arritën në Pejë në qershor të vitit 2000. Struktura e tanishme (rajonet dhe stacionet) u krijua plotësisht në mes të vitit 2000 me përjashtim të Mitrovicës ku Policia e UNMIK-ut ka autorizim të plotë hetues por KFOR-i e mbajti primatin e vet teknik.[55]

Problemi me Policinë e UNMIK-ut qëndron në kompetencat e saj. Më shumë se gjysma e policëve ndërkombëtarë në Kosovë janë nga shtetet autokratike ose nga shtetet me korrupcion të lartë. Duke importuar policë që nuk kanë përvojë në zbatimin e ligjeve në shoqëritë demokratike dhe të punës në mënyrë të këndshme dhe ndihmuese, UNMIK edhe më tej e keqësonte gjendjen. Më një profil të tillë të "policit ndërkombë-

tar", ishte e qartë se ata nuk do të mund të kontribonin në zhvillimin e policisë lokale dhe i armiqësuan marrëdhëniet me popullsinë lokale.[56] Për më tepër, çmimi i angazhimit të policisë ndërkombëtare është shumë i lartë dhe i paqëndrueshëm për projekte të tilla ndërkombëtare. Buxheti i Kombeve të Bashkura ndan përafërsisht diku rreth 115.000.000 dollarë për vit vetëm për Pagesën për Mjete Jetese (MSA) për policët e UNMIK-ut (71 dollarë në ditë për një polic të UNMIK-ut)[57]. Për shkak të faktit që një numër i madh i policëve të UNMIK-ut janë "polic të dobët", çmimi i këtij veprimi duhet të rishikohet seriozisht nga Kombet e Bashkuara.

Analiza e lartëshënuar mbi vendosjen dhe performansën e KFOR-it dhe Policisë së UNMIK-ut në Kosovë nxjerr në pah mësimet kryesore, që vijojnë, që mund të përdoren nga bashkësia ndërkombëtare për misionet e mundshme në të ardhmen:

Nëse komponenti ushtarak i paqe ruajtjes/zbatimit është i detyruar që t'i kryejë detyrat e forcës policore civile, forcat e përfshira kanë nevojë për trajnim shtesë në përmbushjen e detyrave të zbatimit të ligjit dhe rendit publik. Në këtë drejtim, forcat ushtarake me përvojë të posaçme për polici civile (si Gendarmerie Franceze, Carabinieri Italian ose Guardia Civil Spanjolle) mund të luajnë një rol të rëndësishëm në planifikimin dhe kryerjen e detyrave policore në misionet e ardhshme.

Ekziston një nevojë e qartë për një forcë policore të përparuar me planifikim operacional që duhet të shoqërohet me koordinimin para-vendosjes me forcat ushtarake. Këto përpjekje mund të koordinohen me qeveritë kombëtare të vendeve që kontribojnë në komponentin ushtarak me qëllim të shmangies së dërgimit në masë të personelit të patrajnuar në terren, siq ndodhi në Kosovë.

Përvoja e Kosovës tregon se ekziston nevoja për një qasje të re për operacionet paqe ruajtëse/zbatuese duke i bashkuar në një pako të përbashkët planifikimin ushtarak dhe policor për rastet në të ardhmen.

Zbatimi i ligjit dhe rendit

Misioni ndërkombëtar ushtarak dhe civil në Kosovë ishte, në fillim, duke vepruar në një atmosferë të paqartësisë ligjore në lidhje me atë se cilat ligje zbatohen. Kjo mungesë u bashkua me faktin se nuk ekzistonte kurrëfarë infrastrukture mbështetëse ligjore në atë kohë. Kjo situatë i detyroi trupat e KFOR-it që të mirren me raste në bazë të ligjeve të veta vendore, sepse çfarë mund të bënin policët ndërkombëtar në një situatë të tillë komplekse ishte që të veprojnë si dijnë më së miri. Në raste të procedurave penale, definicionet e krimeve dhe të koncepti i rasteve të hapura nuk ishte i njohur në mënyrë universale nga ata që e zbatonin paqen. Si rrjedhojë e kësaj situate, qytetarët e Kosovës ishin duke jetuar në një kaos ligjor dhe drejtat e tyre shpesh shkeleshin. Në atë kohë u bënë përpjekje për ta mësuar personelin e zbatimit të ligjit mbi ligjin e zbatueshëm në Kosovë (UNMIK-u deklaroi se ligjet që kanë qenë në fuqi para 23 marsit të vitit 1989 do të ishin ato që zbatohen). Kjo dështoi tmerrshëm pasi që kopjet e ligjeve të Kosovës u përkthyen në anglisht vetëm pas dhjetë muajsh pas fillimit të misionit.[58]

Këto rrethana rezultuan në shumë gabime të Policisë së UNMIK-ut. Në këtë periudhë të kaosit ligjor në kryerjen e funksioneve policore, Policia e UNMIK-ut paraqiti një propozim që bënte thirrje per implementimin e "kodit të përgjithshëm penal" për të cilin personeli i misionit do të trajnohej dhe do të mund ta zbatonte në raste të paqartësive ligjore. Fatkeqësisht, ky propozim u refuzua nga UNMIK-u.[59] Bile edhe më e dëmshme, deri në janar të vitit 2001, Policia e UNMIK-ut nuk lejohej që të ndërmarrë aktivitete të fshehta vëzhguese që rezultoi në shërbime të pamjaftueshme të zbulimit.[60] Përkundër këtyre barrierave administrative, shumë nga këto aktivitete u kryen me vetë-iniciativë të një numri të policëve të UNMIK-ut.[61]

Në anën tjetër, sistemi gjyqësor i Kosovës vuante nga mungesa e përgjithshme e profesionalizmit për shkak të shkëputjes së prokurorëve dhe gjykatësve lokal Shqiptarë nga sistemi gjyqësor për nje dekadë. Situata në sistemin gjyqësor u përkeqësua nga fakti që ky sistem është komplikuar edhe më tej për shkak të rasteve të frikësimit dhe detyrimit të stafit gjyqësor.[62] Për më tepër, mungesa e një programi për mbrojtjen e dëshmitarëve ka penguar në masë të madhe implementimin e sundimit të ligjit në Kosovë që rezulton në bashkëpunim të paktë nga ana e qytetarëve me policinë në rastet e krimeve të rënda.[63]

Fillimisht ekzistonte tensioni në mes gjyqësisë dhe policisë ndërkombëtare për shkak të faktit se shumë policë vinin nga shtetet që nuk kanë traditën e gjykatësve hetues si në rastin e Kosovës. Në Kosovë, gjykatësi hetues e ka rolin udhëheqës në hetimet e rasteve penale. Ky rol hetues u pengua, sidoqoftë, nga fakti se gjyqësia e Kosovës ka kapacitete të kufizuara për kryerjen u punëve në mënyrë të duhur dhe Policia e UNMIK-ut shpesh i anashakalonte procedurat tradicionale.[64]

Çështje tjetër komplikuese në luftimin e krimit në Kosovë është mungesa e kapaciteteve në burgje; Kosova ka një kapcitet të burgjeve për vetëm 600 vetë, derisa numri i arrestimeve për një ditë është 50 deri në 60 vetë.[65] Kjo situatë e detyron Policinë e UNMIK-ut që t'i lirojë shumë individ që kanë kryer krime. UNMIK-u akoma nuk është marrë në mënyrë të duhur me këtë çështje.

Kur kemi të bëjmë me zbatimin e përgjithshëm të sundimit të ligjit në Kosovë, KFOR-i është duke u ballafaquar më pengesa të mëdha. Përkundër faktit se qysh heret NATO-ja vendosi t'ja jep COMKFOR-it komandën dhe kontrollin mbi të gjitha forcat në Kosovë, akoma kemi një koordinim të paktë në mes të brigadave kombëtare me përjashtim të forcave britanike që janë të disponueshme për COMKFOR-in në raste të dërgimit të trupave jashtë sektorit të kësaj brigade. Çdo forcë tjetër kombëtare e ka rrugën e vet, pa marrë parasysh se çfarë kërkohet, që rezulton në metoda shpesh konfliktuoze të operimit dhe programe kundërshtuese.[66] Për dallim nga KFOR-i, forcat policore të UNMIK-ut kanë një zinxhir të përbashkët komandues dhe i përgjigjen vetëm Komisionerit të Policisë së UNMIK-ut, i cili përgjigjet para PPSP-së. Policia e UNMIK-ut ka forca speciale për trazira që mund të dërgohen në çdo kohë brenda Kosovës. Këto çështje të veçanta të komunikimit dhe të koordinimit kanë shërbyer si pika të tensionit në mes të dy entiteteve gjatë tri viteve të kaluara.

Kufizimet e kontrollit të forcave të NATO-s në Kosovë kanë ndikuar në zbatimin e rendit dhe sundimit të ligjit në Mitrovicën Veriore, të theksuara gjatë periudhave të krizave. Ky është problemi më i dukshëm në Kosovë tani, pasi që është kjo pjesë e Kosovës ku Policia e UNMIK-ut nuk ka forcë që të veprojë. Së pari, ekziston mungesa e bashkëpunimit nga ana e popullatës serbe; së dyti, zyrtarët e UNMIK-ut janë pajtuar që zyrtarët policor nga Serbia janë duke patrulluar në rrugët e Mitrovicës në rroba civile. Jo vetëm që kjo është shkelje e Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake të vitit 1999, por ajo gjithashtu e bën të pamundshme që popullata lokale të ndihet aq e sigurt sa për të bashkëpunuar me Policinë e UNMIK-ut nëse do të dëshironin të bënin këtë.[67] Si përgjegje ndaj kritikave, Policia e UNMIK-ut pohon që vetëm KFOR-i mund të veprojë dhe të udhëheq me operacione ushtarake me përdorim të forcës. Kjo mosmarrëveshje bëhet edhe më e qartë kur KFOR-i mohon se ka çfarëdo njohurie rreth veprimit të zyrtarëve policor serb në Mitrovicë.[68] Sidoqoftë, ky mohim nuk mund të qëndronte, pasi që Policia e UNMIK-ut e zbuloi një listë me emrat e 70 zyrtarëve policor nga Serbia, që janë në komandën e Gjeneralit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Svetislav Djordjevic.[69]

Vetëm në fund të nëntorit të vitit 2002 UNMIK-u filloi me zgjerimin e detyrave të veta administrative në Mitrovicën Veriore. Shpjegimi i këtij kthimi të papritur të suksesit të UNMIK-ut flet më shumë për përpjekjet politike të UNMIK-ut se sa përpjekjet për zbatimin e ligjit nga KFOR-i dhe Policia e UNMIK-ut.

Në analizimin e përvojës së mbajtjes së rendit dhe ligjit në Kosovë, mësimet kryesore që vijojnë duhet të mësohen:

Mungesa fillestare e ligjeve themelore për kryerjen e hetimeve në rastet penale dhe zhvillimi i njësiteve speciale të policisë për luftimin e krimit tregohet të jetë një ndër pengesat kryesore për mbajtjen e sigurisë dhe rendit publik në territoret e administruara ndërkombëtarisht. Prandaj, Kombet e Bashkuara kanë nevojë që të formalizojnë një paketë të ligjeve që mund të përdoren si nga trupat paqeruajtëse ashtu edhe nga policia ndërkombëtare me qëllim të shmangies së vakumit të krijuar nga korniza ligjore që faktikisht pengon zbatimin e ligjit duke shkaktuar kaos ligjor.

Trajnimi i zyrtarëve në forcat ndërkombëtare ushtarake dhe policore për ligjin lokal penal është element i domosdoshëm për sigurimin e efektivitetit ndër-institucional

Zinxhiri i dobët komandues i COMKFOR-it në lidhje me zinxhirët kombëtar komandues e bën gati të pamundur përdorimin e trupave të NATO-s në nivelin ndër-rajonal. Kjo rrethanë është duke ndikon në zbatimin e përgjithshëm të ligjit në Kosovë, duke përfshirë bashkëpunimin efektiv në mes të KFOR-it dhe Policisë së UNMIK-ut në raste të trazirave. Një zgjidhje mund të gjindet në krijimin e një kontigjenti multi-nacional të trupave të NATO-s nën komandën direkte të COMKFOR-it, forcë që mund të përdoret në situata kur një brigadë e vetme është e pamjaftueshme.

Pasi që si KFOR-i ashtu edhe Policia e UNMIK-ut kanë mandatin e njejtë të zbatimin të rendit dhe ligjit, bashkëpunimi dhe veprimi i përbashkët i tyre në paaftësimin e vepri-

meve ilegale të forcave policore Serbe në Kosovë është vital për sigurimin e funksionimit normal të UNMIK-ut dhe të administatës së Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në krejt territorin.

Mungesa e qendrave të paraburgimit është duke i penguar përpjekjet për luftimin e krimit në Kosovë. Kjo çështje duhet që të adresohet me urgjencë nga UNMIK-u dhe bashkësia donatore ndërkombëtare.

Ndërtimi i qëndrueshmërisë: Shërbimi Policor i Kosovës

Bashkësia ndërkombëtare ka treguar ngurrim në përdorimin e ish ushtarëve të UÇK-së dhe ish policëve të përjashtuar në 1989 në formimin e forcës civile policore të Kosovës. Në bazë të Policisë së UNMIK-ut, aryeja e mos kthimit në vendet e punës të ish policëve janë pasojat e apartejdit gjatë dekadës së kaluar në të cilën vetëm disa policë të SHPK-së kishin përvojë policore dhe shumë nga ta u ballafaquan me një dekadë të papunësisë, duke shtruar kështu nevojën e ritrajnimit.[70] Nën këto kushte, ndërtimi i Shërbimit Policor të Kosovës si një shërbim lokal policor filloi nga zeroja në gjysmën e dytë të vitit 1999. Përpjekjet e UNMIK-ut në zhvillimin e SHPK-së kryhen përmes Shtyllës I të Policisë dhe Drejtësisë (trajnimi në terren, mbikqyrja dhe monitorimi) dhe Shtyllës III të Ndërtimit të Institucioneve, përkatësisht nëpërmes Shkollës Policore të OSBE-së.

Kandidatët e zgjedhur për trajnim dhe si më vonë të rekrutuar në Shërbimin Policor të Kosovës duhet të jenë banorë të Kosovës në mes të moshës 21 dhe 55 vjeçare dhe duhet ta kenë të mbaruar shkollën e mesme. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme, një hetim i brendshëm është duke u kryer nga Policia e UNMIK-ut lidhur me vërtetimin e të kaluarës së kandidatit. Pas kësaj, kandidatët kalojnë nëpër një mësimi themelor 12 javor në klasë në Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK) dhe 15 javë të trajnimit përmbajtësor me Policinë e UNMIK-ut[71] dhe duke filluar që nga disa muaj më parë, edhe me SHPK-në.[72]

Në procesin e ndërtimit të SHPK-së janë shfaqur pengesa fillestare që kryesisht ishin të lidhura me infrastrukturën e trajnimit (vendi dhe kuadrot), si dhe me tipin dhe stilin e trajnimit që duhej të jepej. Përfundimisht, SHPK-ja adoptoi teknikat policore dhe pajisjet për shkak të faktit që qeveria e SHBA-ve mbulon pjesën kryesore të financimit të programit.

Në bazë të standardeve të SHBA-ve, katër deri në pesë vite të përvojës janë të nevojshme që një polic të mund të konsiderohet për detyra të veçanta ndërsa dhjetë vite kërkohen për detyra të mbikqyrjes. Sidoqoftë, ky model nuk mundet të zbatohet plotësisht në SHPK për shkak të urgjencës në zhvillimin e strukturës. Megjithatë, personeli i SHPK-së është zhvilluar në mënyrë të shpejtë. Deri në shtator të vitit 2002, rreth 4.500 policë nga të gjitha komunitetet e Kosovës janë anëtarë të SHPK-së.[73] Në këtë fazë, SHPK-ja është vendosur në të gjitha pjesët e Kosovës, duke përfshirë Mitrovicën Veriore.[74]

Përveç këtyre programeve të trajnimit të organizuara nga OSBE-ja, një program i ri-çertifikimit/ri-kualifikimit është zhvilluar dhe mbajtur për të vërtetuar zotësinë e policëve të SHPK-së në fusha të veçanta. Gjithashtu janë organizuar edhe trajnime të specializuara në diciplinat e nevojshme policore të përdorura në zbatimin e ligjit si dhe programe tjera të përparuara të trajnimit të mbajtura nga ekspertë të huaj, kryesisht amerikan.[75]

Poashtu, SHSHPK është duke organizuar kurse për mbikqyrës, menaxhimin e mesëm dhe një Kurs për Menaxhimin e Lartë. Koloneli i SHPK-së shërben si këshilltar për Komisionerin e Policisë së UNMIK-ut, derisa Lejtnant Kolonelët shërbejnë si këshilltar për Komandantët Rajonal të Policisë së UNMIK-ut. Policëve të SHPK-së iu lejohet që të mbajnë vijën e parë të përgjegjësive mbikqyrëse/komanduese, përderisa këto vet janë plotsisht të integruara në kuadër të Policisë së UNMIK-ut, duke përfshirë Njësitin e Zbulimit për Krimin e Organizuar.[76]

Të diplomuarit e akademisë veprojnë nën mbikqyrjen e "policëve për tajnim në terren" të policisë ndërkombëtare të UNMIK-ut. Shumica e këtyre policëve kanë përvojë të paktë në mentorim dhe nuk janë të njohur me rajonin.[77] Për më tepër, një numër i policëve të UNMIK-ut kanë aftësi të mjaftueshme profesionale. Në shumë raste, policët e SHPK-së janë më profesional se sa kolegët e tyre nga Policia e UNMIK-ut.[78] Për shkak se policët e SHPK-së janë momentalisht nën mbikqyrjen e Policisë së UNMIK-ut, profesionalizmi i ulët i një numri të policëve të UNMIK-ut shkakton tensione me forcat policore të SHPK-së.[79] Një shenjë premtuese që është duke u adresuar është se policët ndërkombëtar me nivel të lartë të ekspertizës janë përparuar në pozita të larta në Policinë e UNMIK-ut. Kjo do të jetë premtuese për SHPK-në në kohën kur ajo e ngrit nivelin e profesionalizmit.

Përkundër faktit se Policia e UNMIK-ut kupton se SHPK-ja është më profesionale se disa forca policore në rajon, Policia e UNMIK-ut akoma nuk e konsideron atë si një forcë civile stabile.[80] Në anën tjetër, nga SHPK-ja komponentët kyq për arritjen e stabilitetit janë profesionalizmi dhe paanshmëria e policëve të SHPK-së si dhe mbështetja nga komuniteti dhe respekti për hierarkinë e brendshme.[81] Komponenti i fundit është shumë i rëndësishëm për sigurimin e pavarësisë së SHPK-së. Janë shfaqur rastet kur individët nga rradhët e policëve të SHPK-së janë ngritur në pozitë më të lartë nga ana e UNMIK-ut në gradën e Lejtnant Kolonelit pa kaluar nëpër krejt ciklin e gradimit, që fillon me gradën e rreshterit. Kjo e përshpejtoi trajektoren e karrierës për disa duke shkaktuar pakënaqësi brenda SHPK-së.

Kompletimi i stafit të SHPK-së do të arrijë numrin përfundimtar të autorizuar prej 6.283 policëve të përmbushur me mbi 2000 vetë në stafin mbështetës civil. Është paraparë që transferi i plotë i shërbimeve policore për Kosovën të kompletohet deri në 2005, pra duke përmbushur kështu gjashtë vite për kompletimin e ndërtimit dhe transferit të kompetencave nga Policia e UNMIK-ut.[82] Që nga viti 2005, Policia e UNMIK-ut do të marrë detyrat monitoruese dhe të trajnimit.

Sidoqoftë, ekzistojnë mospërputhje në këtë proces të tranzicionit. Në bazë të Kornziës Kushtetuese të Kosovës, Policia dhe Drejtësia mbesin nën kontrollin e UNMIK-ut si një ndër kompetencat e pa-transferueshme të cilat janë të siguruara për UNMIK-un. Prandaj, gjatë kësaj periudhe, tranferi i kompetencave prej Policisë së UNMIK-ut në SHPK nuk shoqërohet me ndërtimin e kapaciteteve të zyrtarëve kosovarë në udhëheqjen e Departamentit të Policisë. Situata e tanishme mund të ndikojë në qëndrueshmërinë afat-gjate të SHPK-së në lidhje me adminstrimin e saj nga qeveria kosovare. UNMIK-u duhet të mirret me këtë çështje duke zhvilluar një transfer të qartë të kompetencave te autoritetet kosovare, duke përfshirë mundësinë e administrimit të përbashkët të Departamentit të Policisë në një fazë të hershme. Transferi i plotë i kompetencave policore në autoritetet kosovare mund të kompletohet me zhvillimin e Departamentit të Policisë në Ministri të Punëve të Brendshme të Kosovës.

Shqyrtimi i lartëshënuar i tri viteve të kaluara thekson mësimet kyqe që vijojnë:

Ndërtimi i shërbimit lokal policor nga zeroja kërkon një periudhë të gjatë kohore. Ndonëse Kosova ka një popullsi relativisht të vogël, ende do të duhen gjashtë vite për implementimin e tranzicionit të plotë të kompetencave. Në këtë rast, kërkohet një metodë e re e sigurimit të transferit të shpejtë të kompetencave.

Ndërtimi i karierës së besueshme dhe të respektuar si dhe krijimi i standardeve për promovomin e policëve është çështje kryesore në sigurimin e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë afat-gjate të forcave lokale policore. Poashtu, duhet të ekzistojnë kriteriume më të forta profesionale për monitorim nga ana e forcave ndërkombëtare të policisë.

Me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së administrimit të sigurisë së brendshme në Kosovë, transferi i kompetencave nga Departamenti i Policisë së UNMIK-ut në Qeverinë e Kosovës duhet të kompletohet paralelisht me transferin e kompetencave nga Policia e UNMIK-ut në SHPK.

Rekomandimet mbi politikat:

Përvoja e Kosovës tregon se ekziston nevoja për një qasje të re për operacionet e paqeruajtjes/zbatimit duke i futur në një pako të përbashkët planifikimin ushtarak dhe policor për rastet kur që të dyja e kanë mandatin e mbajtjes dhe sigurimit të zbatimit të ligjit në territoret e administruara ndërkombëtarisht.

Ekziston nevoja për planifikim të hershëm dhe për dërgim të hershëm të policëve ndërkombëtar që kanë komunikime të mira me forcat ushtarake. Për sa i përket ekspertizës, planifikimi i hershëm i përbashkët i shërbimeve policore në mes të policisë ndërkombëtare dhe forcave ushtarake mund të përparohet me bashkëpunimin e policisë ndërkombëtare me forcat ushtarake që kanë përvojë të veçantë në shërbimin civil policor.

Kombet e Bashkuar duhet të formalizojnë një pako të ligjeve për procedurat penale dhe për hetime që mund të përdoren si nga trupat paqeruajtëse ashtu edhe nga policia

ndërkombëtare me qëllim të shmangies së vakumit në kornizën ligjore të territorit të administruar.

Transferi i kompetencave nga Departamenti i Policisë së UNMIK-ut në Qeverinë e Kosovës duhet të kompletohet paralelisht me transferin e kompetencave nga Policia e UNMIK-ut në SHPK.

Marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë: shikimi në ardhmëri

Hyrje

Kjo pjesë analizon, vlerëson dhe jep rekomandime institucioneve ndërkombëtare, rajonale dhe lokale si dhe udhëheqësve të komuniteteve që mirren me marrëdhëniet ndëretnike në njërën mënyrë apo tjetrën. Kjo pjesë bën një analizë fillestare të standardeve dhe të mendimeve të adminstratës ndërkombëtare në fillim të misionit si dhe zhvillimet e mëvonshme në këtë fushë me qëllim të marrjes së mësimeve mbi praktikat e mira lidhur me marrëdhëniet ndëretnike.

Marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë trashëgojnë një trashëgimi dhjetë vjeçare të konfliktit në mes të shtetit dhe shumicës shqiptare në Kosovë që gradualisht eskaloi nga persekutimet dhe shkeljet masive të të drejtave të njeriut në luftën e armatosur që rezultoi në mbi dhjetë mijë persona të vrarë ose të humbur dhe 600 fshatra të rrafshuara me tokë. Pas përfundimit të luftës, grupi etnik që më heret ishte i privilegjuar u bë cak i fushatës me sa duket të paorganizuar të hakmarrjes dhe marrjes së apartamenteve, të lëna nga të ikurit që shpesh e bënin këtë për shkak të presionit.

Në fillim të misionit, prioriteti primar i UNMIK-ut në lidhje me marrëdhëniet etnike ishte "promovimi i të drejtës së kthimit nëpërmes një strategjie të planifikuar për kthim që thekson kthimin në shumë zona gjeografike në mënyrë graduale, të rregullt dhe pa shume bujë"[83]. UNMIK-u theksonte nevojën për të qenë transparent, për tu përfshirë në konsultime maksimale dhe për krijimin e ndërtimit të masave të mirëbesimit kurdo që është e mundur. Fushat që shiheshin si të rëndësishme ishin: Siguria, Liria e lëvizjes, Prona, Strehimi, Infrastruktura, Shërbimet publike, Shëndetësia, Shërbimet sociale, Krijimi i të ardhurave, dhe Ndihma humanitare.
Pasi që gjatësia e këtij punimi nuk lejon një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha çështjeve të ndërlidhura, punimi përqëndrohet në çështjet më të spikatura: kthimet e qëndrueshme, roli i institucioneve Kosovare në krijimin e klimës së përgjithshme, çështjet pronësore, paaftësinë e marrjes me institucionet paralele, strategjinë e sigurisë në garantimin e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes dhe përjashtimin e udhëheqësisë së shumicës.

Institucionalisht, bile edhe tri vite pas luftës, çështjet minoritare mbesin kompentencë ekskluzive e PPSP-së. Derisa është bërë një presion në institucionet kosovare, fusha kryesore ku insitucionet kosovare mund të kenë ndikim është formimi i opinionit publik. Politikanët kosovar shpesh ankohen se derisa ata e përjetojnë barrën kryesore të kritikave dhe presioneve, kompetencat e tyre në përmirësimin e situatës në terren janë mjaft të kufizuara, pasi që ata nuk e kontrollojnë policinë dhe nuk mund të ndikojnë në gjyqësi ose në institucione tjera relevante. Bile edhe ankesat lokale në kuadër të çdo komune kanë një mekanizëm të zgjidhjes së problemeve nën kujdesin e administratorit ndërkombëtar në nivelin qendror.

Pa marrë parasysh brengat e veçanta të pakicave, demokratizimi i pasluftës që po ndodh në Kosovë vazhdon të jetë i brishtë në rastin më të mirë dhe me shumë gabime në

shumë drejtime: (a) strukturat jashtëzakonisht të centralizuara të pushtetit nga ana e UNMIK-ut që rezultojnë në autorizime gati diktatoriale të PPSP-së, (b) strukturat e reja dhe relativisht jokompetente qeveritare të Kosovës, (c) transferi i ngadalshëm i kompetencave.

Megjithëse i vonuar, themelimi i institucioneve kosovare pritet që t'i shtojë përgjegjësitë. Sidoqoftë, kompetencat e shumta të rezervuara që mbesin në duart e administratës së lartë të UNMIK-ut kanë qenë shkak i pakënaqësive si te shqiptarët ashtu edhe te serbët. Transferi i kompetencave nuk ka të bëjë vetëm me çështjet politike dhe të sigurisë, por bile edhe me udhëheqjen ditore të komunave të Kosovës, pamarrëparasysh përbërjen etnike të komunës. Madje edhe një dokument i lëshuar nga Qendra Serbe e Koordinimit në mes tjerash shpreh ankesën për kompetencat e pakta të komunave, kjo që është më interes të tyre të rritjes së kontrollit të komunave veriore të dominuara me serb. Si rezultat i kësaj, Qendra Koordinuese (në bashkim me koalicionin serb Povratak), përgatitën një plan për decentralizimin e Kosovës që përbën dyfishimin e institucioneve tashmë të fryera administrative dhe qeverisëse në Kosovë, duke sugjeruar organe dy dhomëshe lokale, rajonale dhe nacionale.

Në përgjithësi, korniza e tanishme ligjore lejon një qeveri lokale mjaft të decentralizuar në Kosovë. Përkundër madhësisë së vogël të Kosovës (një e treta e Uellsit), 30 komuna mbajnë kontrollin mbi shumicën e kompetencave në të gjitha shërbimet publike, mirëmbajtjen e monumenteve dhe objekteve historike, shkollimin fillor dhe atë të mesëm, rininë, integrimin e minoriteteve, kornizën ekonomike, taksat komunale, punësimin, implementimin e akteve dhe procedurave qendrore, marrëdhëniet me UNMIK-un, shërbimet primare shëndetësore, infrastrukturën, planifikimin hapësinor dhe urban. Pavarësisht nga trendet globale të decentralizimit, për shkak të kapaciteteve të pakta financiare dhe njerëzore, mund të thuhet se çfarë i duhet Kosovës është e kundërta, forcimi i institucioneve qendrore.

Marrëdhëniet me komunitetet jo-serbe

Për shkak të rëndësisë së marrëdhënieve në mes të shumicës shqiptare dhe komunitetit serb, ky është përqëndrimi kryesor i këtij punimi. Sidoqoftë është me rëndësi që shkurtazi të vështrohet situata e minoriteteve tjera. Përveç serbëve, dhe deri në një masë romëve, problemet e pakicave tjera janë kryesisht të natyrës sociale dhe shumica prej tyre janë të përbashkëta me problemet e popullatës shumicë shqiptare.

Për shembull, ashkalitë dhe egjiptianët janë të stigmatizuar dhe mbajtur larg punëve me pagë të mirë për shkak të diskriminimit historik dhe kualifikimeve të ulëta si rezultat i paragjykimeve përgjatë Europës Juglindore. ashkalitë dhe egjiptianët më heret kategorizoheshin si romë dhe sot është praktikë standarde që ata të trajtohen nën shkurtesën komunitetet RAE (romë-ashkali-egjiptian) për shkak të problemeve të përbashkëta. Dallimi kryesor është se komuniteti ashkali dhe ai egjiptian flasin shqip dhe janë mjaft mirë të integruar me komunitetin shqiptar. Ata gjithashtu tradicionalisht kanë jetuar në

afërsi të vendbanimeve shqiptare. Një faktor shtesë për këtë diferencim është fyerja e komunitetit romë nga ai shqiptar pasi që romët akuzoheshin se kanë bashkëpunuar me regjimin e Millosheviqit. Kjo shërbeu si nxitje shtesë për komunitetet ashkali dhe egjiptian që ta dallojnë veten nga grupet tjera.

Turqit në anën tjetër janë shumë mirë të integruar dhe bile mund të thuhet se situata e tyre ekonomike është relativisht më e mirë kur krahasohet me shumicën shqiptare. Ata flasin shqip, i takojnë religjionit të njëjtë dhe tradicionalisht kanë qenë të afërt me komunitetin shqiptar. Përkundër akuzave fillestare nga anëtarët e shumicës se udhëheqësia lokale turke ka marrë anën e Millosheviqit gjatë dhjetë viteve dhe për mos-pjesëmarrjen në zgjedhjet e para lokale, ata nuk u ballafaquan me pengesa serioze në integrimin e tyre dhe nuk ka pasë kurrfarë akte të dhunës kundër këtij komuniteti.

Komuniteti boshnjak është gjithashtu në marrëdhënie shumë të mira më komunitetin shqiptar kryesisht për shkak të ndarjes së ndjenjës së përbashkët të viktimës gjatë luftës dhe për shkak të religjionit të njëjtë. Sidoqoftë, ndarjet mbesin, dhe si rezultat, ky komunitet ballafaqohet me diskriminimin indirekt dhe situatë të pafavorshme posaqërisht në arsimin e lartë. Një komunitet tjetër lokal, goranët që gati në tërësi jetojnë në komunën më jugore (dhe njërën nga më të prapambeturat) gjendet në situatë të ngjashme me komunitetin boshnjak, por për shkak të izolimit gjeografik, ata nuk kanë probleme të sigurisë.

Pjesa tjetër e këtij punimi do të përqëndrohet ekskluzivisht në marrëdhëniet me serbët me përqëndrim në çështjen më të rëndësishme që varet nga marrëdhëniet e përgjithshme, në atë të kthimit.

Kthimi i qëndrueshëm

Mbase aspekti më i spikatur i marrëdhënieve ndëretnike është çështja shumë e politizuar e kthimit të personave të zhvendosur. Që nga viti 2000, Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë ka qenë shumë i angazhuar në planifikimin dhe implementimin e një politike rreth kthimit. Udhëhequr nga shtylla humanitare e UNMIK-ut, Komisioni i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara (UNHCR), kthimi i personave të zhvendosur u ngrit si e drejtë e njeriut për kthim të qëndrueshëm. E drejta mbi pronën private në anën tjetër është vështruar si një e drejtë e patjetërsueshme e çdo personi, pa marrë parasysh cilindo ndryshim të kufijve apo të statusit ndërkombëtar të territorit. Duke punuar për vullnetin e secilit person, UNMIK-u kërkonte kthimin e qëndrueshëm në vendbanimet e mëparshme të përhershme.

Në përgjithësi, "roli i UNMIK-ut ose i çdo autoriteti qeveritar nuk është përcaktimi i lokacionit të kthimit ose diktimi i të zhvendosurve dhe refugjatëve se si dhe kur mund të kthehen, por të ndihmojnë në përmirësimin e kushteve në atë masë sa të zhvendosurit dhe refugjatët të jenë të aftë që të zbatojnë vendimin e tyre individual për kthim."[84] Kjo politikë nuk është ballafaquar me përgjigje të njejtë nga Beogradi dhe posaqërisht nga Qendra Koordinuese e RFJ-së dhe Republikës së Serbisë, të cilët që nga fillimi, syn-

onin përfitimin e poenave politik duke promovuar kthimet pompoze të organizuara.

Gjatë vitit të parë të administrimit të UNMIK-ut, kjo çështje është pasqyruar si dështim i Millosheviqit si mënyrë për diskreditimin e UNMIK-ut, duke i paguar paga dhe dhënë apartamente të zhvendosurve dhe duke e treguar Kosovën në mënyrë tmerruese si mjet për mbajtjen e pushtetit dhe ruajtjen e bazës tradicionale të mbështetjes, serbët e Kosovës. Kryetari i Komunës së Leposaviqit, Nenad Radosavljevic, që më vonë është emëruar si këshilltar e PPSP-së, ka pohuar se këto politika më vonë kanë dëmtuar përpjekjet për kthimin e të zhvendosurve sepse ata tanimë kishin krijuar jetë të mirë në Serbi.[85] Pas rënies së Millosheviqit, kjo politikë u dobësua por vazhdohej të përcillej nga presidenti Jugosllav, Vojislav Koshtunica dhe i dërguari i tij për Kosovë, kryesuesi i Qendrës Koordinuese, Nebojsa Covic.

Beogradi gjithmonë do të mbetet si partner kryesor, si mikpritëse e të zhvendosurve dhe e kuptuar si shtet amë nga serbët, për dallim prej Prishtinës. Pas rënies së Millosheviqit, pas një buje të madhe nga e tërë Europa, UNMIK-u bëri përpjekje që ta qetësoj Beogradin me një numër të marrëveshjeve që në anën tjetër i kushtuan shumë UNMIK-ut në marrëdhëniet që i kishte me popullatën e vet Kosovare. Beogradi shpesh është akuzuar për dekurajimin e pjesëmarrjes së Serbëve lokal në institucionet e sapo formuara; për veprimin obstruktiv në një sërë çështjesh bilaterale, siq janë bashkëpunimi ndërmjet policive ose kthimin e librave të regjistrimit civil, dhe për shfrytëzimin e retorikës ekstremiste të krijuar për opinionin e brendshëm si mjet për të treguar se janë duke bërë diçka për kthimin e "djepit të Serbisë". Bashkësia ndërkombëtare ia doli që të përfitojë disa lëshime, më e rëndësishmja ishte lirimi i të burgosurve politik shqiptarë, sidoqoftë, çështja e kthimit mbetet ende çështje e debateve më të ngrohta edhe në kohën e shkrimit të këtij punimi.

Në terma praktikë dhe në terma të lokacionit, kthimi ishte i planifikuat të bëhet në tri faza: (i) në rajonet e pabanuara ose në enklavat e tanishme (nëse qysh në fillim kanë banuar atje), (ii) në enklavat e tanishme ose afër, (iii) në zonat urbane si Prishtina/dhe për shqiptarët kthimi në veri. Strategjia e përcjellur nga UNMIK-u me qëllim të organizimit të kthimit ishte krijimi i Grupeve Punuese Rajonale dhe Lokale për Kthimin, të njohura si GPR dhe GPL në zhargonin e UNMIK-ut. Të udhëhequra nga Adminsitratorët përkatës komunal të UNMIK-ut, këto organe përfshinin përfaqësues nga UNHCR-i, KFOR-i, organizatat e specializuara ndërkombëtare dhe OJQ-ve të përfshira ne aktivitetet të kthimit dhe vetë komunitetet lokale (si ato të shumicës ashtu edhe të pakicave).[86] Kjo ka qenë efektive vetëm në disa fusha.

Përkundër deklaratave publike nga UNMIK-u që procesi i kthimit duhet të kryhet në nivelin lokal me takime me fqinjët me qëllim të krijimit të zonave më të mira të qetësisë, kjo u implementua në mënyrën nga lartë-poshtë. Pavarësisht nga përfshirja e OJQ-ve të ndryshme, komuniteti i gjerë dhe qeveria komunale fillimisht janë mbajtur larg këtij procesi. Derisa roli i pjesëmarrësve kosovar është theksuar të jetë vendimtar, ata janë thirrur vetëm në një fazë të mëvonshme. Kjo shkaktoi zemërimin e politikanëve lokal të cilët ndjenin se kanë qenë të thirrur të marrin pjesë në një proces tashmë të për-

funduar vetëm për të legjitimuar një proces të manipuluar mbi të cilin nuk ushtronin kurrëfarë kontrolli. Dyshimet se një numër i enklavave në Kosovë ishin duke u lidhur me rrugë anësore dhe se shpejt mund të parashikohet ngritja e statusit të tyre në atë të kantonit, nuk ishte me ndihmë për procesin dhe i shqetësoi pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës edhe më shumë. Pavarësisht nga strategjia e dobët, nën presionin joformal, disa komuna kanë bashkëpunuar me GPL-të, duke i mirëpritur të kthyerit e organizuar dhe spontan.[87]

"Korniza thekson se kush do të jenë aktorët kryesor që do të përfshihen në planifikimin dhe/ose implementimin e kthimit, si dhe **rolet dhe përgjegjësitë** e tyre përkatëse. Aktorët nuk përfshijnë vetëm anëtarët që marrin pjesë në mënyrë aktive në punimet e JCR dhe GPR-ve (UNHCR, UNMIK, KFOR, OSCE dhe përfaqësuesit e serbëve) por gjithashtu edhe aktorët tjerë të rëndësishëm si OJQ-të dhe komunitetin e donatorëve."[88]

Mendimi i administratës ndërkombëtare e njeh rëndësinë e krijimit të "progresit brenda dhe në mes të komuniteteve për përparimin e tolerancës dhe vullnetit për bashkëjetesë."[89] Ata gjithashtu njohin "pjesëmarrjen aktive dhe të përgjegjëshme të komunitetit shqiptar të Kosovës, përmes udhëheqësve të tyre" si element kyq për planifikim të suksesshëm të kthimit.[90] Sidoqoftë, roli i udhëheqësve shqiptar të Kosovës mbetet një tentativ ku prania e "…udhëheqësve shqiptar në të gjitha nivelet në planifikimin dhe implementimin e procesit të kthimit gjithashtu theksohet."[91] Në parim, sidoqoftë, mohimi i përgjegjësive dhe pjesëmarrjes për kosovarët në proces shikuar në të kaluarën është vlerësuar si një gabim.

Madje edhe në nivelin komunal, mekanizmat ishin krijuar për menjanimin e mbivotimit nga shumica shqiptare. Përderisa pakicat lokale mund të mbivotohen në mënyrë të rregullt, Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen Lokale kërkon pjesëmmarrjen e një Zyrtari ndërkombëtar të Komunitetit Lokal në çdo komunë dhe krijimin e dy mekanizmave komunale, Komitetin e Ndërmjetësimit dhe Komitetin e Komuniteteve, që kanë kompetenca të paraqitjes së ndonjë çështjeje para PPSP-së. PPSP pastaj mund të krijojë një panel të përzier tri-anëtarësh (ndërkombëtar-shqiptar-serb) dhe nëse kurrëfarë zgjidhje nuk vendoset, ai pastaj ka autoritetin për të vendosur.

Roli i udhëheqësisë lokale kosovare në pranimin e detyrave është vendimtar nëse kërkohet sigurimi i integrimit dhe kthimit të qëndrueshëm. Kanë ekzistuar dyshime nga të dyja anët mbi gatishmërinë e komuniteteve për pranimin e kthimit dhe vullnetin e të kthyerve për të pranuar integrimin e tyre dhe pranimin e realitetit të ri të krijuar pas luftës. Komuniteti mikëpritës në njerën anë ankohet se të kthyerit mund të jenë krimi-nel lufte, gjithashtu duke u frikësuar se kthimi më i madh do ta bëjë udhëheqjen jugosllave/serbe më të mundshme. Përpjekjet e UNMIK-ut për zbutjen e frikës nga kriminelët e luftës nuk ishin të suksesshme në qetësimin e njerëzve pasi që gjykatat që duhet të merren me këtë çështje ishin në rastin më të mirë jofunksionale.

Institucionet kosovare dhe klima e përgjithshme

Pasi që të gjitha kompetencat kryesore lidhur me marrëdhëniet ndëretnike i takojnë PPSP-së, përgjegjësia e vetme që i mbetet institucioneve kosovare është që të ndikojnë në klimën e përgjithshme për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike.

Madje edhe dy vite pas luftës, aktivitetet e institucioneve kosovare nuk shkuan më larg se fjalimet për pajtim që kishin për qëllim kënaqjen e bashkësisë ndërkombëtare. Sidoqoftë, rezultatet e një ankete në mes të vitit 2002 tregojnë pranimin e kthimit të komunitetit serb nga një shumicë e madhe. Siq shënohet më lartë, roli i politikanëve komunal dhe dëshira e qeverive qendrore për të treguar një politikë konstruktive kishin ndikim të njerëzit. Sidoqoftë, krijimi i opinioneve kërkon që të korrespondojë me politikat reale kur kemi të bëjmë me ballafaqimin me mosmarrëveshjet në mënyrë të shpejtë dhe efektive, përndryshe poltikanët shpesh gjenden në situatë të avokimit kundër vullnetit të përgjithshëm.

Derisa në njerën anë diplomatët ndërkombëtar i bindin politikanët se është në interesin e tyre që të promovojnë tolerancën, politikanët në anën tjetër nuk janë të aftë që t'i shpjegojnë votuesve se pse institucionet paralele serbe akoma funksionojnë ose pse shqiptarët nuk mund të kthehen në pjesën veriore të Mitrovicës. Disa politikanë kanë përkujtuar që fjalimet e ashpra retorike kundër komuniteteve tjera janë mënyra më lehtë e përfitimit të mbështetjes. Derisa numri i incideteve ka arritur numrin më të ulët deri më tani, besimi nuk është rikthyer me lehtësi për shkak të ndarjes fizike të dy komuniteteve dhe si rezultat i mungesës së kontakteve. Pavarësisht nga përpjekjet për qetësimin e skenës, ngjarjet e përgjithshme politike që në dukje po e afrojnë Kosovën drejt Serbisë (kryesisht të nxitura nga BE me krijimin e asaj që nga shumë në mënyrë sarkastike emërohet si "Solania"), problemet e pazgjidhura të Mitrovicës, mosmarrëveshja e vonshme me kufirin maqedonas, lobi i Beogradit për marshim masiv të të zhvendosurve drejt Kosovës, përpjekjet e maskimit të kantonizimit nën titullin decentralizim e bëjnë edhe më të vështirë punën e politikanëve që promovojnë pajtimin dhe ngadalsojnë procesin e pajtimit të komuniteteve lokale, OJQ-ve dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Qëndrueshmëria varet nga shumë çështje tjera. Njohja e gjuhës shqipe në Kosovën e dominuar me shqiptarë është e nevojshme për këtë komunitet për tu integruar dhe për të qenë në mundësi të krijimit të një jete të mirë. Më herët të privilegjuar, në dukje vetëm disa serb flasin shqip, edhepse shumica e kuptojnë atë. Gjithashtu, privilegjet e mëhershme e bëjnë shumë të vështirë për serbët që të pranojnë një rol numerikisht më të nënshtruar që siguron trajtim të barabartë në rastin më të mirë. Shumë intelektual serb jozyrtarisht do të pranojnë se serbët vazhdojnë të kenë qëndrime raciste kundër shqiptarëve, gjë që e bën më të mundshme ikjen e tyre në Serbi nëse ata nuk janë zotër në Kosovë.

Disa pohojnë se pa definimin e statusit të Kosovës, organizimi i kthimit do të jetë një çështje e vështirë. Sipas një gazetari me ndikim, "për derisa shqiptarët frikësohen se çdo

kthim i serbëve mund të sjellë kthimin e regjimit serb" do të jetë shumë vështirë që të organizohet kthimi.[92] Të tjerët e vendosin kthimin në një kontekst paksa tjetër, duke pohuar se kthimi i serbëve në Kosovë mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse ata e pranojnë realitetin e ri të krijuar në Kosovë. Komunitetet tjera në njerën apo në tjetrën mënyrë janë pajtuar që ta bëjnë këtë dhe e kanë bërë atë publike përveç komunitetit serb.[93] Ky deklarim e shtroi rrugën për një "Platformë për Veprim të Përbashkët" nga udhëheqësit shqiptar dhe ata të RAE. Kjo platformë në mes tjerash e kundërshtoi nocionin e fajësisë kolektive, deklaroi hapat për kuptimin më të mirë të nevojave të komunitetit Kosovar të RAE, u zotua për një proces të kthimit, ndërmori hapa për ndryshimin e perceptimeve përmes mediave, u zotua për zhvillimin e një programi të posaqëm që fëmijët e komuniteteve RAE të kenë qasje në arsim, dhe emancipim përmes pjesëmarrjes.

Të kthyerit serb në anën tjetër shpesh preferonin që të mbesin lojal ndaj Beogradit dhe udhëheqësisë së Kosovës veriore që kishin aspirata për ndarje, përkundër serbëve në pjesët tjera të Kosovës që kishin një interes më të theksuar në përmirësimin e marrëdhënieve më bashkësinë ndërkombëtare dhe me shqiptarët pa u armiqësuar me Beogradin. Shpesh thuhet se një marrëveshje gjithmonë ka nevojë për dy palë. Sipas UNMIK-ut, "Dialogu ndëretnik kërkon jo vetëm angazhimin pozitiv të komunitetit shqiptar të Kosovës, por gjithashtu edhe një vullnet nga ana e serbëve të mbetur në Kosovë që të marrin pjesë në komunikim pozitiv dhe masa të ndërtimit të mirëbesimit me shqiptarët e Kosovës përmes strukturave udhëheqëse komunale dhe përmes kolegëve nga komunitetet."[94] Pasi që vullneti i njohjes së strukturave të sapo formuara nga serbët lokale ishte mjaft i ulët, UNMIK-u nënkuptueshëm pranoi këtë paqësim të dyfishtë të komuniteteve, duke arsyetuar kështu një sistem paralel për komunitetin serb.

Institucionet pararelele

Derisa sistemi paralel do të mund të arsyetohej në një fazë të hershme si mjet për mbrojtje, shumë shpejt u bë e qartë se në planin afat-gjatë kjo do të shkaktonte shumë probleme. Diku rreth më shumë se tri vite më vonë, megjithëse zyrtarisht ilegale për administratën e UNMIK-ut, institucionet parelele serbe veprojnë gati në çdo enklavë brenda Kosovës, përderisa pjesa veriore madje është lidhur në mënyrë ilegale me sistemin e Telekomit Jugosllav dhe me sistemin energjetik serb. Si rezultat e kësaj, komunitetet mbesin fizikisht të mbyllura ndaj njëra tjetrës me nivele shumë të kufizuara të komunikimit.

Kjo "garanci" afat-shkurte sjell një izolim të përhershëm të minoriteteve dhe një dështim afat-gjatë. Një çështje e veçantë që ngritet, nën kontekstin e institucioneve në ndërtim e sipër të vetëqeverisjes në Kosovë, është ajo e ekzistencës së vazhduar dhe fortifikimit të strukturave paralele, që gjithnjë e ma shumë po bëhen të dëmshme për sigurimin e qasjes në shërbimet thelbësore për pakicat.[95] Tri vite më vonë, luftimi i këtyre institucioneve në planin afat-gjatë do t'i përmirësonte marrëdhëniet ndëretnike, do të nxiste integrimin dhe do të krijonte një elitë të serbëve lokal që do t'i mbronin intere-

sat e veta në mënyrë më të mirë se Beogradi.

Derisa dikush mund të pohoj që në disa rast strukturat paralele vazhdojnë të jenë të paevitueshme si një mjet i përkohshëm për shkak të pasigurisë dhe kufizimeve në lirinë e lëvizjes, këto struktura në fund të fundit do të ofrojnë një shërbim të paqëndrueshëm të klasit të dytë për pakicat dhe do të pengojë format e rëndësishme të bashkëveprimit ndëretnik. Është përfunduar se progres i vogël është bërë në këtë çështje. Në të vërtet, disa aspekte në qytetin e ndarë të Mitrovicës janë keqësuar gradualisht. Pavarësisht nga zotimi dhe përpjekjet e shumta të shumë individëve të devotshëm brenda departamentit përkatës të Strukturave të përbashketa qeverisëse, strukturat komunale dhe OJQ-të e shumta, ofrimi i shërbimeve shëndetsore ende bëhet me shërbim të ndarë shëndetsor për grupet e ndryshme etnike.[96]

Deri më tash, paralelizmat kanë qenë më të dukshme në shëndetsi dhe arsim (të pranuara nga UNMIK-u dhe të paguara nga UNMIK-u dhe shpesh të paguara dyfish edhe nga strukturat e Beogradit) dhe gjykatat (të papranuara nga UNMIK-u por heshturazi të lejuara të veprojnë). Si shembull i përpjekjeve të UNMIK-ut për t'u marrë me strukturat tashmë të fryera paralele dhe me fortifikimin e mëtutjeshëm të tyre është rasti i vonshëm kur UNMIK-u emëroi një drejtor të ri të spitalit në Graçanicë, i cili nuk u pranua nga shumica e punëtorëve që do të pranonin paga më të ulta nga buxheti i konsoliduar i Kosovës.[97] Ky rast gjithashtu pasqyron mosmarrëveshjet në mes të forcave të ndryshme politike.

Rindërtimi dhe mundësitë ekonomike

Një parakusht tjetër kryesor për kthim ishte rindërtimi i shtëpive dhe infrastrukturës së shkatërruar, për çka shumë donatorë kanë dhënë me miliona dollarë. SHBA, Italia, Gjermania, Zvicra, Agjensioni Europian për Rindërtim, Serbia, UNHCR dhe agjensitë tjera kanë dhënë afër njëzet milionë dollarë dhe kanë premtuar akoma më shumë. Sidoqoftë, përderisa ndërtimi i shtëpive është i nevojshëm, nëse kjo qasje do të garanton qëndrueshmëri, atëherë ka nëvojë që të përcillet me një proces politik që momentalisht është larg realizimit. Siq ishte situata në fund të vitit 2002, shumica e të kthyerve me më shumë gjasë do ta shesin pronën e tyre dhe do të largohen për në Serbi përsëri.

Shitja e pronës paraqet një çështje tjetër, mbijetesën ekonomike të kthimit. Kur kemi të bëjmë me kthimin, UNMIK-u kryesisht u përqëndrua në çështjet operacionale. Derisa ana ekonomike e kthimit nuk është harruar, kjo çështje në një masë është jashtë kontrollit të tyre. Derisa është e kuptueshme se disa komunitete mund të përfitojnë në mënyrë disproporcionale nga ekonomia, mbijetesa ekonomike e minoritetit serb është brengë e përgjithshme e ekonomisë kosovare, që në anën tjetër ishte një dështim. Qasjet joadekuate për çështjet e pronës, korniza ligjore, politika joadekuate e doganave, mungesa e ligjit komercial, sistemi joadekuat i arsimit që nuk i përshtatet nevojave të tregut, një rritje e analfabetizimit, krimi i organizuar, korrupsioni dhe nepotizimi, qasja joadekuate për ndërmarrjet shoqërore[98], të gjitha së bashku kane ndikuar në perspek-

tivë të dobët për ekonominë kosovare. Natyrisht, madje edhe futja fillestare e sasive të mëdha të parave nga një prani jashtëzakonisht e madhe ndërkombëtare kryesisht u drejtua në të mirën e shumicës dhe duket se nuk është investuar në bizneset afat-gjate vetëgjeneruese, por në investime të paqëndrueshme dhe të planifikuara dobët që u fundosën njëjtë si rënia drastike e industrisë së teknologjisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjithashtu mund të identifikohet rrjedha natyrale e popullatës serbe nga Kosova që nga vitet 1980. Madje edhe para konfliktit dhe përkundër faktit se një numër disproporcional i vendeve të punës të paguara mirë iu ndanë popullatës serbe, serbët dhe posaqërisht rinia kishin tendencë të migrimit në Beograd nga Kosova relativisht rurale. Serbia e brendshme vazhdon ta përjetojë një trend të ngjashëm edhe sot. Për më tepër, kur krahasohet me Serbinë, Kosova ofron perspektivë të kufizuar ekonomike madje edhe për shqiptarët. Këto argumente nuk kanë për qëllim paraqitjen e anës së keqe të asaj që mund të pritet në këtë drejtim, por të paraqesë një argument real se me çka ballafaqohet administrata e KB-së dhe gjithnjë e më shumë edhe qeveria lokale. Madje edhe udhëheqësit serb pyesin veten për numrin e serbëve që me të vërtet deshirojnë të jetojnë në Kosovë, një numër që mbetet plotësisht i panjohur (Radosavljevic 2000/28/10). Një aktivist i njohur për të drejtat e njeriut, Adem Demaçi, thekson se si boshnjakët që kanë qenë shumë mirë të pranuar gjithnjë e më shumë janë duke u larguar pasi që kanë provuar fatin e tyre për disa vite pas luftës. "Ne po përpiqemi që t'i kthejmë disa, përderisa të tjerët po largohen pasi që nuk kanë kurrëfarë perspektive ekonomike tani tri vite," pohon Demaçi.[99]

Duke iu shmangur kësaj pyetje (sa vetë dëshirojnë me të vërtet të kthehen?) gjithashtu na kthen në çështjen pamundësisë së matjes së suksesit në këtë drejtim. Pavarësisht nga numri i atyre që janë kthyer, çështja mund të vlerësohet si sukses ose të kritikohet, varësisht nga ngjarjet rajonale dhe globale të miqësisë.

Menaxhimi i pronës

Kosova për aq sa mund t'i kujtohet ndokujt nuk ka pasur sistem të kënaqshëm të pronës. Pavarësisht nga trashëgimia e problemeve gjatë gjithë shekullit, situata në Kosovë që nga 1989 (kur u anulua autonomia), ka krijuar shumë probleme.

"Sistemi pronësor filloi të shembet që nga viti 1989, kur regjimi i Beogradit nisi me nxerrjen e ligjeve gjithnjë e më shumë diskriminuese për popullatën shumicë shqiptare. Si rezultat i kësaj, një numër i madh i shqiptarëve humbën të drejtën e banimit në pronat shoqërore, të cilat pastaj iu shpërndanë serbëve të Kosovës ose refugjatëve serb nga Kroacia. Si pasojë e kësaj, shumica e transaksioneve pronësore në mesin e komunitetit shqiptar gjatë kësaj kohe u kryen në mënyrë joformale (p.sh. pa shënime ligjore) që patën për pasojë humbjen e vlerës së regjistrave pronësore dhe kadastrale, çelës për secilin sistem funskional të pronës, si dokumentacione të sakta."[100]

Pas luftës, vendimi për ligjin e zbatueshëm lidhur me pronën ishte shumë konfuz, dhe

shumë vetë e shtruan pyetjen se nëse të gjitha transaksionet pronësore pas heqjes së autonomisë duhet të shpallen të pavlefshme. Për më tepër, prona u shit në mënyrë masive pas luftës, ku një pjesë u shit nën detyrim. Shumë njerëz që e kishin humbur pronën gjatë dhjetë viteve gjithashtu u përpoqën që të kthejnë atë që e panë se iu është marrë në mënyrë të padrejtë nga regjimi. Gjithashtu, pas luftës, nuk ekzistonin institucionet për sigurimin e ligjshmërisë së të gjitha transaksioneve pronësore dhe u paraqitën shumë raste ku prona e njëjtë i është shitur më shumë njerëzve, gjë që dërgoj në shumë mosmarrëveshje.

"Shumë prona kanë pretendues të shumëfishtë për pronësi, dhe vërtetimi i pronësisë është jashtëzakonisht i vështirë. Duke pasur parasysh vakumin institucional dhe mungesën e respektit për sundimin e ligjit, është pak i habitshëm fakti që uzupimet dhe ndërtimet e paligjshme janë aq të përhapura. Problemet shtohen edhe më shumë me valën e kthimeve vullnetare ose të detyruara të kosovarëve në vend, që nga arritja e UNMIK-ut dhe KFOR-it."[101]

Në kohën kur UNMIK-u e kuptoi rëndësinë e menaxhimit të pronës dhe të regjistrave të mirë kadastral, e krijoi Drejtoratin për Banim dhe Pronë (DBP) të menaxhuar nga Habitati, që shpesh konsiderohet si një ndër dështimet kryesore të misionit ndërkombëtar Madje edhe tri vite pas luftës, çështja mbetet si pengesë kryesore jo vetëm në kthimin e popullatës së zhvendosur, por gjithashtu edhe në zhvillimin e ekonomisë, në dhënien fund shumë mosmarrëveshjeve, investimeve të huaja, dhe privatizimin.

Një problem i rëndësishëm gjithashtu u paraqit me atë që bashkësia ndërkombëtare e quajti "shitja strategjike" e pronës në pronësi të pakicave, që mund të definohet si praktikë me të cilën pronarët minoritare të pronës, me vendndodhje në lokacionet e rëndësishme strategjike brenda zonave minoritare, janë të shtyer që të shesin pronën, si pjesë e, çfarë duket të jetë, një fushatë të organizuar.[102] Një përpjekje është bërë për ndalimin e kësaj duke kërkuar leje për kryerjen e transaksioneve pronësore ndëretnike. Shpejt është refuzuar si ide.

Madje edhe për të zhvendosurve që kanë planifikuar të kthehen, sa më shumë që kalon koha aq më mirë ata stabilizohen në vendbanimet e reja të tyre dhe më pak kanë gjasa që të kthehen. Çmimet jashtëzakonisht të larta të patundshmërive në qendër të Prishtinës, të nxitura nga një numër shumë i madh i të huajve dhe nga rritja e shpejtë e Prishtinës, popullata e së cilës u dyfishua pas luftës, shërbyen si nxitje shtesë për shitjen e pronës. Shumica e pronës minoritare në qendër të Prishtinës tashmë është shitur, shumica e së cilës mbi çmimet e tregut për shkak të kërkesës së madhe për banim pas luftës. Një apartament në Prishtinë normalisht është shitur dy herë me shtrejntë se një i tillë në Serbinë e brendshme dhe zakonisht më shtrejntë se në Beograd. Pas blerjes së pronës, gjithashtu duhet të shikohen edhe ligjet themelore të tregut dhe oferta mjaft e kufizuar pas luftës. Gjithashtu trendi është që shumica e apartamenteve shiten në vendbanimet shqiptare e jo në enklava. Arsyeja është se shqiptarët nuk do të blejnë pronë në të cilën nuk mund të vendosen menjëherë. UNMIK-u nuk mund të bëjë shumë në këto raste përveç se jozyrtarisht të përfundojë se serbët pa pronë në Kosovë më gjithë gjasë

nuk do të kthehen në Kosovë.

Të drejtat grupore dhe mbipërfaqësimi i komuniteteve pakicë

Bashkësia ndërkombëtare gjithashtu ka bërë përparime duke punuar bashkë me udhëheqësinë lokale, por shpesh duke nxituar me qëllim të menjanimit të kritikave nga të tjerët, në krijimin e të drejtave të posaqme për komunitetet minoritare.

Njëri ndër sukseset më të shquara ishte krijimi i një sistemi proporcional strikt dhe njëzet vende të rezervuara në Kuvend, dhjetë për serbët dhe dhjetë për pakicat tjera. Ne nuk mund të gjejmë ndonjë pakicë tjetër në Europë që është i mbi përfaqësuar në këtë shkallë. Nga 120 vende në Kuvendin e Kosovës, përfaqësimi i përgjithshëm serb e zë vendin e bllokut të tretë politik me 21 vende (11 te fituara, 10 të ndara), vetëm pesë më pak së blloku i dytë shqiptar.

Kuvendet Komunale gjithashtu zgjedhen me një sistem proporcional, por pa vende të ndara. Pritet që serbët do t'i marrin së paku tri komuna (që të trija në veri) dhe gjithashtu kanë potencial të marrjes së edhe dy komunave tjera (Novo Bërdë dhe Shtërpcë). Është me rëndësi të përmendet që tri nga këto pesë komuna e kanë fituar statusin e komunës gjatë regjimit të Millosheviqit (Zubin Potoku, Novo Bërda dhe Shtërpca) dhe një pas arritjes së administratës ndërkombëtare (Zveçani). Megjithëse të anuara drejtësisht kah pakica serbe, rregullat e lojës në përgjithësi janë pranuar nga të gjithë, sado që komuniteti serb i ka vënë dy kushte/kërkesa kryesore që janë refuzuar nga UNMIK-u dhe nga administrata lokale deri më tani: krijimi i komunës së dytë në Mitrovicë dhe implementimi i një plani të decentralizimit. Si përgjegje ndaj kësaj, UNMIK-u ka krijuar një grup të përbashkët në mes të UNMIK-ut dhe Qeverisë së Kosovës për decentralizimin. Gjithashtu është vendosur se asnjë komunë e re të mos formohet, megjithëse Korniza Kushtetuese nuk e specifikion numrin e përgjitshëm të komunave.

Në terma të ujdisë politike, situata nuk është fare e zymtë. Serbët janë efektivisht në qeveri, jo si partner koalicioni, por nëpërmjet të një marrëveshjeje që i jep një post ministror serbëve dhe një pakicave tjera. Efektivisht, serbët dhe pakicat tjera (të cilët e marrin këtë me rotacion) janë të përfaqësuar në qeveri. Minoritetet gjithashtu kanë poste të larta në qeveritë komunale: një egjiptian ishte nën-kryetar i Kuvendit Komunal të Gjakovës dhe një serb në Viti.

Pakicat në Kosovë gjithashtu kanë përjetuar ndryshimin e brengave dhe prioriteteve gjatë kohës. Derisa siguria kur nuk ishte problem për komunitetin turk, ka shënuar rënie drastike për komunitetet boshnjake, goranët, ashkalitë dhe egjiptianët, por ende mbetet problem për serbët dhe romët. Në përgjithësi, zonat e vendbanimit të minoriteteve janë të sigurta, sidoqoftë, liria e lëvizjes mbetet problem për disa pakica lokale përgjatë Kosovës. Megjithëse shumë serb vozisin veturat e veta për në Serbi duke kaluar nëpër Prishtinë dhe pjesën tjetër të Kosovës, ekziston një dozë e frikës për shkak të rrezikut objektiv dhe të perceptuar. Shqiptarët në anën tjetër preferojnë që të mos udhëtojnë në enklava, derisa udhëtimi në veriun e Kosovës është jashtë konsiderimit. Pakicat lokale

në këtë kontekst gjithashtu përfshijnë edhe shqiptarët që jetojnë në pjesë e dominuar me serb në veri të Kosovës, çështje që zakonisht mbetet pak e raportuar.

UNHCR-i dhe OSBE-ja raportojnë për një rënie graduale të krimeve dhe dhunës kundër të gjitha pakicave. Derisa niveli i krimit ndëretnik u rrit në mënyrë të dukshme disa muaj pas luftës, që nga ajo kohë ka shënuar rënie të vazhdueshme. Në përgjithësi, incidentet serioze të sigurisë kanë shënuar rrënie. Çfarë mbetet e pa raportuar në këto raporte është rritja e përgjithshme ne numrin e përgjithshëm të krimeve. Çështja e sigurisë është diskutuar në më shumë detaje në pjesën paraprake të këtij punimi.

Një zhvillim kryesor pozitiv në këtë drejtim ka qenë ndryshimi i strategjisë së KFOR-it në ruajtjen e enklavave. Duke ndryshuar nga prania e qartë ushtarake në një prani më të brendshme me patrullime të shpeshta të lëvzishme ky ndryshim u tregua si shumë i suksesshëm. Më forcimin gradual të autoriteteve të zbatimit të ligjit (megjithëse në rastin më të mirë të pakënaqëshme) mungesa e kullave të vrojtimit dhe tankeve në hyrje të fshatrave minoritare krijon një efeket pozitiv psikologjik që ndikon edhe në popullatën e jashtme shumicë si dhe e ul ndjenjën e izolimit në mesin e minoriteteve. Përveç incidenteve të vogla, numri i tyre mbetet i njejtë. Patrullimi i lëvizshëm gjithashtu përmirëson lirinë e lëvizjes në arteriet kryesore të transoprtit dhe siguron një lëvizshmëri më të sigurtë për pakicat.

Mbase një nga vendimet më të dëmshme të bashkëisë ndërkombëtare, që në pjesën më të madhe është zbatuar pa pëlqimin e mëhershëm të elitës lokale politike, ishte që data e 1 janarit 1998 të merret si vendimtare në përcaktimin e banorëve të Kosovës. Për pakënaqësinë e popullatës ky vendim i jepte të drejtën e votës refugjatëve serb nga Kroacia dhe Bosna që kanë qenë përkohsisht të vendosur në Kosovë, ndërsa ia merrte të drejtën e votimit qindra mijëra shqiptarëve nga diaspora kosovare nga të gjitha përktësitë etnike që ishin larguar gjatë represionit dhjetëvjeçar.

Sipas regjistrimit të popullsisë me 1991, në Kosovë jetonin 194.190 serbë.[103] Në anën tjetër, UNHCR/OSBE e vendosën numrin e pakicave të zhvendosura nga Kosova (Në Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi) në 235.000 (200.000 nga ta serbë) derisa 20.000 janë të zhvendosur brenda Kosovës.[104] Numri i votuesve të regjistruar ka qenë 170.000. Ekzistojnë shumë kundërthënie lidhur me këta numra, që kanë ngritur dyshimet në motivet e mundshme të fshehura për lojra të ndryshme statistikore.

Praktikat e mira

Gjithashtu kemi edhe tregime të sukseseve pas luftës në Kosovë. Përveç disa rasteve të kthimit, ne kemi identifikuar disa çështje që mund të ndriqojnë atë që është bërë në ta kaluarën. Qyteti i Gjilanit është një shembull ku serbët kanë shëtitur lirisht nëpër qytet me të drejtën e plotë të fjalës. Kjo shpesh i ngarkohet (i) kryetarit të ri dhe energjik të komunës dhe (ii) një udhëheqësi serb që ishte i gatshëm të shtrëngoj dorën e ofruar të miqësisë. Qendra e skijimit e menaxhuar nga serbët lokal në Shtërpcë filloi të përdoret nga shqiptarët dy vite gjysmë pas konfliktit. Kjo është shenjë se motivimi i parasë dhe

angazhimi i bashkësisë ndërkombëtare e mundësuan këtë. Sidoqoftë, pronësia mbi këtë qendër është diskutabile. shqiptarët, serbët dhe të tjerët raportohet se kanë raporte të shkëlqyera në qendër të Prishtinës në shtëpinë për personat me aftësi të kufizuara dhe për penzionerë.[105] Më e rëndësishmja nga të gjitha është ndryshimi i qëndrimit në mesin e mediave të cilët tani i raportojnë me të madhe lajmet mbi raportet e mira ndëretnike. Disa media i kanë kontribuar përpjekjeve të pajtimit duke kërkuar tregime të mira të bashkëjetesës ndëretnike dhe pastaj i kanë publikuar këto gjerësisht në mënyrë pozitive. Potezi më i suksesshëm ishte krijimi i "targave të përbashkëta", të kopjuara pas suksesit në Bosne. Pavarësisht nga suksesi mesatar në Kosovë, kur nuk e arriti nivelin e Bosnës, sepse serbët ndjenin një dozë të tjetërsisë ndaj targave të reja kosovare. Serbët sot i shfrytëzojnë targat kosovare për të udhëtuar brenda Kosovës dhe i ndërrojnë ato me targat e vjetra të lëshuara nga autoritetet serbe posa të hyjnë në Serbi.

Mësimet e mësuara për misionet e ardhshme:

Për çdo zgjidhje afat-gjate që do ta durojë testin e kohës, bashkësia ndërkombëtare ka nevojë që të përfshijë komunitetet lokale në procesin e vendim-marrjes; t'i transferojë kompetencat administrative dhe politike qysh heret (e ngrit zotimin dhe përgjegjësinë lokale para zgjedhësve të vet);

Ndërtimi i strukturave transparente dhe përgjegjësisë më të mirë. Stafi nga qindra shtete ka interesa dhe mënyra të ndryshme të punës dhe mungesa e hierarkisë së qartë dhe përgjegjësisë shkakton rritjen e korrupsionit, papërgjegjësisë politike dhe paefektshmërisë;

Të jetë e vëmendshme për balanset entike dhe balanset e mëparshme të pushtetit të grupeve lokale etnike dhe të forcave politike (duke e favorizuar një pakicë që ka ushtruar një regjim të llojit të aparteidit mund t'ja përkujtojë shumicës padrejtësinë e të kaluarës);

Një strukturë administrative duhet gjithmonë të qëndrojë larg vendimeve politike, përkundër paevitueshmërisë së kësaj; ajo duhet që qysh heret ta ngris veten si organ legjitim lokal. Mbajtja e kontakteve më të afërta me komunitetin do t'i ndihmojë bashkësisë ndërkombëtare që t'i kuptojë më mirë ngjarjet dhe të ndërtojë marrëdhënie më të shëndosha me zgjedhësit lokal;

Ndërtimi i një sistemi për zgjidhjen e kontesteve pronësore dhe i nje sistemi kadastral efektiv qysh herët. Prona është çelësi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndëretnike.

Rekomandimet mbi politikat

Kthimi: Të promovohet përfshirja e institucioneve kosovare për një proces të qëndrueshëm të kthimit duke dhënë kompentenca dhe përgjegjësi të vërteta; të depolitizohet procesi i kthimit; kundërthëniet në numra mundësojnë politizimin e çështjes dhe lejojnë hapësirë për deklarime skandaloze nga të gjitha anët nga palët që kanë për qëllim përke-

qësimin e mëtutjeshëm të konfliktit. Si të tilla, opinioni dhe Qeveria e Kosovës kanë më shumë gjasë që ta kuptojnë ndjenjën e posedimit ndaj procesit dhe të zotojnë financim nga buxheti kosovar për çështjen e kthimit; të sigurohen kushtet për kthim vullnetar dhe të sigurtë që e kthen dinjitetin e të kthyerve me shërbime adekuate publike dhe mbështetje nga komuniteti vendës;

Politikat rajonale: të ushtrohet presion mbi Beogradin përmes bashkësisë ndërkombëtare për mos mbështetjen e institucioneve paralele; të shfuqizohet menjëherë sistemi paralel i drejtësisë. Gradualisht të punohet me shëndetësinë dhe arsimin. Praktika sipas së cilës rastet minoritare udhëhiqen nga gjyakatësit minoritarë të zëvendësohen me monitorim të afërt nga OSBE-ja.[106]

Bashkëveprimi ndëretnik: Mbështetje publike për partitë politike dhe organizatat joqeveritare që merren me përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike; të kërkohen mundësitë për hapa praktike për rritjen e komunikimit të përgjithshëm ndëretnik, siq janë tregjet e përbashkëta, apo të ngjashme; Patrullat e përziera policore në të gjithas zonat minoritare.

Krijimi i sundimit të ligjit në krejt Kosovën: Qytetarët e zakonshëm në Kosovën veriore mbështesin krijimin e sundimit të ligjit dhe nuk guxojnë që të konfrontohen me krimin lokal të organizuar që ka lidhje të ngushta me elitën politike.

Të fillohet me qasjen e çështjes së statusit në forume joformale. Sidoqoftë, kjo është një çështje e ndjeshme që mban peng një numër të çështjeve tjera.

Nevoja për një strategji të tërheqjes për misionin ndërkombëtar civil. Bashkësia ndërkombëtare duhet t'i përgatisë komunitetet lokale për bashkëjetesë dhe qeverisje në rast të uljes drastike të buxhetit, stafit apo kompetencave të misionit ndërkombëtar. Kjo hap rrugën për shumë interpretime që shtrihen prej: kërcënimit institucioneve shqiptare se ato serbe mund të kthehen, kërcënimet ndaj popullatës serbe, presioni për zgjidhjen e statusit. Pasi që fondet e sjellura nga bashkësia ndërkombëtare pakësohen, aq më pak të nevojshme do të shihen ato në sytë e lokalëve dhe aq më shumë do të insistojnë ata në kompetenca dhe autorizime.

Më qëllim të përmirësimit të besimit në mesin e komuniteteve, të gjithë stakeholders duhet të konsiderojnë formimin e **Komitetit të së Vërtetës dhe Pajtimit** me përfaqësues të të gjitha komuniteteve dhe të bashkësisë ndërkombëtare; Gjykimi i kriminelëve të luftës gjithashtu do të krijojë ndjenjën e drejtësisë në mesin e viktimave dhe do t'i ndhmojë atyre që ta drejtojnë zemërimin e tyre kundër individëve specifik të gjykuar për krime në vend të fajësimit të komunitetit në mënyrë kolektive; të ushtrohet presion në Beogradin për falje/njohje publike për vuajtjet.

Përmirësimi i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik: të investohet në infrastrukturën rurale, se kjo ka qenë njëra ndër trashëgimitë kryesore të sistemit komunist. Ky është një parakusht për zhvillimin rural; të krijohet një "parim i solidaritetit" (një fond për fondet e pazhvilluara në Kosovë) për të siguruar se asnjë rajon nuk mbetet prapa të tjerëve në mënyrë drastike, që do të ishte në të mirë të pakicave dhe popullatës rurale.

Të mbështetet **autonomia jo-territoriale për të gjitha komunitetet** (shkallë e lartë e të drejtave grupore) në vend të ideve të reja se si të ndahen territoret brenda komunave; të promovohen lidhjet e posaçme kulturore me komunitetet amë (serbët me Beogradin, turqit me Ankaranë si mjet i promovimit të mësimit të gjuhës dhe studimit të kulturave të veta); t'i qaset propozimit të decentralizimit të Qendrës Koordinuese (të përpiluar nga koalicioni Povratak) në mënyrë të kujdesshme pasi që kjo mund të shkaktojë kantonizimin, ose çfarë frikësohen shqiptarët "një entitet i ndarë gjeografik serb brenda Kosovës". Idetë për decentralizim të mëtutjeshëm duhet të mbështeten , por me kujdes për shkak të burimeve të kufizuara administrative dhe kapacitetit të kufizuar njerëzor. Përveç implikimeve politike, të thjeshtëzimit dhe zvogëlimit të administratës dhe qeverisë lokale dhe të mos burokratizohen ato edhe më shumë deri në pikën kur mund të jenë të paqëndrueshme;

Të ndihmohet Kuvendi për miratimin e **ligjeve jo-diskriminuese** në pëgjithësi; serbët dhe grupet tjera të ndikuara do të përfitojnë me një rezultat të përgjithshëm pozitiv të nivelit të tolerancës të shoqërisë kosovare.

MISIONI I PARË I BASHKIMIT EVROPIAN

Derisa raundi i parë i negociatave të para të akcesimit janë duke vazhduar për dhjetë shtete anëtare për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Kosova mbetet një rast unik. Kosova tanimë është duke e shfrytëzuar Euron si valutë zyrtare, Prishtina është e mbuluar me flamuj të kaltër dhe te verdhë për festimin e ditës së Europës më 9 Maj dhe ministri i parë i Financave të Kosovës ka qenë një zyrtar i Komisionit Europian. Premtimi për 'Europianizimin' e Kosovës dhe integrimit në familjen Europiane vazhdimisht është shtruar si karrotë për të shtyer përpara reformat në të gjitha nivelet. Ekziston një prani gjithpërfshirëse e Europës dhe institucioneve të saj në Kosovë, premtimi sidoqoftë mbetet mjaft i mjegulltë. Nëse kjo paqartësi nuk do të ndryshojë, Ballkani do të mbetet një ishull i jostabilitetit në zemër të Europës, duke eksportuar emigrantë dhe importuar paqeruajtës.[107]

Paqeruajtësit, këshilltarët dhe ekspertët të të gjitha profileve janë të shumtë në Kosovë. Më 10 qershor 1999, puna e Bashkësisë Europiane dhe të organizatave tjera ndërkombëtare ishte e mirëpritur nga vendorët për të zhvilluar një qasje bashkëkohore drejt zhvillimit ekonomik dhe stabilizimit të rajonit të ndikuar nga kriza e Kosovës.[108] Kjo ishte referenca e vetme e Rezolutës 1244 në Bashkimin Europian, dhe u bë bazë e zotimit serioz nga Bashkimi Europian dhe shteteve anëtare të saj për të rindërtuar, renovuar dhe zhvilluar Kosovën dhe ekonominë e saj. Nuk ekzistonin procedura interne apo raste precedente në të cilat do të mbështetej - vetë Europa asnjëherë nuk ka qenë 'në mision' - Shtylla e Bashkimit Europian (ose shtylla IV) si pjesë e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) duhej të zbuloheshin nga asgjëja.

Në gusht të vitit 1999, Shtylla e BE ishte vetëm një grumbull i shtatë ekspertëve të komisionit dhe stafit mbështetës të kyresuar nga Jolly Dixon.[109] Gjatë vitit të parë të ekzistencës së saj, Shtylla e BE-së nuk ishte Europiane në kuptimin se është përbërë nga stafi prej Bashkimit Europian. Në të vërtetë, mund të thuhet se njëri ndër sukseset e para të ndërtimit të institucioneve, Autoriteti Qendror Fiskal është implementuar në pjesën më të madhe nga amerikanët dhe australianët dhe paguar nga USAID-i. Marrëveshjet kontraktuese ndyrshonin me të madhe; stafi paguhej nga buxhetet e ndryshme, madje edhe stafi që punonte në të njejtin departament punonte në bazë të standardeve të ndryshme. Për disa muaj në 2002, nje këshilltar australian e drejtonte Shtyllën e BE-së.

Gjatë tri viteve të kaluara, Shtylla e BE-së ka qenë në rrjedhë të vazhdueshme. Me qëllim të kuptimit të politikave të Shtyllës së BE-së, duhet të merret parasysh ndërtimi dhe zhvillimi i saj unik. Mandati dhe përgjegjësitë e saj kanë ndryshuar, burimet e saj kanë ndryshuar dhe struktura e saj e brendshme është ndryshuar disa herë. Poashtu, Shtylla e BE-së është ballafaquar me ndryshim të shpeshtë të stafit. Pozita e Zëdhënësit është ndryshuar katër herë. Në fund, asnjë institucion tjetër ndërkombëtar në Kosovë nuk ka pasur aq shumë ndryshime dramatike që nga vera e vitit 1999 deri më tani.

Sot, Shtylla e BE-së dhe institucionet në të cilat stafi i saj luan një rol udhëheqës janë

përgjegjëse për një masë mahnitëse të të mirave, njerëzve dhe detyrave. Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit[110] është përgjegjës për privatizimin apo likuidimin e më shumë se 400 kompanive në pronësi shoqërore dhe publike dhe të mirave të tyre. Autoriteti i Bankave dhe i Pagesave, autoritet i të ardhurave të Kosovës, doganat, të gjitha shërbimet publike, aeroporti dhe interesimet kryesore si kompania Trepça janë të menaxhuara, administruara dhe mbikqyrura nga Shtylla e BE-së. Shtylla e BE-së gjithnjë ka qenë shtylla më e vogël në mesin e katër shtyllave të UNMIK-ut, por një shtyllë që vazhdimisht është rritur ne kuptim të personelit dhe përgjegjësive. Në vitin 2002, Shtylla e BE-së kontrollon resurse të mëdha, merr vendime kyqe ekonomike dhe drejtpërsëdrejti menaxhon me institucionet kryesore. Vendimet e shtyllës së BE-së ndikojnë në ndërmarrjet shoqërore, mbi 50.000 biznese private të regjistruara dhe gati në çdo shtëpi në Kosovë.

Menaxhimi i një grupi kaq të madh të resurseve dhe përgjegjësive në mënyrë efektive kërkon një prani të fortë në terren, një njohje të mirë të kontekstit të veçantë institucional dhe ligjor të Kosovës, njohjen e trashëgimisë jugosllave të socializmit dhe institucioneve publike, dhe të një sistemi për ndarjen e gjerë dhe menaxhimin e resursit më të rrallë të Kosovës: informatat e besueshme.

Shtylla e BE-së gjithnjë ka pasur pjesën më të vogël të stafit të vet jashtë Prishtinës, duke krijuar një prani modeste në terren vetëm që nga fillimi i vitit 2000.[111] Zyra e parë rajonale e Shtyllës së BE-së në Mitrovicë u hap në prill të vitit 2000, me një anëtarë ndërkombëtar dhe një vendor. Struktura rajonale e KB-së në Mitrovicë në atë kohë, pa administratat komunale në rajon, punësonte diku rreth tridhjetë ndërkombëtar. Në verën e vitit 2001, vetëm njëzet e një punëtorë të Departamentit të Tregtisë dhe Industrisë ishin përgjegjës për më shumë se 400 ndërmarrje shoqërore ne Kosovë. Disa nga këta ekspertë ndërkombëtar ishin të njohur me socializmin jugosllav dhe me veçantitë e tij si vetë-udhëheqja e punëtorëve dhe prona shoqërore. Kuptimi ligjor dhe praktik i koncepteve të veçanta jugosllave si "prona shoqërore" vazhdon t'i hutojë ekspertët ndërkombëtar sot.

Ringjallja e fantazmave

Zhvillimi i Shtyllës së BE-së dhe kufizimet e saj më së miri tregohen me shembullin e kompetencave mbi frutet e zhvillimit socialist të Kosovës-katërqind e më tepër ndërmarrje shoqërore (NSH) të Kosovës. Të kufizuar nga mungesa serioze e informatave të besueshme mbi realitetin në terren, të penguara nga burimet e veta të kufizuara administrative dhe të drejtuara gabimisht nga stafi i painformuar, Shtylla e BE-së aksidentalisht i rigjallëroi fantazmat e Jugosllavisë socialiste.

Për një vit e gjysmë të parë nuk kishte fare prani të Shtyllës së BE-së në terren, dhe autorizimi i të vepruarit si administrator ose kujdestar i të gjitha ndërmarrjeve që janë industriale ose tregtare për nga natyra[112] u transferua në Departamentin e Tregtisë dhe Industrisë (DTI) vetëm në Dhjetor të vitit 2000.[113] Që nga fundi i vitit 1999 deri në fund

të vitit 2000, administratorët e KB në nivel komunal u përpoqën në mënyrën më të mirë që t'i drejtojnë aktivitetet e ndërmarrjeve shoqërore në territorin e tyre duke i rivendosur kontrollet institucionale dhe kërkesat raportuese të kohës së socializmit.

Pas zgjedhjeve të para komunale në Kosovë, disa mosmarrëveshje u paraqitën rreth kontrollit mbi këto NSH,[114] posaqërisht në ato ndërmarrje që kishin të ardhura stabile nga lëshimi me qira i objekteve të tyre ose duke i shitur pjesët e saj. Sipas ligjit të zbatueshëm, ishte ilegale që të lëshohet me qira një objekt nën pronësinë shoqërore dhe që të shpërndahen pastaj paratë e kësaj qiraje punëtorëve në vend të ri-investimit të tyre për ta rritur vlerën e kompanisë. Pas një krize ndërmarrjen e prodhimit të metalit Zahir Pajaziti (më heret e njohur si FAN ose FAGARA) në Podujevë në shkurt të vitit 2001, Shtylla e BE-së u përpoq që t'i zgjedh konfliktet në mes të drejtorit të vetë-emëruar, kuvendit të sapo zgjedhur komunal dhe punëtorëve duke e ngjallur institucionin e këshillit të punëtorëve si trup kryesor ekzekutiv të ndërmarrjes, të zgjedhur nga kolektivi i punëtorëve në përgjithësi. Punëtorët në këto ndërmarrje ishin përsëri të aftë që të zgjedhin dhe përjashtojnë menaxherët e vet dhe që t'i shpërndajnë të ardhurat në mesin e tyre.

Sistemi i vetë-udhëheqjes së punëtorëve ka qenë në zemrën e socializmit jugosllav. Ky sistem e institucionalizoi "demokracinë" në vendin e punës nën kufizimet e sistemit një-partiak të zotuar për ndërtimin e një shoqërie socialiste. Në të njetën kohë, kolektivi i punëtorëve u ballafaqua me një rrjet të komplikuar të kufizimeve institucionale dhe ligjore. Rezultati i kësaj ishte një sistem ekonomik i përshkruar me konflikt të vazhdueshëm, në të cilin negociatat e pafunda e sfiduan prodhimin si aktivitet primar. Në kuadër të sistemit ndërmarrjet ishin të paralizuara përkundër rezultateve ekonomike të përkeqësuara në mënyrë të theksuar. Në mungesë të një dicipline të vërtetë të tregut partia komuniste ishte në qendër të zgjidhjes së konflikteve rreth burimeve të kufizuara.

Vendimi i DTI-së për rifutjen e vetë-udhëheqjes së punëtorëve ishte i bazuar në një vendim të rastësishëm të disa individëve të painformuar dhe doli se ishte një gabim fatal. Ndërmarrjet e udhëhequra nga këshillat e punëtorëve janë për nga definicioni në kundërshtim me ristrukturimin dhe zvogëlimin, dhe natyrisht i bëjnë ballë investitorëve të rinj dhe ideve të reja. Mbajtja e zgjedhjeve për këshillat e punëtorëve në rreth 100 ndërmarrje nuk ndihmoi në mbrojtjen e kompetencës së DTI-së[115] si administrator i të gjitha ndërmarrjeve shoqërore. Faktikisht, kontrolli mbi disa ndër pasuritë më të vlefshme të Kosovës vazhdon të vendoset jashtë kornizës ligjore në shumë mosmarrëveshje të ndryshme lokale. Dominon pushteti i njerëzve lokal me ndikim e jo pushteti i ligjit. Në disa ndërmarrje zgjedhjet për këshillat e punëtorëve janë mbajtur, në të tjerat drejtorët e emëruar nga qeveria e pas-luftës e UÇK-së vazhduan të mbesin në krye, në disa raste drejtorët që ishin në ato pozita para vitit 1989 u rikthyen në postet e tyre; dhe në gjashtë raste DTI-ja mori përsipër administrimin e drejtpërdrejtë.

Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë nuk i posedonte informatat më thelbësore të nevojshme për formulimin e politikave të duhura. Deri më tani, numri i vërtet i ndër-

marrjeve shoqërore në Kosovë mbetet i panjohur, poashtu mbetet i panjohur edhe numri i punëtorëve që punojnë në këto kompani dhe askush nuk mund të thotë sa hektarë tokë janë nën pronën e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore. Rinjohja e vetë-udhëheqjes së punëtorëve është një shembull perfekt se si informatat joadekuate në fund të fundit shkaktojnë politika joadekuate. Në vend të zgjidhjes së problemit të qeverisjes afariste dhe kontrollit menaxhues në ndërmarrjet shoqërore, kjo krijoi pengesa shtesë për zhvillimin ekonomik. Politika afatshkurtër e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në ndërmarrjet shoqërore me zgjedhjen e këshillit të punëtorëve duke u bazuar në Ligjin mbi Ndërmrrjet të vitit 1988 ishte formuluar pa e kuptuar mirë ambientin e ndërlikuar institucional të Kosovës, pa u përpjekur që të kuptohet trashëgimia e socializmit jugosllav dhe pa i marrë parasysh pushtetin e kufizuar të vetë DTI-së. Siq thekson Banka Botërore disa herë në Raportin e Zhvillimi të vitit 2002, shumica e punëve të rëndësishme në ndërtimin e institucioneve bazohet në modifikimin e *atyre që tashmë ekzistojnë* me qëllim të plotësimit më të mirë të instituconeve tjera dhe të kuptohet se *çka të mos ndërtohet* në konteksit e veçantë, në vend të asaj së çka të ndërtohet.[116] Madje edhe reformatorët komunist jugosllav e kishin kuptuar institucionin e vetë-udhëheqjes së punëtorëve si thembër të Akilit të sistemit ekonomik jugosllav. Si vëren John Allcock, "duke i shikuar bashkarisht, Kushtetutën e vitit 1974 dhe Ligjin e Punës së Bashkuar kontribuan më shumë se çdo aspekt tjetër në historinë e Jugosllavisë në kolapsin e saj përfundimtar."[117] Aksidentalisht, DTI e ktheu Kosovën në muze socialist të Evropës.

Sektori i panjohur privat

Informatat e kufizuara gjithashtu ndikuan në fushat e tjera të politikës që i takonin mandatit të Shtyllës së BE-së. Natyra dhe struktura e sektorit privat në Kosovë ka qenë po aq mister për vëzhguesit ndërkombëtar, sa edhe sistemi jugosllav i vetë-udhëheqjes së punëtorëve.

Në korrik të vitit 1999, Jolly Dixon deklaroi se "sfida e parë kryesore është që t'i mundësohet sektorit privat që të bëhet motor i zhvillimit". [118] Shumë vëzhgues të huaj ishin të befasuar me shpejtësinë me të cilën u ngrit sektori privat në Kosovë pas konfliktit të vitit 1999. Por në shumë mënyra ky ishte një kthim në sektorin privat të së kaluarës, që i ka rrënjët qysh para socializmit, që vazhdoi të funskionojë gjatë erës jugosllave se *mala privreda* (tregti e vogël) dhe u zgjerua dukshëm në vitet e hershme të 1990, dhe vetëm stagnoi që nga 1995 e këndej.[119]

Sektori privat i Kosovës është kryesisht i shkallës së ultë dhe me kapital të vogël. 58,3% e bizneseve të regjistruara janë të angazhuara në aktivitete tregatre dhe ndërtimore dhe 49,9% të bizneseve të regjistruara në shtator të vitit 2002 janë ndërmarrje me vetëm një person.[120] Në shumë mënyra sektori privat i Kosovës në vitin 2002 është i ngjashëm me ekonominë e SHBA-ve të viteve 1830, ku shumica e bizneseve përqëndroheshin në familje dhe dyqane të vogla që shitnin një asortiment të kufizuar të mallrave të importuara në kiosqe apo shitore të vogla. Shumica e tregtarëve në të njejtën kohë ishin edhe zyrtarë të bankës, transportues, menaxher dhe sigurues të vetvehtës.

Pavarësisht nga fakti se zhvillimi i udhëhequr nga sektori privat gjithnjë u konsiderua si një prioritet i lartë, kurrë nuk ka ekzistuar ndonjë strategji e përbashkët e Shtyllës së BE-së se si të ndihmohet komuniteti lokal i biznesit. Sektori privat asnjëherë nuk pranoi vëmendjen e njejtë me atë që ju kushtua industrive të vjetra socialiste madje burime edhe më të pakta ishin ndarë për grumbullimin e informatave të kësaj natyre. Në shumë mënyra sektori privat i Kosovës mund të paraqitet si "sektor i zi" apo "gri", por vetëm për shkak se shumë pak përpjekje janë bërë nga institucionet ndërkombëtare dhe lokale në përpjekjen për të kuptuar këtë ekonomi të re private.

Në fund të vitit 2000, DTI krijoi një Ekip për Zhvillimin e Sektorit Privat në secilin prej pesë rajoneve dhe punësoi shtatë ndërkombëtar dhe katër vendor. Këto ekipe e kaluan pjesën më të madhe të kohës në mbledhjen e informatave rreth OJQ-ve dhe institucioneve mikro krediduese, por fare nuk punuan në hulumtimin e ekonomisë reale. Brengat e tregtarëve privat mbetën të padëgjuara dhe pengesat në zhvillimin nën udhëheqjen e sektorit privat mbetën të panjohura për hartuesit e politikave në Prishtinë.

Politikat që me të vërtetë ndikonin në jetën e tregtarëve dhe prodhuesve kosovar ishin të formuluara në zyret e Misionit të Doganave të Kosovës, diskutuara ne mesin e zyrtarëve të administratës tatimore dhe të modifikuara nga legjislacioni i ri i hartuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Politikat tatimore, njohja e targave të Kosovës nga shtetet tjera, marrëveshjet për tregti të lirë dhe politikat e punësimit së bashku e krijuan kornizën në kuadër të së cilës bizneset private mund të operojnë. Në qytetin e Prishtinës, 60% e ndërmarrjeve të vogla janë momentalisht në nivelin e mbijetesës.[121] Çdo luhatje në treg ose zbatim i ndonjë politike të re tatimore mund t'i detyrojë këto biznese që t'i japin fund aktiviteteve të tyre afariste.

Zhvillimi i politikave që kanë për qëllim forcimin e sektorit privat pengohet nga përpjekjet e kufizuara dhe të pakoordinuara për mbledhjen e informatave themelore për ekonominë private të Kosovës. I tërë sistemi i regjistrimit të bizneseve dhe numrit zyrtar të bizneseve private që u zbatuan për regjistrimin e përkohshëm të bizneseve është mjaft i pabesueshëm. Sipas zyrtarëve të administratës tatimore rreth 10,000 nga 51,000 biznese private të regjistruara janë zhdukur përsëri ose kurrë nuk e kanë filluar aktivitetin e tyre afarist.[122] Parashikimet rreth nivelit të papunësisë në Kosovë janë nga 30 deri në 60 për qind. Numri i njerëzve të punësuar rregullisht nga sektori privat është gjithashtu i panjohur.

Pasi që pritet një rënie drastike në ndihmën dhe donacionet ndërkombëtare në vitin 2003, dhe pasi që organizatat ndërkombëtare vazhdojnë që të ulin numrin e stafit dhe buxhetet e tyre, presioni mbi sektorin privat për zbutjen e papunësisë vazhdon të rritet. Pasi që pritet një rënie në punësimin zyrtar në ndërmarrjet shoqërore të Kosovës si rezultat i politikës së privatizimit dhe likuidimit të AKM-së-mbetet vetëm te sektori privat që të krijojë vende të reja të punës dhe të mbledh të ardhura të reja tatimore për buxhetin e Kosovës.

Nëse nuk do të ketë kurrëfarë politike në të ardhmën për zbutjen e nivelit të lartë të

papunësisë në Kosovë dhe përmirësimin e gjendjes së dobët të infrastrukturës, misioni i parë i Bashkimit Europian në Kosovë do të dështoj. Pasi që Kosova do të largohet edhe më tej nga Europa, premtimi për integrim Europian gradualisht do ta humb peshën e vet dhe karrota që tani nxit reformat do të vyshket. Suksesi i Shtyllës së BE varet nga sektori privat i Kosovës; me fjalë tjera, suksesi i misionit do të varet nga aftësia e UNMIK-ut për krijimin e të drejtavë të qarta pronësore.

Prona është kryesore

Hulumtimet në terren në Kosovë tregojnë qartë se sektori privat ka mungesë të qasjes në tokën e punueshme, tituj të qartë pronësor dhe përmirësime kryesore në infrastrukturë. Në Kosovë dhe në krejt rajonin, bizneset e reja janë detyruar që të mbështeten në qendrat e zhvillimit socialist me qëllim të përfitimit të qasjes në infrastrukturë, derisa shumica e komunës mbetet e mbyllur për zhvillim. Ekziston një mungesë e dukshme e objekteve të përshtatshme të disponueshme për bizneset private, dhe shitoreve të vogla dhe bizneseve tjera nuk iu del vendi.[123]

Në ish-Jugosllavi, planifikimi qendror i zhvillimit të infrastrukturës është kryer plotsisht në të mirë të sektorit të NSH-ve. Nuk ka ekzistuar tradita e investimit në infrastrukturë për zhvillimin e zonave rurale, dhe sigurisht jo për zhvillimin e sektorit privat. Gjendja e dobët e infrastrukturës është një pengesë e madhe në zhvillimin e sektorit privat në krejt rajonin.[124]

Si pasojë, mund të jemi dështmitarë të urbanizimit të egër përgjatë rrugëve kryesore të Kosovës që shkakton përdorimin joekonomik të hapësirës, dëmtime të mëdha për infrastrukturën dhe shaktërrimin e anës ekologjike dhe bujqësore të zonave rurale. Çdo ditë e më shumë toka bujqësore po shndërrohet në kantier ndërtimi apo në ndonjë zonë tjetër të egër industriale. Ministria e Bujqësisë së Kosovës pohon se në mes të 15.000-20.000 hektarë të tokës bujqësore janë zhdukur që nga 1989.[125]

Qartësia e titujve pronësor do t'i ulte me të madhe kostot e transkasioneve në tregun e tokës dhe kapitalit të lirë privat. Kundërthënia kryesore rreth të ardhmës së pronës shoqërore dhe publike rezulton në çmime të patundshmërive që tejkalojnë me të madhe buxhetet e afaristëve kosovar dhe bllokon kapitalin e vlefshëm investues që përndryshe do të mund të përdorej për aktivitete produktive.

Shumica e ligjeve të vjetra socialiste që rregullonin marrëdhëniet pronësore janë ende të zbatueshme në Kosovë. Gjysma e masës së përgjithshme tokësore të Kosovës, ose 466.000 hektarë tokë janë në pronësi publike. Kjo përfshin tokat nën shtëpitë private në çdo qytet, parcelat e mëdha të tokës në zonat e ndryshme industriale si dhe rrugët dhe lumenjtë. Çdo tokë që përfshihet me planin urbanistik brenda kufijve të një qyteti sipas definicionit është në pronësi publike. Nuk ekziston pronë private në tokat në pronësi publike; pronarët e shtëpive private e mbajnë vetëm të drejtën e përdorimit-të drejtën e përdorimit përderisa shtëpia mbahet e padëmtuar. Deri më tani, e tërë toka në pronësi publike është ende nën ndikimin e Ligjit për Shpronësim, dhe një autoritet

kompetent mundet në çdo kohë ta shpronësojë pronarin e tanishëm. Ligji parashikon vetëm kompenzim të kufizuar për "përdoruesin" privat.

Vetëm toka dhe prona jashtë planit urbanistik dhe kështu jashtë ndikimit të Ligjit mbi Tokën Ndërtimore ose të Ligjit për Shpronësim, ka një titull të qartë dhe të plotë të pronësisë.[126] Vetëm toka që nuk është nacionalizuar, konfiskuar ose dhënë kooperativave bujqësore mbetet në pronësi të plotë private, e punueshme dhe me mundësi shitjeje.

Prona është çelësi i zhvillimit ekonomik. Të drejtat e qarta pronësore janë bazë për stabilitetin shoqëror dhe politik duke bërë gjithkë stakeholder. Të drejtat e qarta pronësore janë të lidhura ngusht me sundimin e ligjit dhe paqartësitë rreth të drejtave pronësore janë të dëmshme për zhvillimin ekonomik.

Hernando De Soto më plot bindje pohon se nëse të drejtat pronësore nuk caktohen qartë, atëherë prona nuk është tjetër asgjë përveç një pasurie të vdekur. Në Kosovë, si edhe në vendet tjera në zhvillim,

> "burimet mbahen në forma të gabuara: shtëpitë e ndërtuara në toka të drejtat pronësore të të cilave nuk janë të regjistruara në mënyrë adekuate, biznese që nuk janë korporata me borxhe të padefinuara, industri të vendosura në vendet ku financuesit dhe investorët nuk mund t'i shohin. Për shkak se të drejtat mbi këto pronësi nuk janë të dokumentuara në mënyra adekuate, këto pasuri nuk mund të shëndrrohen menjëherë në kapital, nuk mund të tregtohen jashtë qarqeve të ngushta lokale ku njerëzit e njohin dhe i besojnë njër-tjetrit dhe nuk mund të ngarkohen për kredi ose si hise ndaj ndonjë investimi".[127]

Fondi kosovar i shtëpive ka një vlerë të llogaritur prej dy miliardë Euro, por shumica e pronës në Kosovë është një pasuri e vdekur: nuk mund të përdoret për ngritje të kapitalit dhe nuk mund të shërbejë si hipotekë.[128] Hapësira të mëdha të patundshmërive primare komerciale janë të bllokuara në ndërmarrjet jofunksionale shoqërore; hapësira të mëdha të tokës në pronësi publike në qytetet e Kosovës nuk mund të tregtohet ose ngarkohen mënyrë të lirë. Një ligj i ri mbi hipotekat mbetet vetëm në formën e draftit. Sektorit privat i mungon hapësira dhe kapitali investues. Përfaqësuesi i Posaqëm i Sekretarit të Përgjithshëm Michael Steiner madje e përmendi këtë çështje në fjalimin inagurues të dhënë më 19 shkurt 2002: "Reforma pronësore dhe privatizimi do të merren parasysh. Çdo shtëpi, çdo shitore dhe çdo inç i tokës duhet ta ketë një pronar të qartë. Pasuritë e vlefshme duhet të zhvillohen. Përndryshe, ato do të mbesin vetëm si kapital i vdekur".[129]

Krijimi i pronës është paqeruajtje

Është qëllim themelor i UNMIK-ut që të krijojë një ekonomi të qëndrueshme nën shtetin e së drejtës. Kjo nënkupton zëvendësimin e sistemit të vjetër me një regjim funksional të pronës. Dështimi në kryerjen e kësaj mban kosto të mëdha ekonomike dhe sho-

qërore.

Pa tituj të qartë pronësor nuk do të kemi investime në Kosovë. Pa tituj pronësor të tregtueshëm dhe të ngarkueshëm, sektorit privat do t'i mohohet kapitali i ri. Pa një qeveri që do të jetë në gjendje që t'i zbatojë të drejtat pronësore, pronarët e shitoreve dhe afaristët e vegjël në Kosovë do të duhet që të mbështeten në kompanitë private të sigurisë për mbrojtjen e interesave të veta. Mungesa e titujve të qartë dhe të zbatueshëm pronësor krijon treg për agjensitë private të mbrojtjes, që e zëvendësojnë shtetin e dobët. Kjo i dobëson përpjekjet ndërkombëtare për krijimin e shtetit të së drejtës dhe ndërtimin e një ambienti të sigurt.

Krijimi i pronës është një problem i shkëlqyeshëm politik. Zgjidhja e statusit të pronës shoqërore në Kosovë nuk është çështje vetëm për juristët dhe ekonomistët. Asnjë ndryshim i vërtet shoqëror nuk mund të bëhet pa identifikimin dhe bashkëpunimin me grupet e interesuara lokale që kanë një interes në reforma të tilla. Kush janë këto grupe të interesuara lokale në Kosovë?

Një studim rreth komunës Kalesija në Bosnë tregoi qartë se me dhënien e kushteve të drejta, sektori i ri privat mund të jetë shtytësi i vërtet për zhvillim. Në Kalesija, sektori privat u zgjerua nga 5 deri në 42 përqind të punësimit të përgjithshëm zyrtar brenda disa vitesh.[130] Sektori privat është përfituesi kryesor i çdo reforme pronësore dhe bizneset private do të përfitojnë më së shumti nga privatizimi dhe likuidimi i suksesshëm që do t'i çlirojnë të mirat e ndërmarrjeve shoqërore për investim privat.

Përveç sektorit privat, komunat gjithashtu do të mund të përfitonin drejtpërsëdrejti nga qartësia e pronës komunale, shoqërore dhe publike. Gjersa më herët komunat kishin mundësi të dhënies së tokës publike për ndërtim të zonave komerciale ose për vendbanime shoqërore, tani Agjensia e sapo themeluar Kosovare e Mirëbesimit[131] si kujdestare e të gjitha ndërmarrjeve shoqërore dhe publike dhe të mirave të tyrë, ushtron kontrollin në pjesë të mëdha të pronës komunale. Shumë nga patundshmëritë primare tani janë në duart e AKM-së dhe AKM-ja është e ngarkuar me përgjegjësi të madhe shoqërore dhe politike për të zhvilluar, shitur, shpërndarë dhe caktuar parecelet e tilla të tokës.

Tani, komunat trashëgojnë efektet e planifikimit të dobët socialist dhe pronësisë shoqërore, por nuk posedojnë me mjetet për zgjidhjen e problemeve që shkaktohen nga këto. Shumica e komunave akoma veprojnë në baza të planifikimit urban dhe zonal që kanë qenë të zhvilluara për nevojat e planifikimit socialist dhe që i kanë rrënjët qysh në vitet e tetëdhjeta. Planifikimi i qyteteve në Jugosllavinë Socialiste përqëndrohej në industritë e mëdha dhe jo në nevojat e sektorit privat.

Sektori privat i Kosovës ka nevojë urgjente për një regjim funksional të pronës me qëllim të zhvillimit dhe ofrimit të vendeve të reja të punës për gjeneratat e ardhshme. Çfarë nevojitet është një politikë që merret në të njëjtën kohë me dy çështje: të krijohet një titull i qartë dhe i sigurtë pronësor dhe të adresohet problemi i infrastrukturës së dobët kosovare.

Nga rindërtimi në zhvillim

Kosova ka qenë dëshmitare e një rrjedhe të rëndësishme dhe të paprecedencë të ndihmës ndërkombëtare për rindërtim. Më shumë se 500 kilometra rrugë janë rindërtuar, sistemet e ujit janë rehabilituar dhe më shumë se njëzetmijë shtëpi janë rindërtuar. Sidoqoftë, asnjë kilometër të ndonjë rruge të re nuk është shtruar dhe gjshtëdhjetë përqind e popullatës kosovare akoma jeton në fshatra pa rrugë të asfaltuara. Shumë nga këto rrugë të dheut bëhen të pakalueshme në ditët me shi. Në komunën e Klinës, vetëm 19% e banorëve janë të lidhur në sistemin lokal të ujit. Në komunën e Vitisë grumbullimi i plehrave kufizohet vetëm në qytetin e Vitisë; atje nuk ka sistem të hudhjes së mbeturinave në 42 fshatrat e kësaj komune

Në mungesë të shtetit shumica e infrastrukturës lokale në fshatrat e Kosovës është financuar privatisht. Fshatarët vetë organizojnë mbledhjen e fondeve brenda fshtatit dhe komunitetit të diasporës, bëjnë thirrje për oferta dhe kontribojnë me fuqi punëtore për shtrimin e rrugëve, instilimin e kanalizimit apo ndërtimin e ndonjë qendre rinore. Në Stubëll, komiteti i fshatit ka mbledhur fonde për 3 kilometra asfalt, për një qendër rinore dhe një ambulancë. Në Sllatinë të Epërme, 130.000 Euro janë mbledhur nga udhëheqësi religjioz i fshatit për ndërtimin e sistemit të kanalizimit.

Zonat rurale në Kosovë tradicionalisht kanë pasur mungesë të pëfitimeve të zhvillimit jugosllav. Planifikuesit socialist me qëllim i kanë injoruar nevojat e sektorit privat dhe i kanë harruar këto zona. Nxitjet ekonomike për ngritjen e më shumë se vetëm bujqësisë themelore janë aq të ulta sa që një pjesë e madhe e tokës bujqësore në Kosovë është lënë pas dore ose shitur shumë shtrejtë sektorit të ri privat. Sektori bujqësor nuk mund ta zbus papunësinë, dhe vetëm nëse nuk bëhet zhvillimi më i barabartë në mes të qyteteve, zonave industriale dhe zonave rurale, Kosova do të vazhdon që të përjetojë migrim të fuqisë punëtore në qytete dhe të eksportoj fuqinë e vet punëtore ne Europë.[132]

Menaxhimi i paditurisë

Çfarë i dallon strategjitë efektive të zhvillimit nga rindërtimi i thjeshtë është që ato përqëndrohen në zhvillimin e institucioneve dhe kapaciteteve lokale. Vetëm me kuptimin e anëve të forta dhe të dobta të strukturave ekzistuese është e mundur arritja e ndryshimit të qëndrueshëm institucional, që është parakusht për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.[133]

Identifikimi i mangësive informative duhet të jetë prioriteti numër një për çdo organizatë ndërkombëtare që ka për qëllim reformimin e një sistemi apo ekonomie të trashëguar. Një agjendë e duhur dhe reale e reformës duhet të bazohet në informata të sakta rreth realitetit në terren. Një strategji ekonomike duhet të shfrytëzojë status quo-në ne vendin, rajonin ose sektorin për të cilin interesohet. Organizatat ndërkombëtare në përgjithësi investojnë shumë në kapitalin e tyre njerëzor, në pajisjet e tyre të teknologjisë informative ose në marrëdhënie me opionion. Shumë pak kohë dhe resurse janë të

shfrytëzuara për mbledhjen e informatave themelore në terren, për analizimin e të dhënave, ndarjen e këtyre informatave me organizatat tjera, apo kërkimin e ekspertizës lokale dhe ruajtjen e vazhdueshmërisë institucionale.

Suksesi i misionit të parë të Bashkimit Europian do të varet në aftësinë e tij për të mësuar mbledhjen e informatave dhe menaxhimin e injorancës në mënyrë më të mirë. Nje debat i mirë-informuar mbi politikat do të mund të parandalonte politikat e drejtuara gabimisht për rivendosjen e vetë-udhëheqjes së punëtorëve në ndërmarrjet shoqërore. Burimet e donatorëve do të mund të shpërndaheshin në mënyrë më efektive për përmirësimin e infrastrukturës rurale dhe qasjes në tokën e punueshmë të bazuar në informatat e sakta rreth nevojave të sektorit privat. Reforma pronësore do të duhej që të futet në agjendë gjatë tri viteve të kaluara.

Sfida reale e institucioneve ndërkombëtare për të punuar në një ambient të panjohur dhe në ndryshim të vazhdueshëm siq është ai kosovar, është pranimi i mosdijes dhe menaxhimi i saj në mënyrën më efektive. Natyra e rastësishme e përpjekjes së misioneve ndërkombëtare për tu angazhuar në fikjen afat-shkurte të zjarrit, qartazi është kundër përpjekjeve që marrin shumë kohë për mbledhjen e informatave të nevojshme për një debat të informuar rreth politikave. Sidoqoftë, kostot afat-gjate të një politike që ka dështuar si rezultat i mosdijes i mbipeshojnë të mirat afat-shkurte të zgjidhjeve të shpejta.

Ardhmëria e Kosovës varet nga sektori i fuqishëm privat. Institucionet e përkohshme të qeverisë, sistemi i arsimit apo sistemi shëndetësor nuk mund të funksionojnë pa një sektor të fuqishëm privat. Vetëm sektori privat grumbullon të ardhurat tatimore të këtij vendi. Në vitin 2001, sektori privat vetë mblodhi rreth 24 milion Euro në tatime.

Në mënyrë që Shtylla e BE-së të kontribojë në zhvillimin dhe stabilizimin ekonomik të rajonit, siq parashihet në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, më shumë kohë dhe burime do të duhet të ndahen për sfidën e trefishtë të mbledhjes së informatave, këshillimit me palët kryesore me interes në proces dhe kuptimit të realitetit në terren.[134]

Mësimi kryesor i nxjerrë nga përpjekja afat-shkurte e Shtyllës së BE-së për të zhvilluar sektorin privat të Kosovës duhet të jetë që në misionet e ardhshme ekspertët ndërkombëtar duhet t'i fikin kompjuterët e tyre dhe të dalin në rrugë për ta zbuluar ekonominë e vërtet. Zhvillimi i sektorit privat nuk është asgjë më shumë se identifikim i pengesave të vërteta të zhvillimit të këtij sektori. Sektori privat i çdo vendi nuk është diç e fshehtë apo abstrakte, por janë vetë tregtarët, prodhuesit, konsumatorët, prodhuesit e energjisë elektrike, zyrtarët tatimor dhe planifikuesit e infrastrukturës ata që e bëjnë sektorin privat.

REHABILITIMI NË MITROVICË

Mitrovica, dhe ardhmëria e saj mbetet një ndër problemet më të vështira të Europës, duke iu shtuar kështu pengesave tjera me të cilat ballafaqohet Kosova në tërësi. Situata, prandaj, meriton një vëmendje të posaqme për shkak të seriozitetit të pengesave, posaqërisht ne fushat e veçanta të sigurisë dhe sundimit të ligjit, administrimit dhe qeverisjes, si dhe marrëdhënieve ndëretnike. Kjo pjesë i adresohet problemit se si qasjet e zbatuara në pjesët tjera të Kosovës nuk janë zbatuar edhe në Mitrovicë dhe analizon efektet e kësaj neglizhence në stabilitetin e rajonit. Kërkimi i stabilitetit të tillë kërkon zbatimin e qëndrimeve të qëndrueshme në problemet mirë të rrënjosura; këto zgjidhje duhet të kërkohen nëpërmes hulumtimit dhe pastaj të implementohen nga të gjitha palët me interes në këtë process, duke përfshirë UNMIK-un, KFOR-in, Qeverinë e Kosovës, administratën lokale dhe Beogradin.

Mitrovica gjendet në veri të Kosovës, me një popullatë të para-luftës të vlerësuar në 300.000 nga të cilët 43.000 ishin serb.[135] Lumi Ibër kalon nëpër rrafshin e Kosovës dhe nën pesë urat e Mitrovicës që në kohërat më të mira kanë qenë të përdorura nga kosovarët për kalimin e lumit. Funksioni tradicional i urave është ndryshuar rrënjësisht pas luftës, duke shërbyer si pikë qendrore i një rrethine të çuditshme të përbërë nga paqeruajtësit ndërkombëtar duke mbajtur roje në post-blloqet me tanke dhe me tela gjembor që janë vendosur për parandalimin e përdorimit të urës si përpara. Gjatë konfliktit, banesat e shumicës shqiptare kanë pësuar dëmtime të mëdha, me diku rreth 65% të shtëpive të djegura dhe shkatërruara, përderisa vendbanimet me popullatë kryesisht serbe kanë mbetur gati të paprekura.[136] Cinizmi drejt arritjes së një zgjidhjeje politike që do të ishte e kënaqshme për të dy komunitetet, në një zonë ku mbizotëron ky përshkrim: "I huaji është shndëruar në urrejtje dhe hakmarrje dhe ku një lum do të ndajë ngushtë dhe gjerë".[137]

Madje edhe me praninë e trupave të huaja, akoma kanë ekzistuar rregullat strikte që kufizojnë lëvizjen në mes të dy zonave.[138] Qyteti rrjedhimisht ka qenë bazë e tri strukturave administrative - atë të shqiptarëve të Kosovës, të serbëve të Kosovës dhe administratën civile të KB-së. Pjesa veriore e qytetit tani ka diku rreth 12.000 serb, 3.000 shqiptarë, 600 turq, 500 romë si dhe diku rreth 5.000 persona të zhvendosur (IDP) nga veriu.[139] Në anën tjetër, jugu përmban afër 50.000 shqiptarë, dhe 300 familje serbe që kanë qenë duke banuar aty qysh para luftës.[140]

Para disa javësh, PPSP i KB, Michael Steiner, ka deklaruar pushtetin e UNMIK-ut në veriun e Mitrovicës, duke raportuar për mbylljen zyrtare të të gjitha institucioneve paralele serbe të financuara nga Beogradi që u formuan pas luftës. Më 2 tetor 2002, Steiner e bëri të ditur planin e tij shtatë pikësh për Mitrovicën, duke theksuar se populli i Kosovës duhet të vendosin në mes të "stagnimit apo ndryshimit." Ai pohoi se lejimi i gjërave ashtu si janë do të kontribojë në "paligjshmëri, pasiguri, frikë dhe margjinalizim politik."[141]

Shqiptarët dhe serbët menjëherë iu përgjigjën planit, më së shumti me skepticizëm;

serbët e Mitrovicës ishin kundër "mënyrës" në të cilën plani ishte formuluar, derisa banorët shqiptarë ishin pesimist, jo për shkak të përmbajtjes të planit, por për shkak të "dështimit të planeve të mëhershme" të dhëna nga UNMIK-u.[142] Me fjalë tjera, plani i Steinerit nxiti brengosjen e komunitetit shqiptarë, kryesisht për shkak se bashkësia ndërkombëtare "nuk ka qenë efektive deri më tani, në futjen e administratës së saj në veri."[143] Në anën tjetër, serbët e shikojnë planin më shumë si një ultimatum pasi që përfaqësuesit e serbëve deklarojnë se nuk kanë qenë të kontaktuar dhe nuk janë marr këshillat e tyre lidhur me detajet e këtij plani para deklarimit të tij.[144]

Megjithë faktin se përfundimisht KB ka ushtruar mandatin e vet mbi këtë qytet, banorët kosovar dyshojnë në përcaktimin dhe vullnetin e bashkësisë ndërkombëtare për të levizur në drejtim të arritjes së qëllimeve të shprehura. Kjo kërkon një qasje të vendosur nga ana e UNMIK-ut, në shndërimin e ideve formale në veprime kuptimplote; ky do të jetë një proces gradual por në dukje duhet të jetë i suksesshëm. Ky process filloi më 25 nëntor 2002, pasi që UNMIK-u e deklaroi autoritetin e vet me qëllim të sjelljes së "normalitetit në qytet."[145]

Siguria

Një nga fushat që ka nevojë për përmirësim është siguria. Pushtetit duhet të rivendoset në veriun e Mitrovicës me qëllim të krijimit të ambientit të sigurt që do të nxisë kthimin e refugjatëve dhe lirinë e lëvizjes. Arsyet për situatën e tanishme rrjedhin nga përpjekjet e organizuara për mbajtjen e ndarjes etnike pas luftës nga ana e forcave lojale ndaj liderit të atëhershëm serb, Milosevic. Agjentët serb krijuan post-blloqe ilegale, duke kufizuar kështu levzijen në mes të dy anëve. Ky grup i serbëve të Kosovës – "Grupi nga Ura" - ishte "I aftë që të mobilizojë me qindra njerëz brenda pak minutave për të parandaluar çdo përpjekje të shqiptarëve që të lëvizin në pjesën veriore të qytetit."[146]

Preokupimi kryesor i grupit vazhdon të mbetet kundërshtimi i tij për kthimin e shqiptarëve në veri; grupi ka pohuar se kthimi do të rezultonte në dëbimin e serbëve nga veriu dhe eventualisht nga i tërë rajoni.[147] ICG mban qëndrimin se "nëse ekstremistët serb mund të demonstrojnë se KFOR-i dhe UNMIK-u janë të paaftë në krijimin e një ambienti të sigurt për jo-shqiptarët dhe krijimin e institucioneve funksionale në zonat e përfshira me urrejtje atëherë Beogradi mund ta mbrojë rastin e vet më me forcë."[148]

Grupi ka qenë i përfshirë në disa akte kriminale në zonat veriore të qytetit, duke përfshirë kërcënimin e serbëve lokal që kanë bashkëpunuar me UNMIK-un.[149] Një fakt që e ka rritur akoma më shumë problemin janë përpjekjet e pakta të KFOR-it dhe UNMIK-ut në "shkatërrimin" e grupit.[150] Kjo dilemë kërkon arrestimin e kriminelëve radikal që kërkojnë ndarjen e Mitrovicës dhe që mund të pengojnë funksionimin e institucioneve shumë-etnike. Masa të tilla janë të nevojshme me qëllim të krijimit të ndjenjës së sigurisë te njerëzit që shprehin dëshirën e kthimit në shtëpitë e veta. Një dilemë e ngjashme ekzistonte në Timorin Lindor, ku rebelët e zemëruar nuk ishin të gatshëm ta

pranojnë humbjen, duke shkaktuar shpërndarjen e trupave në rajonin kufitar me qëllim të bllokimit të përpjekjeve të tyre për të sabotuar përpjekjet e Kombeve të Bashkuara atje. Jonathon Steel i vlerësonte përpjekjet e luftimit të tentativave të Indonezisë për t'i përçarë përpjekjet e KB-së si "vitale në kapjen e ish anëtarëve të grupeve rebele që bënë përpjekje për tu kthyer në fshatrat e tyre si refugjatë."[151]

Steiner ka mbajtur qëndrimin se UNMIK-u dhe KFOR-i kanë marrë një qasje më të fortë dhe aktive kundër të ashtuquajturve "Rojet e Urës" që ka ndihmuar në uljen e nivelit të dhunës në Veri.[152] Sidoqoftë, siq ceket edhe në pjesën e sigurisë së këtij punimi, UNMIK-u pohon se vetëm KFOR-i mund të veprojë dhe të kryejë operacione ushtarake me forcë. Në të njëjtën kohë, Policia e UNMIK-ut nuk ka kurrfarë autorizimesh për të vepruar në veri për shkak të mospjatimit të popullatës serbe, që është një sfidë tjetër në ndërtimin e një force policore shumë-etnike.[153]

Një incident që ndodhi më 8 prill 2002 rivendosi pengesat që mbeten në fushën e sigurisë, pa marrë parasysh faktin se dhuna është pakësuar që nga 1999.[154] Dhuna filloi pas përpjekjeve të UNMIK-ut për të arrestuar një "roje të urës" të mirënjohur për shkak të shkaktimit të trazirave në shkurt 2002; ky individ gjithashtu ka qenë i akuzuar edhe për krime tjera që kanë ndodhur para këtij incidenti.[155] Rrjedhimisht, ai kundërshtoi arrestimin, gjë që provokoi trazira dhe nxiti turmën që të gjuaj granata kundër policisë, duke lënduar gjithsej 26 policë të UNMIK-ut dhe disa civil serb. UNMIK, KFOR dhe serbët reaguan ndaj incidentit në mënyra të ndryshme; sidoqoftë, pak është bërë për ta adresuar seriozitetin e këtij incidenti.[156]

Reagimi i PPSP-së Michael Steiner ishte një dënim i vetëm pa deklaratë zyrtare; Komanda e KFOR-it pohoi se ata "nuk kanë qenë të informuar për aksionin", që do të thotë se nuk ka pasë intervenim të KFOR-it, megjithë se ata "I kanë mbrojtur post-bllokqet ekzistuese dhe kanë bërë thirrje për përforcime."[157] Policia e UNMIK-ut, në anën tjetër, e cilësoi incidentin si "rutinë" dhe shpjegoi përpjekjet e tyre për zbatimin e ligjit si të vazhdueshme. Megjithë këto deklarime, "administrata e UNMIK-ut dhe zyrtarët e KFOR-it jozyrtarisht pohonin se sulmi është bërë për shkak të udhëheqjes së dobët të aksionit nga ana e policisë dhe mungesës së koordinimit në mes të policisë dhe KFOR-it."[158]

Rrënjët e dështimit mund të gjinden qysh në fillimin e misionit të NATO-s me masat jo të duhura të marra nga KFOR-i për ofrimin e sigurisë në qytet; duke dështuar të insistojnë për një qytet jo të ndarë. Një strategji e ngjashme është aprovuar në Bosne në "besimin se kjo është mënyra më e mirë e ruajtjes së sigurisë."[159] Mbase në planin afatshkurtë, por rikthimi i strategjisë doli se ishte më i vështirë.

Këto çështje të sigurisë lidhen drejtpërsëdrejti me brengat e banorëve që dëshirojnë të kthehen në shtëpitë e tyre, të kenë qasje në punë dhe në shërbime më të mira. Nëse UNMIK-u vazhdon me adminstrimin e vet pa i adresuar këto çështje, bashkëpunimi ndër-etnik nuk do të jetë i mundshëm, posaqërisht nëse nuk zbatohen masa më të vendosura të sigurisë me qëllim të parandalimit të konfliktit në mes të grupeve të ndrysh-

me. Siq theksoi edhe administratori i KB për Mitrovicën, John Rodgers gjërat si liria e lëvizjes nuk do të vijnë brenda natës por gjëja më e rëndësishme është bashkimi i strukturave themelore. Kjo përfshin sigurinë adekuate që duhet të garantohet nga UNMIK-u dhe SHPK-ja me ndihmën e KFOR-it kur është e nevojshme. Pa siguri dhe sundim të ligjit, gëzimi i lirisë së lëvizjes dhe qasjes në institucione nuk do të jetë i mundshëm, madje edhe në planin afat-gjatë.

Dy pikat e para të planit të Steinerit për Mitrovicën lidhen në mënyrë direkte me këto çështje të sigurisë; pika e parë thekson se Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i duhet të ndihmojnë në ruajtjen e kujdesshme të urës, derisa pika e dytë thekson se serbët do të integrohen ne SHPK si policë të rregullt.[160] Pika e parë ka qenë e pranishme edhe deri më tani, por kriminelët ende qëndrojnë në urë dhe vazhdojnë të ndërhyjnë në ligjin dhe rendin me masa ta pakta të ndërmarra për arrestimin e tyre; prandaj, një veprim më agresiv është i nevojshëm në këtë drejtim. Ngjashëm, në mënyrë që një forcë shumëetnike të funksionojë në harmoni, forca duhet të pranojë plotësisht që është integruar në Shërbimin Policor të Kosovës, duke i ndërprerë lidhjet me Beogradin dhe duke punuar bashkë me grupet e tjera etnike. Ata gjithashtu duhet të punojnë në arrestimin e kriminelëve të njohur në veri siq bëjnë për çdo kriminel tjetër në Kosovë.

Në Timorin Lindor, misioni paqeruajtës i KB ka qenë i suksesshëm në qëllimet e veta primare, që përfshinin mbrojtjen e banorëve të Timorit Lindor nga hakmarrjet nga rebelët dhe "krijimin e një ambienti të sigurtë për kthimin e shumicës së refugjatëve, një të tretën e popullsisë."[161] Kjo ndodhi për shkak se paqeruajtësit vazhduan t'i mbrojnë kufijtë e Timorit Lindor nga elementet infiltrues problematik. Një qasje e tillë është esenciale për Kosovën gjatë disa viteve të ardhshme. Në këtë drejtim, është me rëndësi që misionet e paqeruajtjes të jenë të financuara bollshëm që nga fillimi. Sië shihet në rastin e Srebrenicës, mungesa e trupave të mjaftueshëm për të siguruar "një ambient të sigurt" e intensifikoi problemin. Nëse siguria nuk zbatohet në mënyrë adekuate dhe të duhur, qëllimi i kthimit të refugjatëve nuk do të jetë i mundur.

Në të njëjtën kohë, institucionet gjyqësore dhe tribunalet janë të domosdoshme për suksesin e Kosovës demokratike në të ardhmën. UNMIK-u duhet të demonstrojë vendosjen e vet në ushtrimin e pushtetit të vet në veriun e Mitrovicës me qëllim të nxitjes së përmirësimit të shtetit të së drejtës dhe sistemeve funksionale gjyqësore. Sekretari i Përgjithshëm Annan deklaroi se "mbështetja e vazhduar për luftën e misioneve kundër krimit përmes hetimeve gjyqësore që çojnë në arrestim dhe ndërtimi i potencialit të policisë dhe gjyqësisë lokale, do ta çoj Kosovën drejt normalizimit."[162] Këto gjeste duhet të përcillen me veprime.

Qëndrueshmëria është posaqërisht vitale në fushën e sigurisë në Mitrovicë. Rëndësia e qëndrueshmërisë gjithashtu ilustrohet në rastin e Kamboxhas ku Kombet e Bashkuara u përpoqën që të krijojnë një shtet të fortë dhe të mbrojnë të drejtat e njeriut në vend.[163] Demokracia ishte në bazë të këtyre përpjekjeve. Ky proces dështoi për shkak se përpjekjet nuk u mbajtën për gjatë. Derisa intervenimi konstruktiv duhej të ishte pjesë e paqeruajtjes, në vështrim të njerëzve dhe elitave lokale, intervenimi i tillë nuk ishte

"lëvizje në drejtim të duhur", kryesisht për shkak se disa sektorë ndiheshin të kërcënuar nga ky proces.

Mitrovica mbetet sfidë në implementimin e mandateve të Këshillit ët Sigurimit për Kosovën, me misionin që është në kërkim të stabilizimit të situatës në terren përmes dialogut me Republikën Federale të Jugosllavisë. Marrëdhëniet e shqiptarëve me paqeruajtësit francez mbeten mëdyshëse ku shumë shqiptarë mbajnë qëndrimin se këto trupa nuk janë objektive në kryerjen e misionit të tyre dhe bëjnë pak në ballafaqimin me aktivitetet e ndryshme kriminele nga grupet agresive dhe të dhunshme.[164] Në të njejtën kohë, serbët nuk do ta lejojnë askë që ta kalojë urën pa u marrë në pyetje, "duke vendosur se kush mund të hyjë dhe duke i kërcënuar të tjerët." Rezultatit i aksionit të parakohshëm të UNMIK-ut mbetet të shihet, por çfarë është e qartë është se do të mbetet i vogël nëse nuk ndërmerret një zbatim i njëmendët i mandatit të vet në veri të qytetit.

Administrimi

Administratori i KB për Mitrovicën, John Rodgers, shpjegoi se në kuptim të administrimit, faktori më i rëndësishëm sigurimi i shërbimeve të duhura për të gjithë personat në komunë. Sidoqoftë, ai pohon se çfarë mbetet që të menaxhohet është e "drejta për t'i pranuar këto shërbime".[165] Rodgers është optimist për planin e Steinerit për sjelljen e rendit në Mitrovicë, megjithëse ai thekson se një proces i tillë kërkon kohë dhe bashkëpunim të vazhdueshëm; ai nuk është i vetmuar në këtë optimizëm. Në mesin e çështjeve tjera është edhe ajo e punësimit në insitucionet e UNMIK-ut me shtatëdhjetë vende të lira të punës të shpallura para do kohe.

Administrata e UNMIK-ut ka shpjeguar se procedurat për punësimin e stafit të ri janë të bazuara në aftësitë e kandidatëve potencial; ata duhet të jenë "njerëz të aftë dhe kompetent, duke siguruar se punët do të kryhen dhe atë në mënyrë të duhur."[166] Ai theksoi rëndësinë e punësimit të njerëzve që mund të kompletojnë punët në mëyrë efektive, dhe në një mënyrë profesionale. Sidoqoftë një brengë është e lidhur me mundësinë e krijimit të një stafi shumë-etnik.

Nëse kjo çështje nuk adresohet, atëherë ambienti punues mund të përbëhet vetëm në punën e UNMIK-ut me serbët në veri, duke nxitur kështu zhvillimin e komunave të ndara, dhe të nis një përbërje të tillë që do të nxiste një precedentë të rrezikshëm të ndarjes së qytetit. UNMIK-u ishte i paaftë që të vendosë pushtetin në veri, që do të thotë se ishin të paaftë në mbajtjen e spitalit shumë-etnik, strukturës së gjykatës dhe shërbimeve tjera publike; institucionet si arsimi dhe shëndetësia i raportojnë ministrive përkatëse në Beograd.[167] Kjo ka shkaktuar irritim te shqiptarët të cilëve iu është mohuar qasja në këto institucione; kështu, mungesa e punësimit në jug edhe më shumë e përkeqësoi ndjenjën e armiqësimit te shqiptarët.

Shqetësimet kryesore të shqiptarëve në jug ishin kthimi në pronat e veta, dhe shfrytëzimi i shërbimeve, si shëndetësia dhe arsimi; por më me rëndësi ata janë duke kërkuar

përmirësimin e mirëqenies ekonomike. Shumica e shohin planin e UNMIK-ut si një plan që dështon adresimin e çështjes së punësimit, duke shkuar prapa sa i përket përmirësimit të gjendjes ekonomike të shumë shqiptarëve të papunësuar që tani banojnë në jug.[168] Derisa ndërtimi i institucioneve të përbashkëta është i rëndësishëm, bashkësia ndërkombëtare nuke duhet të neglizhojë çështjen e zhvillimit ekonomik. Në Timorin Lindor, shumë prej problemeve u shkaktuan nga mungesat në menaxhmentit e brendshëm në UNTAET, trajnimin e pamjaftueshëm të timorezëve dhe tendencën e përqëndrimit shumë më të madh ndërtimin e institucioneve se sa në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik. Këto veprime dhe sjelljet e pandjeshme të shumë anëtarëve të stafit shkaktuan ankesa të arsyeshme të vendorëve.

Pikat pesë dhe gjashtë të planit të Steinerit për Mitrovicën përfshijnë përmirësimin e gjendjes ekonomike në Mitrovicë, si dhe mundësimin e investimeve. Në të njejtën kohë, Steiner konsideron se pa institucione legjitime, implementimi i investimeve të tilla do të jetë i pamundur; sidoqoftë, bashkësia ndërkombëtare duhet që më fuqishëm të promovojë një çështje të tillë pasi që ky investim do të mund të kontribuonte drejtpërsëdrejti në krijimin e institucioneve stabile dhe në qëndrueshmërinë e tyre, si dhe në gjendjen ekonomike të njerëzve. UNMIK-u duhet të merr parasysh të gjitha aspektet e problemit nëse kërkohet një ndryshim i qëndrueshëm; është e qartë se nëse mbështetja ekonomike nuk mbahet në këtë fushë atëherë situata nuk do të përparojë. Ky konsiderim është posaqërisht i nevojshëm, pasi që serbët nuk e kanë potencialin ekonomik të mbështetjes së kthimit të refugjatëve serb derisa "bashkësia ndërkombëtare që nuk e ka vullnetin politik dhe burimet, dhe duke u ballafaquar me një pakësim të fondeve, sipas të gjitha gjasave nuk do të jetë e aftë që të investojë në mënyrë të qëndrueshme në qoftë kthimin e refugjatëve qoftë në rritjen ekonomike."[169]

Ramadan Kelmendi, përfaqësues i LDK-së në Mitrovicë thotë se UNMIK-u ka iluzione lidhur me problemet e përfshira, duke shpjeguar se veprimet e UNMIK-ut si hapa që do të duhej që të ndërmerreshin para tri viteve. Ai thotë se janë 23.000 apartamente dhe shtëpi që duhet të kthehen duke përfshirë renovimin e tyre, qasjen në shëndetësi dhe fakultete, punësimin, pushtetin dhe kompetencat.[170] Kryeministri, Bajram Rexhepi shpjegon se gjërat do të ndodhin gradualisht duke lëvizur nga niveli zero i aktivitetit, por që të gjtha palët me interes në proces duhet të jenë realiste, posaqërisht në shpërbërjen e institucioneve paralele. Në të njëjtën kohë, kthimi i refugjatëve do të jetë një process i ngadalshëm që duhet të përcillet jo vetëm me veprimet e bashkëisë ndërkombëtare dhe të qeverisë por edhe të qytetarëve që duhet të jenë të gatshëm për ta bërë pjesën e tyre të punës.[171]

Institucionet duhet të jenë të përziera në përbërjen e tyre etnike dhe profesionale, ku mospërkatësia në ndonjë parti politike duhet të jetë bazë e punësimit dhe zgjedhjes në kuadër të këtyre institucioneve. Pika e tretë e planit të Steinerit përqëndrohet në vendimet që duhet të merren bashkarisht në nivelin komunal nën mbikqyrjen e UNMIK-ut, që do të kujdeset për mënjanimin e mbivotimit të marrëveshjes të koalicionit në mes të partive politike serbe dhe shqiptare në Kuvendin Komunal. Marrëveshja do të parasheh

që pamarrëparasysh madhësinë e tyre komunitetet kanë ndikim në nivelin komunal. Sidoqoftë, Steiner përfundon se me qëllim të lëvizjes përpara, pjesëmarrja politike në komunë është e nevojshme, dhe që pa institucione legjitime nuk mund të ketë ardhmëri dhe investime.

Serbët lokal dhe Beogradi

Më 14 nëntor 1999 The New York Times raportoi se Slobodan Milosevic ishte duke ndihmuar në organizimin e sigurisë dhe jetës së përditshme në pjesën veriore të Mitrovicës dhe në vetë veriun e Kosovës.[172] Shumica e perëndimorëve mendonin se Beogradi po e përdorte veriun, të cilin e furnizon me para dhe mallra, për të destabilizuar Kosovën ose për të parandaluar "normalizimin" e situatës pas fushatës së përgjakshme kundër shqiptarëve. Duket se një strategji e tillë akoma qëndron, tri vite më vonë. Qëllimi i Milosevic-it ka qenë që të mundohet ta mbajë së paku një pjesë të Kosovës brenda Serbisë dhe nën ndikimin e Beogradit, që ndjen se qeveritë perëndimore e kanë përçmuar sovranitetin e Serbisë mbi rajonin me frikën se Kosova eventualisht mund të kërkojë pavarësinë e vërtetë.

Shumica e fajësisë për vështirësitë në Mitrovicë i ngarkohen elementeve ekstremiste në mesin e serbëve si në Beograd ashtu edhe në Mitrovicë që "nuk kanë pasë vullnetin e nënshtrimit pushtetit të UNMIK-ut, ose të pranimit të integrimit të pjesës veriore të qytetit në shoqërinë dhe institucionet kosovare".[173] Në të njëjtën kohë, Beogradi shikohet si "një faktor vendimtar në përcaktimin e sjelljes politike të serbëve të mbetur të Kosovës".[174]

ICG shpjegon arsyet për këtë si "pjesërisht politike, pjesërisht etnike dhe pjesërisht kriminele" dhe thekson se UNMIK-u dhe KFOR-i duhet t'i kuptojnë këto "motivime të ndërlidhura" në mënyrë që të merren me sukses me Mitrovicën. Në të njëjtën kohë, Beogradi i shfrytëzonte burimet e pakta për të mbështetur institucionet paralele me mungesë të transparencës në kuptim të buxhetit që kanë qenë i drejtuar për shpërndarjen e këtyre fondeve. Beogradi ka financuar Kosovën me së paku 50 milion gjatë muajve të parë të vitit 2001 dhe më shumë se 29.800 njerëz në Kosovë ishin të paguar me paga nga Serbia në vitin 2001.

Përderisa vendosmëria e UNMIK-ut në këtë zonë ishte e dobët, ata e hapën një zyrë të komunitetit në Mitrovicën veriore në fillim të vitit 2002. Sidoqoftë, edhe pse një zyrë e tillë ekziston, "Beogradi përdorë çdo mjet të disponueshëm pët ta mbajtur kontrollin e vet mbi Veriun e Kosovës me qëllimin e ndarjes së provincës," si kundërshtim ndaj strategjive për bashkimin e Mitrovicës.[175] Serbët lokal pohojnë se bashkësia ndërkombëtare nuk ka ofruar mbrojtje të mjaftueshme kundër sulmeve të dhunshme, duke shkaktuar kështu mosbesim; prandaj, ata iu drejtuan Beogradit për pushtet civil. Në të kaluarën, Serbia i ka paguar pagat e zyrtarëve civil në Mitrovicën veriore edhe pse në vendet tjera UNMIK-u e kishte këtë detyrë. Nebojsa Covic, zëvendës-kryeministri serb dhe Ministri përgjegjës për Kosovë, "përshëndet" planin e Steinerit, por gjithashtu e sfi-

don atë, pasi që përfaqësuesit serb nuk kanë qenë të përfshirë në formulimin e tij.

Qeveria e Kosovës shpreh qëllimin e Beogradit për të sabotuar edhe njëherë bashkësinë ndërkombëtare dhe përpjekjet e PPSP-së për normilizimin e situatës dhe bashkimin e Mitrovicës.[176] Megjithëse është akoma shumë heret që të analizohet progresi i bërë që nga dekalrimi i pushtetit të UNMIK-ut në veri të Mitrovicës, disa kanë pohuar se dokumentacioni i 120 punëtorëve të institucioneve paralele janë larguar në ndërtesat e banimit afër spitalit, me dijen e UNMIK-ut për ekzistencën e këtyre strukturave ilegale. UNMIK-u i mohoi këto akuza, duke thënë se institucionet paralele nuk ekzistojnë më dhe se dokumentacioni do të mbetet për shkak të interesit të serbëve në këtë kuptim.[177]

Sidoqoftë, ata deklaruan se do të merren me lokacionin e dokumentacionit të tillë pas rindërtimit të ndërtesave; UNMIK-u nuk duhet ta vonojë ballafaqimin me këtë çështje. UNMIK-u duhet të konsiderojë mosbesimin që është shprehur ndaj tyre dhe mbështetjen që serbët kanë pranuar nga Beogradi, duke lënë përshtypjen se "serbët nuk kanë një nxitje ekuivalente për të bashkëpunuar në rregullimin e saj," madje edhe pasi UNMIK-u e ka bërë të qartë prioritetin e vet në zgjerimin e pushtetit të ligjit në krejt Kosovën.[178] Shqiptarët dhe serbët kanë besim të vogël në komunat e kontrolluara nga shqiptarët që i trajton ata në mënyrë të barabartë ose që ju ofron shërbime.

Serbët në Mitrovicën veriore janë larg të qenurit të kënaqur me humbjen e krejt Kosovës, duke thënë se nëse Kosova bëhet plotësisht e pavarur nga Jugosllavia, atëherë ata do të kërkojnë ndarjen nga Kosova. Në këtë kuptim, disa zyrtar perëndimor pranojnë rastin e ndarjes së Kosovës, duke ju dhënë serbëve veriun e rajonit dhe shqiptarëve pjesët e mbetura. Ky është një skenar i rrezikshëm, që nuk është demokratikisht i mundshëm; prandaj konstruktimi i ndarjes së tillë do të paraqiste një precedent të rrezikshëm.

Pengesa e parë për çdo plan të lehtë të ndarjes rreth Mitrovicës është e rrethuar më miniera që japin ari, zink dhe metale tjera të çmueshme. Këto miniera të pushtuara nga Hitleri në Luftën e Dytë Botërore dhe vitale për Jugosllavinë gjatë Luftës së Ftohtë, kanë marrë rëndësi mistike për vendasit.[179] Nga fillimi, Steiner-i theksoi se "bizneset dhe investimet nuk do të hyjnë në zonën gri të strukturave paralele."[180] Në përgjithësi, ekonomia e Kosovës si e tërë është akoma larg të qenurit e vetë-qëndrueshme me kornizë të privatizimit në krijim e sipër. Në të njëjtën kohë, privatizimi duhet të kryhet në një mënyrë transparente për t'i mundësuar bashkësisë ndërkombëtare përcjelljen e zhvillimit.

Shqiptarët e Kosovës

Sfidat ekonomike janë më të dukshme për vendimmarrësit jashtë Kosovës, derisa çështjet kulturore dhe politike janë më të qarta për vendimmarrësit brenda Kosovës me komunikimin rapid të pamjaftueshëm për zhvillimin e perspektivës së përbashkët nga distanca.[181] Për shqiptarët, "nevoja për ndërtimin e një forme të ekonomisë të vetë-qën-

drueshme dhe të zbutjes së papunësinë e bënë pronësinë dhe kontrollin e Trepçës një nevojë ekonomike."[182]

Kjo përfshijnë ekzistencën e investimeve të huaja. Në këtë drejtim, serbët janë përpjekur që "të ndajnë një pjesë të kapaciteteve procesuese nga prodhimi më pak profitabil i lëndës së parë dhe të përforcojnë lidhjet me pjesën tjetër të Serbisë, rihapjen e lidhjeve tregtare me beneficione të dyanshme dhe sigurimin e sigurisë ekonomike."[183] Fati i Trepçës së bashku me burimet e saja të ndara në mesin e zonave me shumicë shqiptare dhe shumicë serbe do të vazhdojnë të mbeten një çështje e rëndësishme për Kosovën.

Qeveria e Kosovës bën thirrje për liri të lëvizjes, shpërbërjen e "Rojeve të Urës", kthimin në institucionet si: shëndetësia, arsimi dhe kthimi i pronës. Pesimizëm i shtuar në mesin e shqiptarëve të Kosovës shkaktohet nga përhapja e thashethemeve lidhur me nënshkrimin e një marrëveshjeje në mes të Covicit dhe UNMIK-ut. Kjo ka shkaktuar përhapjen e frikës te shqiptarët se UNMIK-u është pajtuar me krijimin e një komune të re në Mitrovicën veriore. Kjo është diçka që do të ishte e papranueshme për shqiptarët; nëse kjo ndodh, situata mund të përkeqësohet edhe më shumë.

Mësimet e mësuara nga kjo analizë përfshijnë:

UNMIK nuk ka qenë efikas në ndikimin e Mitrovicës veriore me administratën e vet duke shpier kështu në progres të pakësuar në këtë rajon. Aksioni për eliminim e institucioneve paralele dhe formimi dhe administrimi i strukturave të ligjshme, në përgjithësi të pranuara përgjatë territorit të komunës, është deklaruar vetëm tani vonë.

Megjithëse dhuna është zvogëluar, mbesin pengesat në fushën e sigurisë dhe sundimit të ligjit, posaqërisht në arrestimin e kriminelëve përgjegjës për dhunë; mungesa e koordinimit në mes të UNMIK-ut dhe KFOR-it ka kontribuar në këtë problem.

Beogradi vazhdimisht ka mbështetur strukturat paralele në Mitrovicën veriore, duke përfshirë elementet radikale, që nuk kanë dashur t'i nënshtrohen pushtetit të UNMIK-ut dhe të pranimit të integrimit të Mitrovicës veriore.

Shteti i së drejtës nuk është zgjeruar në Mitrovicën veriore, me vazhdimin e mohimit të lirisë së lëvizjes, kthimit të refugjatëve dhe qasjes në institucionet e shëndetëisë dhe arsimit dhe punësimit.

UNMIK-u nuk ka qenë transparent ne veprimet që i ka ndërmarrë për vendosjen e pushtetit në Mitrovicën veriore.

Fushat e përshkruara duhet të mbahen nëse kërkohet ndryshimi i njëmendtë, duke përfshirë kthimin e refugjatëve, qasjen në institucione dhe investime. Bashkëpunimi në mes të të gjithë aktorëve duhet të përparojë në implementimin e një administrate efektive dhe shumë-etnike. Udhëheqësia efikase dhe demokratike është një faktor i rëndësishëm në përpjekjet për ndryshim.

Rekomandimet:

UNMIK-ut: Të mbajë qëndrim të fortë në vendosjen e pushtetit në Mitrovicën veriore duke i kthyer shprehjet formale në veprime kuptimplote. Kjo përfshijnë ushtrimin e qëndrueshmërisë në formimin dhe administrimin e strukturave që në përgjithësi pranohen në krejt territorin e komunës; konfirmimin e eliminimit të strukturave paralele; dhe të punojë për një ambient punues shumë-etnik duke i trajtuar të dy anët e Mitrovicës si një komunë.

Të praktikohet transparenca në informimin e opinonit mbi hapat që ndërmerren gjatë përpjekjeve për krijimin e qeverisjes efikase dhe demokratike në Mitrovicën veriore.
Policisë së UNMIK-ut: Të merr masa më agresive në arrestimin e kriminelëve, kur ekzistojnë dëshmitë e mjaftueshme, si dhe luftimin dhe shuarjen e strukturave paralele që vazhdojnë të ekzistojnë dhe të promovojnë sundimin e ligjit. Kjo nënkupton bashkëpunimin e vazhdueshëm me KFOR-in, të cilët duhet ta mbështesin procesin dhe të ofrojnë siguri dhe kontroll adekuat të kufijve.

Beogradit: t'i nënshtrohet pushtetit të UNMIK-ut dhe të ndalojë financimin e institucioneve paralele.

Shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës: të pranojnë integritetin e komunës së Mitrovicës kthimin e të gjithë refugjatëve.

Përfundimi

Derisa bashkësia ndërkombëtare ballafaqohet me një situatë tjetër potenciale katastrofike të pas-luftës në Irak, mësimet e mësuara nga ato që kanë ndodhur gjatë tri viteve të kaluara në Kosovë marrin një rëndësi të jashtëzakonshme. Sjellja alergjike e bashkësisë ndërkombëtare ndaj kritikave të aktiviteteve të saj në Kosovë pasqyron një ndjeshmëri të përgjithshme që nuk i shërben përmirësimit të kapaciteteve operacionale të shumë organizatave që do të detyrohen të përfshihen në Irak pas konfliktit. Siq shënohet më lartë në detaje, ekziston një numër i faktorëve që duhet të adresohen gjatë marrjes së përgjegjësisë së rindërtimit të një shoqërie, që është ballafaquar me dekada të margjinalizimit shoqëror dhe ekonomik si dhe represionit politik dhe kulturor.

Duke dështuar në adoptimin e një qasjeje më fleksibile dhe në të njëjtën kohë më të pajtueshme etnikisht për administrimin e Kosovës, dështimet e vërejtura i kanë intensifikuar faktorët që shkaktuan konfliktet e fundshekullit njëzet në Ballkan, në vend se t'i dobësojë ato. Dështimi i vlerësimit të dinamizmit fundamental të komuniteteve njerëzore i ka lënë banorët e Kosovës shpesh të hutuar rreth asaj se ku do t'i shpiej e ardhmja. Tragjikisht, ndjenja e çastit e sigurisë që mund ta kenë ndjerë në verën e vitit 1999 është humbur. Intensifikimi pasues i frikës kolektive dhe ndjenjës në rritje se ato që kanë ndodhur gjatë tri viteve të kaluara nuk sigurojnë mbështetjen e hapur të popullatës të Kosovës duhet të shërbejnë si vërejtje kur zbatuesit e projekteve në të ardhmën mund të futen në një ambient shumë më armiqësor. Iraku, ashtu si edhe Kosova, është një entitet i ndërlikuar dhe shumëetnik që nuk do të "reformohet" lehtë; ndjeshmëritë e parashikuara gjithnjë do të dalin më të komplikuara se që është menduar fillimisht.

Përvetësimi i roleve të ndërtimit të shtetit dhe shoqërisë nga ana e bashkësisë ndërkombëtare ka shprehur gabimet më fundamentale të botës së zhvilluar në lidhje me marrëdhëniet e saj me shoqëritë tjera. Ngjarjet e 11 Shtatorit 2001 duhet të shërbejnë si vërejtje që neglizhimi institucional dhe arroganca dhe qëndrimet kryelarta të botës post industriale nuk do të përkthehen në qeverisje efektive. Po që se udhëheqësit e ardhshëm në ringjalljen e Irakut ose në misionet e tjera në të ardhmen nuk përfshihen në hulumtime afatgjata dhe thelbësore të dinamikave dhe kolektivit si dhe nevojat individuale të popullatës në fjalë, mësimet e Kosovës nuk do jenë të mësuara dhe stabiliteti i rajoneve tjera të botës do të jetë përherë i kërcënuar siq është tani në Ballkan. Kontributi i lartëshënuar ka ndriquar provincializmin në administrimin e shoqërive të postkonfliktit që nëse lejohet të vazhdojnë, do t'i mundësojë forcave antidemokratike në botë që vazhdimisht të kërcënojnë interesat humanitare të njerëzve me nevojë më të madhe për to.

Shkurtesat dhe sqarimet gjuhësore

KKK Korniza Kushtetuese e Kosovës
CIIPVOL Policia e UNMIK-ut
COMKFOR Komandanti i KFOR-it
DTI Departmenti i Tregtisë dhe Industrisë
BE Bashkimi Europian
EUMIK Misioni i Bashkimit Europian në Kosovë
RFJ Republika Federative e Jugosllavisë
IRJM Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
ICG Grupi Ndërkombëtar i Krizave
JCR Komiteti i Përbashkët për Kthim
JIAS Strukturat e Përbashkëta të Përkohshme Administrative (struktura të përbashkëta UNMIK/kosovare që kryenin funksionin e përkohshëm ministror)
KFOR Forca e Kosovës (NATO)
UÇK Ushtria Çlirimtare e Kosovës
AKM Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit
OSBE Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Europian
ZPPSP Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjitshëm
DBP Drejtorati për Banim dhe Pronë
KABP Komisioni për ankesat banesore dhe pronësore
BN Bashkësia Ndërkombëtare
ZLK Zyrtar Lokal i Komunitetit
GLPK Grupet Lokale Punuese mbi Kthimin
SHPK Shërbimi Policor i Kosovës
SHSHPK Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës
LDK Lidhja Demokratike e Kosovës
MSA Pagesa e Misionit për Jetesë
IPVQ Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
"komunitetet RAE" përdoret për përshkrimin e komuniteteve Roma-Ashkali-Egjiptiane nën një titull pasi që i kanë problemet e përbashkëta.
GPR Grupi Punues Rajonal për Kthimin
SC/JCR Komiteti Drejtues i Komitetit të Përbashkët për Kthim
PPSP Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të KB
UNHCR Komisioni i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara
UNMIK Administrata e Përkohshme e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNSC Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

Shënimet:

[1] Më poshtë vetëm "rezoluta".
[2] Caplan, Robert, "A New Trusteeship? The International Administration of War-torn Territories." *Adelphi Paper* 341, shkurt 2002.
[3] Stedman, Stephen "Spoiler Problems in Peace Processes," Siguria Ndërkombëtare 22, nr. 2 (vjeshtë 1997) f: 5-53.
[4] Caplan f: 76.
[5] Caplan f: 51-52
[6] Caplan f: 51.
[7] Darby, John "The Effects of Violence on Peace Processes," Washington D.C.: Instituti për paqe i SHBA-ve 2001, f: 8.
[8] Caplan f: 57-58.
[9] Caplan f: 49.
[10] Caplan f: 66.
[11] Rezoluta e KS: S/RES/1244 (1999) e 10 qershorit 1999, në: M. Bothe/ Th. Dorschel: UN Peacekeeping – A Documentary Introduction, Hagë/ Londër/ Boston, f. 249.
[12] Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar në Kosovë (15 gusht 2002) The Kosovo Report, Oxford: 2000, f: 67.
[13] S/1999/649 e 7 qershorit 1999 [Titulluar "Chernomyrdin-Ahtisaari-Document"] qasur në: http://un.org/peace/kosovo/s1999649.pdf
[14] Kjo është një çështje diskutuese nëse UNMIK-u është bazuar direkt në Kapitullin VII të Kartës së OKB-së apo ka bazën e vet ligjore në marrëveshjen e qeverisë jugosllave. Shiko Perrit H.H. dhe J.M. Scheib (8 maj 2000). "Rebuilding Kosovo - UNMIK as a Trustee Occupant, Punim i shpërndarë në Konferencën e Evropës Juglindore" në *Matheson M.J.* "United Nations Governance of Post-Conflict Societies" *The American Journal of International Law* 93, f: 857.
[15] UNMIK Rregullorja Nr. 1999/1, 25 qershor 1999, 1.1.
[16] UNMIK REG 1999/1, f: 4.
[17] UNMIK REG 1999/1, f: 3.
[18] UNMIK Rregullorja Nr. 1999/24 të 12 dhjetorit 1999, f: 1.1.
[19] Raport i Sekretarit të Përgjithshëm 1999, S/1999/1250, Par. 55.
[20] UNMIK REG 1999/24, f: 1.1.
[21] UNMIK REG 1999/24, f: 1.2.
[22] Me qëllim të përfshirjes së komunitetit lokal ligjor në çështjet legjislative, UNMIK-u themeloi Komitetin e Përbashkët Këshillues për Çështjet Ligjore si trup këshilldhënës për PPSP dh që përbëhej në pjesën më të madhe nga juristët me përvojë më të gjatë akademike e më pak praktike.
[23] Për një vështrim të plotë dhe të detajizuar të aktivitetit ligjor shiko gazetën zyrtare të UNMIK-ut në faqen zyrtare të internetit http://www.unmikonline.org/regulations/index.htm.
[24] Gazeta Zyrtare e RFJ-së 78/29.
[25] Gazeta Zyrtare e RFJ-së 80/6.

[26] Gazeta Zyrtare e RFJ-së 77/4.
[27] Shiko UNMIK Rregullorën Nr. 2000/68 mbi Kontratat e shitjes së të mirave.
[28] Kodi i përgjithshëm Penal është përgatitur nga UNMIK-u me mbështetje të Këshillit të Europës. Kodi Penal është akoma vetëm një draft edhe përkundër kërkesave të vazhdueshme të komunitetit ligjor të Kosovës ende nuk është miratuar.
[29] UNMIK Rregullorja Nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001, kapitulli 8.1.
[30] UNMIK REG 2001/9, : 12.
[31] UNMIK REG 2001/9, 5.1.
[32] UNMIK REG 2001/9, 9.1.26.
[33] UNMIK REG2001/9, 9.1.45.
[34] Hoefer-Wissing, Neithart. "UNMIK holds on to a share of power," *Focus Kosovo,* 11.
[35] UNMIK REG2001/9, 9.1.26
[36] UNMIK REG2001/9, 8.1 dhe 8.2.
[37] Stahn, C. "The United Nations Transitional Administration in Kosovo and East Timor – A First Analysis," në: Max Planck Yearbook of United Nations Law, (2001) Vëllimi 5, f: 105 (109).
[38] Siç dihet, ekzistojnë paqartësi në Rezolutën 1244 (1999) në drejtim të statusit të ardhshëm të Kosovës dhe qëllimi i saj është që krijojë "autonomi substanciale". Flitet se Bernard Kouchner e ka lexuar tekstin e Rezolutës 1244 dy herë çdo mëngjes për të kuptuar se çfarë nënkuptohet me "autonomi substanciale." (Richard Caplan 77).
[39] E kryer si rezultat i Marrëveshjes Teknike Ushtarake të nënshkruar në mes të Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë(KFOR) dhe Qeverive të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë, nënshkruar më 9 qershor, 1999. burimi: http://www.nato.int/kfor/kfor/documents/mta.html
[40] Një marrëveshje për demilitarizimin e UÇK-së dhe Bashkësisë Ndërkombëtare është nënshkruar më 20 qershor, 1999. burimi: http://www.nato.int/kfor/kfor/documents/uck.html
[41] Gordon IV J., McGinn J., Nardulli B., Perry W., Pirme B., Disjointed War: Military Operation in Kosovo, 1999, Chapter Five: Enforcing the Peace, RAND 2002, http://www.rand.org/publications/MR/M1406..
[42] NATO, Brifingu i Mëngjesit, Jamie Shea, 9 qershor, 1999, Burimi: http://www.nato.int/kosovo/press/b990618m.html
[43] KFOR, Structure: http://www.nato.int/kfor/kfor/structure.html
[44] Lord Robertson i Port Ellen, Sekretar i Përgjithshëm në NATO, Kosovo One Year On: Achievement and Challenge, f: 16, 21 mars, 2001. burimi: http://www.nato.int/kosovo/repo2000/index.html
[45] Po aty, f: 11.
[46] Po aty, f: 16.
[47] KFOR , Objektivat dhe misioni, në: http://www.nato.int/kfor/kfor/objectives.html
[48] Lord Robertson i Port Ellen, Sekretar i Përgjithshëm në NATO, Kosovo One Year Mbi: Achievement and Challenge, f. 16, 21 mars 2001. burimi: http://www.nato.int/kosovo/repo2000/index.html
[49] Burimi: http://www.nato.int/facts/2000/kosovo.html

[50] Lord Robertson of Port Ellen, Sekretar i Përgjithshëm në NATO, Kosovo One Year On: Achievement and Challenge, f: 16, 21 mars 2001. burimi: http://www.nato.int/kosovo/repo2000/index.html
[51] Caplan, op cit., 77.
[52] Burimi: http://www.cIPVol.org/unmik/report_july.html
[53] Raport vjetor i policisë së UNMIK-ut, f: 11, Burimi: www.unmikonline/cIPVol/reports/report2000.pdf
[54] Burimi: http://www.unmikonline.org/cIPVol/factsfigs.html Stafi i Policisë)
[55] Raport vjetor i policisë së UNMIK-ut 2000, f: 11, Burimi: www.unmikonline/cIPVol/reports/report2000.pdf
[56] Burimi: www.cIPVol.org/unmik/balance.html
[57] Burimi: http://www.unmikonline.org/cIPVol/newfaq.html
[58] Chappel, Derek dhe Barry Fletcher. Intervistë personale, UNMIK Zëdhënës zyrtar, shtator 2002.
[59] Po aty.
[60] Njësiti për zbulimin e krimit të organizuar është themeluar më 15 Janar, 2001, *UNMIK Police Press Release*, 15 Janar, 2002.
[61] Chappell dhe Fletcher.
[62] International Crisis Group "Finding the Balance: The Scales of Justice System in Kosovo" f. 5. 12 shtator 2002, ICG Balkans Report Nr. 34, Prishtin/Bruksel.
[63] Chappell dhe Fletcher.
[64] ICG, "Finding the Balance: The Scales of Justice System in Kosovo".
[65] Chappell dhe Fletcher.
[66] Gordon et al.
[67] Chappell dhe Fletcher.
[68] Lynch, Gjeneral i SHBA-ve, Intervistë Personale, Prishtinë, tetor 2002.
[69] *Koha Ditore*, f. 1. 16 nëntor, 2002, Prishtina.
[70] Chappell dhe Fletcher.
[71] Për detaje shiko: Raport vjetor i policisë së UNMIK-ut 2000, www.unmikonline/cIPVol/reports/report2000.pdf
[72] Chappell dhe Fletcher.
[73] SHPK Raporti Javor i Statistikave të Burimeve Njerëzore, 14 shtator, 2002.
[74] UNMIK Kumtesë për shtyp e policisë së UNMIK-ut, 18 shtator 2002.
[75] Chappell dhe Fletcher.
[76] Morina, Shefki, Zëdhënësi i SHPK-së, Intervistë Personale, September 2002.
[77] Gordon et al.
[78] Coster, Dennis, Intervistë Personale, Zëvendësi I Krye-Komandantit të Kontigjentit Policor të SHBA-ve, Policia e UNMIK-ut.
[79] Morina.
[80] Chappell dhe Fletcher.
[81] Morina.
[82] Policia e UNMIK-ut , "Enhanced Comprehensive Development Frameëork Matrix for Kosovo Police Service" 2002.

[83] UNHCR/UNMIK (2001 January 13). Komiteti i përbashkët mbi Kthimin e serbëve kosovar: Korniza mbi Kthimet 2001. Prishtina.
[84] UNMIK (17 maj 2002). "E drejta për kthim të qëndrueshëm: Fletëkoncept [The rigth to sustainable return: A concept paper," Zyra e kthimit dhe e komuniteteve [The office of the returns of communities, The Office of the SRSG], Prishtina.
[85] Radosavljevic, Nenad (2000 Tetor 28). Platforma za dugorocno resavanje pitanja Kosova. [Public letter].
[86] United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (2002 August). "Returns to Kosovo: a new approach (as of Gusht 2002)," *Focus Kosovo*, Pristina.
[87] Manuel, Susan (gusht 2002). Pioneers pave the way. *Focus Kosovo*, f.: 13-14.
[88] UNHCR/UNMIK 2001. op cit.
[89] Po aty. 2.
[90] Po aty. p.: 2.
[91] Po aty.
[92] Palokaj, Augustin (2002 Qershor 17). "Projektet e kthimit të serbëve në Kosovë do të dështojnë në qoftë se nuk pranohet realiteti (Return projects of Serbs to Kosovo will fail if the neë reality is not accepted)," *Koha Ditore*, Nr. 1790, 3.
[93] Për një deklarim lidhur me komunitetet RAE shiko UNHCR/UNMIK (12 prill 2000). Deklaratë nga Tavolina e Rrumbullakët për çështjet Humanitare (gjithashtu "Platforma për Veprim të Përbashkët lidhur me komunitetet RAE të Kosovës – Deklaratë e Principeve"), Prishtinë.
[94] UNMIK 2001, op cit. 2-3.
[95] UNHCR/OSCEa. Ninth Assessment of the Situation of Ethnic Minorities in Kosovo: Period covering September 2001 to April 2002.
[96] UNHCR/OSCE (26 mars 2001). Assessment of the Situation of Ethnic Minorities In Kosovo: period (covering October 2000 through February 2001), 2.
[97] Bytyçi, Syzana (2002 August 30). "Beogradi vendos për drejtorin në Graçanicë," *Koha Ditore*, Nr. 1864,f: 1.
[98] Lessons Learned Analysis (LLA) Unit of the European Union Mission in Kosovo (2002 8 August 2002). The Ottoman Dilemma: Power and Property Relations Under the United Nations Mission in Kosovo."
[99] Mustafa, Artan (2002 September 6). "Demaçi: Pa definimin e statusit politik të Kosovës, kthimi i serbëve do të jetë i vështirë," *Epoka e Re*, Nr. 729, f: 3.
[100] UNMIK 2001, Op cit. Annex 2.
[101] Po aty.
[102] Çfarë përbën një lokacion strategjik nuk mund gjithmonë të definohet qartë dhe më shum ka të bëjë me perceptimet e vet komunitetevee. Ai duhet të kuptohet se i pëfshijnë pronat që i lidhin grumbujt e shtëpive të minoriteve me njëra tjetrën ose i lidh ato me shërbimet siq janë shioret apo klinikat. Fakti që shitja e pronës së tillë do të kishte rezultatin e reduktimit të zonës së banuar nga grupi minoritar duke i detyruar ata kështu që të shpërngulen në zona të shumicës është baza me të cilën komunitetet i klasifikojnë pronat e caktuara si strategjike. UNHCR/OSCE 2001 op cit. 16.
[103] Savezni Zavod za Statistiku (1995). Popis stanovnistva i domacinstva u SR

Jugoslavije prema popisu 1991, Stanovnistvo 47, Centar za demografska istrazivanja Instituta drustvenih nauka, Beograd, 213.

[104] UNHCR/OSCE (shtator 1999). Assessment of the Situation of Ethnic Minorities In Kosovo.

[105] Uka, Afërdita dhe Besa Bytyqi (15 gusht 2002). "Një kulm i përbashkët për shumë nacionalitete." *Zëri*, 6.

[106] UNHCR/OSCE. Përshkrim i situatës së pakicave serbe në Kosovë: periudha e mbuluar mars 2001 deri më gusht 2001.

[107] ESI/LLA, "Western Balkans 2004: Assistance, Cohesion and the neë boundaries of Europe. A call for policy reform, 3 nëntor 2002, www.esiweb.org

[108] Rezoluta e Këshilit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara S/R/1244 (1999), www.un.org

[109] Ju lutemi që t'i vëreni dallimet në mes ta Agjensionit Europian për Rindërtim (EAR,www.ear.int), krahut donator të Komisionit Europian, dhe shtyllës së BE, përgjegjëse për krijimin e politikave ekonomike si pjesë përbërëse e UNMIK-ut (www.euinkosovo.org).

[110] Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit i krijuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 më 13 qershor 2002.

[111] Zyret rajonale të BE do të mbyllen deri në fund të 2002.

[112] Regullorja 2000/63 e UNMIK-ut lëshuar më 7 dhjetor 2000.

[113] Themeluar për Rezultën 2000/63 të Këshillit të Sigurimit në dhjetor 2000.

[114] Ndërmarrjet Shoqërore (NSH).

[115] Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë.

[116] Raporti zhvillimor i Bankës Botërore 2002.

[117] Allcock, John B, Explaining Yugoslavia, Hurst & Company, 2000.

[118] Rindërtimi dhe Investimet 2001-2003.

[119] ESI/LLA, op cit.

[120] Vështrim Statistikor i Bizneseve të Regjistruara në Kosovë, shtator 2001.

[121] Prishtina. The Kosovo Big Small-Business Market, Small Scale Enterprise, Situation and Perspective, botuar nga Departamenti Administrativ për Punë dhe Punësim, gusht 2002.

[122] Draft Statistical Overvieë of Registered Businesses in Kosovo, shtator 2002.

[123] Qeerisja dhe Zhvillimi. Një tregim i vërtetë për rritjen e sektorit privat në Bosnë dhe Hercegovinë, LLA, 13 shkurt 2002, http://www.esiweb.org

[124] Po aty.

[125] Land Administration Seminar, 14 nëntor 2002.

[126] Ligji për Shpronësim, Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr 21/78 dhe Ligji për Tokën për Ndërtim, Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 14/80.

[127] De Soto, Hernando. The Mystery of Capital, Basic Books, 2000.

[128] Njësia Makroekonomike e Autoritetit Qendror Fiskal, Kosovë, tetor 2002.

[129] Speeches by the SRSG on www.unmikonline.org

[130] Governance and Development. A real life story of private sector growth in Bosnia and Herzegovina, ESI/LLA, 13 shkurt 2002, www.esiweb.org

[131] UNMIK Rrregullorja 2002/13 lëshuar më 13 qershor 2002.
[132] ESI/LLA Western Balkans 2004, op cit.
[133] ESI/LLA Kalesija Report. www.esiweb.org
[134] UN SCR 1244, 10 qershor 1999.
[135] OSCE, *As Seen As Told: An Analysis of Human Rights Violations in Kosovo* (Warsaw: Office of Democratic Institutions and Human Rights, 1999), f. 89.
[136] Po aty. f. 89.
[137] Steven Erlanger, "Fears Grow Over the De Facto Partition of Kosovo," *New York Times*, 14 Nëntor 1999.
[138] OSCE op cit., f. 89.
[139] OSCE vlerësimi i popullsisë cituar në Grupin Ndërkombëtar të Krizës (ICG), *UNMIK's Kosovo Albatross; Tackling Division in Mitrovica* (Pristina: International Crisis Group, 3 qershor 2002), f. 3.
[140] Po aty. f. 3.
[141] Micheal Steiner, Përfaqësuesi i Posaqëm i Sekretarit të Përgjithshëm, *A Choice for Mitrovica* 1tetor, 2002.
[142] UNMIK Division of Public Information-Media Monitoring, "Serbs Consider Seven Point Plan an Ultimatum, Albanians are Skeptical," *Koha Ditore,* 6 tetor 2002.
[143] Po aty.
[144] Po aty.
[145] UNMIK, New Coverage, *UN Assumes Administrative Control in Mitrovica*, 26 Nëntor, 2002. http://www.unmikonline.org/news.
[146] OSCE, *As Seen As Told: An Analysis of Human Rights Violations in Kosovo* (Warsaw: Office of Democratic Institutions and Human Rights, 1999), f. 90.
[147] Po aty.
[148] ICG, *UNMIK's Kosovo Albatross; Tackling Division in Mitrovica* (Prishtnë: International Crisis Group, 3 qershor 2002) (shënimi 5), f. 7.
[149] Po aty. f. 3. ICG shpjegon se "Rojet e Urës" paguhen nga Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë (MUP) si anëtarë të Sigurimit Shtetëror (DB); rrjedhimisht, në shkelje të drejtpërdrejt të Rezolutës 1244. Ata detyrojnë shitoret që të paguajnë taksë për "mbrojtje" dhe t'i lëshojnë me qira apartamentet e okupuara. Shiko intervistën e ICG me KFOR and UNMIK (shënimi 4), f. 3. ICG shkruan se "Rojet e Urës" i shtojnë fondet e tyre përmes krimit të organizuar duke përfshirë trafikimin dhe prostitucionin. Ata gjithashtu i pengonjë shumë shqiptarët dhe pakicat tjera që të kthehen në shtëpitë e tyre dhe i frustrojnë përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të krijuar prani në veri.
[150] Andrew Pervis, A Legacy of Hate. *Time Europe,* 18 shkurt 2002 (shënimi 4) thekson se Coviç është përpjekur që ta bind njërin ndër liderët e parë të "Rojeve të Urës", Ivanoviç, për të mbështuetur krijimin e një force policore shumë-etnike për të cilën Ivanoviç u pajtua vetëm nëse ata do t'i kenë buxhetin dhe uniformat e veta. Kjo është e papranueshme në vazhdën e përpjekjeve për një forcë policore shumë-etnike. Gjithashtu është e papranueshme në kuptim të ndarjes së saj me Mitrovicën veriore duke lëvizur pak a shumë në një sturktur komunale.

[151] Jonathon Steel, "Nation Building in East Timor," W*orld Policy Journal*, Summer 2002, Vëllimi 11, Nr. 2, f. 56.
[152] United Nations. Security Council Press Release, "Council Members Regret Stalemate in Installation of Kosovo's Newly Elected Institutions," 21 janar 2002, SC/7278, f. 13.
[153] Shiko Pjesën 2 mbi Sigurinë e Brendshme dhe të Jashtme.

[154] ICG (shënimi 4), f. 3. Në shkurt të vitit 2000, një sulm me granat ndaj një autobusi të UNHCR-it që transportonte serbët nga Mitrovica la të vdekur tre serbë dhe disa të tjerë u plagosën. Kjo shkaktoi një numër të sulmeve hakmarrëse dhe një cikël të ri të dhunës.
[155] OSBE, *As Seen As Told*, f. 90.
[156] ICG, *UNMIK's Kosovo Albatross,* f. 4
[157] Po aty.
[158] Po aty, f. 5.
[159] Komsioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën. Kosovo Report. (New York: Oxford, 2000), f.109.
[160] Michael Steiner, PPSP, *The Seven Point Plan: A Choice for Mitrovica*, 1 tetor 2002.
[161] Steel, op cit.
[162] United Nations. "Kosovo Making Progress in Security, Inter-ethnic Relations, Annan Reports." 26 korrik 2002 në http://www.un.org/apps/news/story.
[163] Lizee, Pierie. "Conflict Resolution as a Construction of Security: Peace-Building, Constructive Intervention, and Human Security in Southeast Asia." Simpoziumi për Zhvillim dhe Siguri në Azinë Juglindore (Toronto: York University 1999) 25 tetor.
[164] Guy Lawson, "The View from the Bridge," *New York Times*, 20 gusht 2000.
[165] Radio Mitrovica, Op cit.
[166] Po aty.

[167] ICG, f. 3. Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë vepron në veri dhe të dyshimtit arrestohen dhe sillen para gjykatave në Serbi.
[168] The Economist, First of All, be Nicer to Each Other, 5 Tetor 2002, Vëllimi. 365, Nr. 8293.
[169] The Economist, Op cit.
[170] Radio Mitrovica, Op cit.
[171] Intervistë me Bajram Rexhepin. KTV Direct, 6 dhjetor, 2002.
[172] Steven Erlanger, "Fears Grow over the De Facto Partition of Kosovo." New York Times. 14 Nëntor 1999
[173] ICG, UNMIK's Kosovo Albatross, Op cit. f. 6.
[174] Po aty.
[175] Andrew Pervis, A Legacy of Hate. Time Europe. 18 Shkurt, 2002, Vëllimi.59, Nr. 7.
[176] Musa Mustafa dhe Violeta Hyseni, "Institucionet paralele serbe vazhdojnë në lokacion të ri." Koha Ditore, 3 dhjetor 2002.
[177] UNMIK Divizioni i Informatave Publike, Media Monitoruesit, Bota Sot, 6 tetor 2002.
[178] ICG op cit. f: 6.

[179] Carlotta Gall, "NATO-Led Troops Caught in Battle over Kosovo Town." New York Times, 14 shkurt 2000.
[180] United Nations, Security Council Press Release, "Council Reviews Persistent Challenges Facing the Province." 30 korrik 2002, nr. SC/7472.
[181] Dana Eyre. "Partnership for Peace: Revitalizing Trepca and the Building of Peace in Kosovo." Peacekeeping and International Relations, Vëllimi 30, nr. 4, f: 19-22
[182] OSCE. As Seen as Told: An Analysis of the Human Rights Findings of the OSCE Verification Mission. Tetor 1998 deri në qershor 1999, f. 93.
[183] Po aty.

design & prepress: PIKA (www.pikastudio.net)

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

353.8:328 (496.51) (06)

ADMINISTRIMI dhe qeverisja në Kosovë : Mësimet e mësuara dhe ato që mbeten për tu mësuar / [Përpiluan Robert Muharremi ...et al.]. - [Ribotim]. - Prishtinë ; Gjenevë : KIPRED, 2005 (Prish- tinë : „ADD") . - VI, 72 fq.; 24 cm. - (Seria për kërkime politike : Botim i veçantë)

Shkurtesat dhe sqarimet gjuhësore : fq.61. - Shënime : fq.63-70

1.MUHARREMI, Robert

ISBN 9951-14-008-4

Për KIPRED-in

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave ka për qëllim të përkrahë vlerat demokratike në Kosovë përmes trajnimeve dhe analizave të pavarura të politikave publike.

Trajnimet kryesisht fokusohen në zhvillimin e partive politike përmes Internet Akademisë për Demokraci, e zhvilluar në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare Olof Palme nga Suedia.

Kërkimet fokusohen në botimin e analizave të pavarura në fusha si qeverisja e mirë, administrata, zhvillimi i partive politike, bashkëpunimi rajonal, politika ekonomike dhe qeverisja lokale.

KIPRED-i financohet nga fondacioni suedez "Olof Palme International Center" dhe nga fondacioni amerikan "Rockefeller Brother's Fund".

KIPRED
Kodra e Diellit, Rr. III, Ll. 39
Prishtinë, Kosovë (UNMIK)
Tel/Fax: +381 (0) 38 555 887
Info: kipred@hotmail.com
www.kipredinstitute.org

Përkrahur nga:

THE OLOF PALME INTERNATIONAL CENTER

Rockefeller Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World

ISBN 9951-14-008-4